



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 243

Tiranë – E hënë, 11 janar 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1069 datë 23.12.2015	Për tjetërsimin e pronësisë shtetërore “truall”, nga pronë shtetërore në pronë private, për shoqërinë “Bloja” sh.p.k., Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 122, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza e madhe e Tiranës (Komuna e Parisit-Rruga e Kavajës)””..... 16657
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1073, datë 23.12.2015	Për miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2016, për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare..... 16659
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1074, datë 23.12.2015	Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara..... 16659
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1075, datë 23.12.2015	Për masat për kontrollin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm (VOC), që rezultojnë nga magazinimi dhe shpërndarja e benzinës nga терминаlet në stacionet e shitjes së karburanteve..... 16663
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1076, datë 23.12.2015	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Arben Duka..... 16670
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1077, datë 23.12.2015	Për miratimin e rregullores “Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë”..... 16671
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1079, datë 23.12.2015	Për dhënien në përdorim, pa shpërblim, të një sipërfaqeje prej 371 m ² , në përgjegjësi administrimi të autoritetit shtetëror për informacionin gjeohapësinor (ASIG), qendrës “Protik”, Tiranë..... 16683
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1080, datë 23.12.2015	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 10.11.2015, për çështjen “Sharra dhe të tjerë kundër Shqipërisë” (për ankimet nr. 25038/08, 64376/09, 64399/09, 347/10, 1376/10, 4036/10, 12889/10, 20240/10, 29442/10, 29617/10, 33154/11 dhe 2032/12)..... 16684

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1082, datë 24.12.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 920, datë 18.11.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për mbylljen e Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI)”.....	16687
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1086, datë 28.12.2015	Për dhënien e ndihmës financiare, nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, për krijimin e një fondi ndihme, në kuadër të iniciativës së Këshillit të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës (CEB), “Për financimin e qendrave transite dhe të pritjes për vendet evropiane që presin refugjatë dhe emigrantë”.....	16687
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1087, datë 28.12.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar.....	16687
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1091, datë 28.12.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 212, datë 11.3.2015, “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Financave, për pagesën e shërbimeve juridike për përfaqësimin dhe mbrojtjen në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar ICC no. 20447/MHM S2 Albania sh.p.k. dhe Rapyscan Systems INC. kundër Republikës së Shqipërisë”.....	16688
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1093, datë 28.12.2015	Për miratimin e procedurave, kritereve dhe përparësive për dhënien e bonusit të strehimit.....	16688
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 28.12.2015	Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara.....	16690
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1096, datë 28.12.2015	Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike.....	16692
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1097, datë 28.12.2015	Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit.....	16699
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1098, datë 28.12.2015	Për disa ndryshime në vendimin nr. 54, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i objektit “Studim, projektim, lidhja e rrugës transballkanike me superstradën Fier - Vlorë”, të ndryshuar.....	16700
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1099, datë 28.12.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 488, datë 22.7.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e çmimit favorizues të shitjes së parcelës ndërtimore për ndërtimet pa leje me funksion banimi dhe të përzier, të subjekteve që përfitojnë falje të pagesës, si dhe të mënyrës e afateve të pagesës”, të ndryshuar.....	16705
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1101, datë 28.12.2015	Për miratimin e kushteve dhe përcaktimin e rregullave për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe të studentëve.....	16706
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1103, datë 28.12.2015	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit te Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, të sipërfaqes së tokës bujqësore 21.4 ha, zona kadastrale 1323, fshati Buronjë, Delvinë, dhe për një shtesë në vendimin nr. 820, datë 13.10.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të institucioneve të varësisë, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”.....	16715

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1104, datë 28.12.2015	Për miratimin e kërkesave për parandalimin e shkarkimit të mbetjeve, të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat, në det.....	16716
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1105, datë 28.12.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga “ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të Vlorës, faza 2, IPA 2012”.....	16726
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1107, datë 30.12.2015	Për krijimin e bordeve rajonale të kullimit Lezhë, Durrës, Fier dhe Korçë.....	16727
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Mihallaq Doko.....	16728

**VENDIM****Nr. 1069 datë 23.12.2015**

**PËR TJETËRSIMIN E PRONËSISË
SHTETËRORE “TRUALL”, NGA PRONË
SHTETËRORE NË PRONË PRIVATE,
PËR SHOQËRINË “BLOJA” SHPK,
TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR. 122, DATË 5.3.2014, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I SEGMENTIT RRUGOR “UNAZA E
MADHE E TIRANËS (KOMUNA E
PARISIT-RRUGA E KAVAJËS)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 757-760, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 3, shkronja “b”, e 8, paragrafi i parë, të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, dhe të neneve 4, 5, 10, 11, 12 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës dhe ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tjetërsimin e pronësisë shtetërore “truall”, me sipërfaqe 705 (shtatëqind e pesë) m², të ndodhur në zonën kadastrale nr. 8240, me nr. pasurie 2/137 dhe 2/138, sipas genplanit që i bashkëlidhet këtij vendimi, nga pronë shtetërore në pronë private, për shoqërinë “Bloja” sh.p.k., Tiranë.

2. Tjetërsimi të bëhet në natyrë, me kontratë shkëmbimi, me sipërfaqen e tokës prej 705 (shtatëqind e pesë) m², të ndodhur në zonën kadastrale nr. 8240, me nr. pasurie 2/137 dhe 2/138, që ka në pronësi shoqëria private “Bloja” sh.p.k., Tiranë, të ndodhur në kufi e vazhdim të tokës shtetërore, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Pasuritë me nr. 74 dhe nr. 75 hiqen nga lista e pronave që i bashkëlidhet vendimit nr. 122, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të

pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza e Madhe e Tiranës (Komuna e Parisit-Rruga e Kavajës)””, dhe shuma e vënë në dispozicion për dëmshpërblimin e shoqërisë “Bloja” sh.p.k., sipas këtij vendimi, kthehet në buxhetin e shtetit.

4. Autorizohet Autoriteti Rrugor Shqiptar që, në zbatim të këtij vendimi, të nënshkruajë kontratën e shkëmbimit me shoqërinë “Bloja” sh.p.k., Tiranë, sipas tekstit bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. _____ Rep.

Nr. _____ Kol.

KONTRATË SHKËMBIMI**Pasurie të paluajtshme**

Në Tiranë, sot më _____ 2015 (dymijë e pesëmbëdhjetë), para meje noteres publike _____, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, me seli në _____, u paraqitën personalisht palët si më poshtë:

PALET SHKËMBYESE:

I. Autoriteti Rrugor Shqiptar

II. Shoqëria “Bloja” sh.p.k.

BAZA ligjore:

Neni 83, 757 e vijues i Kodit Civil, ligji nr. 33/2012, datë 21.3.2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, ligji nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë” (i ndryshuar), VKM nr. _____, datë _____.

TË DHËNA PARAPRAKE:

Me vkm nr. _____, datë _____, Këshilli i Ministrave ka miratuar shkëmbimin e pasurisë _____ në pronësi të shtetit shqiptar, me pasurinë _____, në pronësi të “Bloja” sh.p.k., për shkak se prona e “Bloja” sh.p.k. preket nga ndërtimi i unazës së madhe të Tiranës. Për të përfaqësuar shtetin shqiptar në lidhjen e kësaj kontrate është autorizuar Autoriteti Rrugor Shqiptar.



Neni 1

Pasuria e paluajtshme e shtetit shqiptar

Shteti shqiptar është pronar i pasurisë _____ të ndodhur në _____

Neni 2

Pasuria e paluajtshme e “Bloja” sh.p.k.

“Bloja” sh.p.k. është pronare e pasurisë _____ të ndodhur në _____

Neni 3

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Me nënshkrimin e kësaj kontrate shkëmbimi dhe regjistrimin e saj në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, secila palë fiton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme objekt shkëmbimi, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre, respektivisht shteti shqiptar fiton pronësinë mbi pasurinë _____ aktualisht në pronësi të “Bloja” sh.p.k. dhe “Bloja” sh.p.k. fiton pronësinë mbi pasurinë _____ aktualisht në pronësi të shtetit shqiptar.

Secila palë kontraktuese do të marrë pasuritë respektive në gjendjen në të cilën ndodhen.

Palët garantojnë njëra-tjetrën se pas nënshkrimit të kontratës së shkëmbimit të pasurive të paluajtshme nuk do të ketë asnjë lloj pretendimi të tashëm apo të ardhshëm, duke qenë të vetmet dhe përfundimtare për këtë marrëdhënie shkëmbimi të pasurisë së paluajtshme objekt kontrate të lidhur ndërmjet tyre.

Palët me vullnet të lirë dhe të plotë deklarojnë se, me nënshkrimin e kësaj kontrate shkëmbimi të pasurive të paluajtshme, nuk do të kenë asnjë lloj pretendimi të tashëm apo të ardhshëm ndaj njëri-tjetrit, në lidhje me kohën e kalimit të titullit të pronësisë për pasuritë respektive, kalim i cili bëhet me pajisjen e pasurive me certifikata për vërtetim pronësie, nga ZVRPP Tiranë.

Palëve iu bëhet me dije që brenda afatit 30-ditor (tridhjetëditor), nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate shkëmbimi, të bëjnë regjistrimin e saj për transkriptimin e pasurive pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë. Në të kundërt, me kalimin e këtij afati përveç tarifës së regjistrimit, në bazë të nenit 39 të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, për çdo ditë vonese, që ka kaluar nga kjo datë, paguhet

kamatëvonesë, e barabartë me 10% (dhjetë për qind) të tarifës së regjistrimit.

Neni 4

Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni, zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Kjo kontratë, është hartuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe konkretisht nenit 83, 757 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Për sa u përket çështjeve që kjo kontratë nuk i rregullon shprehimisht, ato do të rregullohen nga dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate midis palëve, do të zgjidhet me bisedime dhe mirëkuptim të ndërsjellë midis palëve në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Kur midis palëve nuk arrihet zgjidhja e çështjeve me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 5

Të ndryshme

Detyrimet dhe të drejtat që burojnë nga kjo kontratë fillojnë efektet e tyre nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate.

Kjo kontratë zëvendëson të gjitha komunikimet e mëparshme mes palëve. Gjithashtu, palët deklarojnë se pas nënshkrimit të kësaj kontrate nuk kanë asnjë pretendim ndaj njëra-tjetrës lidhur me transferimin e pasurive respektive, as tani as në të ardhmen.

Kontrata iu lexohet palëve, të cilët e kuptojnë, e pranojnë përmbajtjen e aktit dhe e nënshkruajnë atë pa vërejtje, duke vënë emrin e mbiemrin, formë nënshkrimi kjo e përcaktuar në nenin 46 të Ligjit Nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për Noterinë” (i ndryshuar). Në zbatim të ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar), unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Kontrata redaktohet në katër ekzemplarë, me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike, nga të cilët një ruhet në arkivin e noteres. Një ekzemplar do të depozitohet pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme Tiranë.

Unë noterja, vërtetoj redaktimin korrekt të aktit dhe autenticitetin e nënshkrimeve, në bazë



të ligjit Nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për Noterinë”
(i ndryshuar).

PALET SHKËMBYESE
Autoriteti Rrugor Shqiptar
përfaqësuar nga
“Bloja” sh.p.k.
përfaqësuar nga
NOTERE

VENDIM

Nr. 1073, datë 23.12.2015

PËR MIRATIMIN E FONDIT TË SHPENZIMEVE, PËR VITIN 2016, PËR AUTORITETIN E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE E POSTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 117, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të shpenzimeve, për vitin 2016, për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP), në shumën 318 570 000 (treqind e tetëmbëdhjetë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, sipas pasqyrës nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE**
PASQYRA NR.1
**PROJEKTPLANI I SHPENZIMEVE PËR
VITIN 2016**

në milionë lekë

Nr.	Emërtimi	VITI 2016
A	Shpenzimet	318.57
1.	Paga dhe shtesa të tjera	81.2
2.	Sigurime shoqërore e shëndetësore	10.4
3.	Shpenzime për materiale	6.2
4.	Shpenzime për shërbime	90.47
5.	Shpenzimet për investime	130.3

VENDIM

Nr. 1074, datë 23.12.2015

PËR PËRCAKTIMIN E MASAVE PËR MËNJANIMIN E PENGESAVE NË KOMUNIKIM DHE INFRASTRUKTURË NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I

RREGULLIME TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjahen pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara.

2. Janë pengesa në komunikim:

a) vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim e dëgjim;

b) vështirësitë në komunikim që kanë personat që kërkojnë formate të thjeshta për t'u lexuar dhe për t'u kuptuar.

3. Janë pengesa infrastrukturore:

a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtdo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar, të përhershme ose të përkohshme;

b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve e të pjesëve përbërëse;

c) mungesa e mjeteve dhe e sinjalizimeve që lejojnë orientimin dhe njohjen e vendeve e të burimeve të rrezikut për këdo dhe, në veçanti, për personat me shikim apo dëgjim të kufizuar.

4. Ky vendim e shtrinë zbatimin mbi:

a) bashkitë dhe strukturat e tyre të kontrollit, sipërmarrësit privatë, administratorët e bizneseve, kompanitë e projektimit e të zbatimit të projekteve ndërtimore, si dhe të gjitha subjektet përgjegjëse



për të garantuar një mjedis pa pengesa për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara;

b) të gjitha ndërtimet e strukturat ndërtimore të reja dhe ekzistuese, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, kryesisht objektet e shëndetit publik, banesat dhe objektet rezidenciale, shkollat dhe institucionet shkencore, objektet kulturore, objektet e kultit, qendrat tregtare, institucionet administrative e të shërbimit publik, ndërmarrjet e qendrat e punës, në mjediset e të cilave ofrohen shërbime publike, parqet, sheshet e rrugët;

c) mjetet e transportit publik;

ç) mediat dhe tërësinë e mjeteve publike apo private të informimit publik.

5. Standardet e përshtatshmërisë zbatohen në të gjitha ndërtimet e strukturat ndërtimore ekzistuese si dhe në parqet, sheshet e rrugët ekzistuese, bazuar në kërkesat e parashikuara në kreun II, të këtij vendimi.

6. Shërbimi dhe mjetet e transportit publik përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë, të parashikuara në kreun II, të këtij vendimi.

7. Njësitë vendore përgjegjëse për transportin publik, qytetas dhe ndër-qytetas, publikojnë /afishojnë në çdo stacion të mjeteve të transportit publik orarin e lëvizjes së mjeteve të përshtatura dhe monitorojnë zbatimin e tij.

8. Mjetet, mënyrat dhe formatet e komunikimit të përdorura në ofrimin e shërbimeve publike përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë në komunikim, të parashikuara në këtë vendim.

9. Çdo subjekt, që ofron shërbime për publikun, është i detyruar që të miratojë një plan masash për zbatimin e kërkesave të këtij vendimi brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja e tij në fuqi.

10. Në planin e masave përfshihet detyrimi i subjektit për:

a) evidentimin e objekteve ekzistuese dhe të shërbimeve, për të cilat nevojitet përshtatshmëria;

b) planifikimin progresiv të fondeve të nevojshme për përshtatjen;

c) përcaktimin e afatit kohor për realizimin e përshtatshmërisë.

11. Plani i masave, një kopje e të cilit i dërgohet Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, miratohet me urdhër të titullarit /drejtuesit të subjektit dhe bëhet publik.

12. Subjektet planifikojnë në mënyrë progresive procesin e përshtatjes në përputhje me dispozitat e këtij vendimi.

13. Çdo subjekt, sipas pikës 4, të këtij vendimi, ka detyrimin që, brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data e miratimit të planit të masave, të fillojë punën për të realizuar procesin e përshtatshmërisë lidhur me objektet ekzistuese dhe shërbimet e ofruara.

14. Plani i masave e raportimet periodike /vjetore për realizimin e tyre publikohen nga subjektet e ngarkuara sipas këtij vendimi në çdo rast në faqet e internetit të institucioneve të tyre dhe dërgohen gjithashtu edhe në ministrinë përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar.

15. Marrja e masave për përshtatshmëri, në çdo rast, do të jetë pjesë e specifikimeve teknike, si një nga kushtet e detyrueshme për t'u plotësuar në një proces prokurimi.

16. Ndalohet dhënia e financimeve ose mbështetja financiare nga ana e shtetit apo enteve publike dhe jopublike/donatorëve për ndërtimin e një vepre, me qëllim ofrimin e shërbimit publik, nëse objekti nuk përmbush kërkesat e parashikuara në këtë vendim.

KREU II RREGULLA TË POSAÇME

1. Niveli i aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara garantohet në përputhje me kërkesat teknike, në çdo rast.

2. Çdo kërkesë teknike për përshtatshmërinë e objekteve të reja dhe atyre ekzistuese, parqeve, shesheve dhe rrugëve zbatohet sipas dispozitave të parashikuara në vendimin nr.1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara””.

3. Subjektet, që ofrojnë shërbim publik, garantojnë proces komunikimi dhe informimi për individët me vështirësi shikimi ose plotësisht të verbër, duke botuar në gjuhën braille dhe/ose me shkrim të zmadhuar dhe/ose në formatin audio materiale të lidhura drejtpërdrejt me interesat parësorë të këtij grupi njerëzish, duke parashikuar në mënyrë progresive edhe buxhetin përkatës të nevojshëm për përmbushjen e kësaj përshtatshmërie. Shërbimet e ofruara, ku përparësi kanë shërbimet e ofruara nga institucione të ligjit dhe tatim-taksave, institucione të arsimit dhe botimit, të shëndetësisë, të punësimit e të transportit, respektojnë kërkesat e përshkruara në këtë vendim.



4. Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit e bën të detyrueshëm (pjesë të kurrikulës arsimore) mësimin e gjuhës Braille, krahas mësimin të gjuhës së shkruar dhe/ose të folur shqipe në shkollën speciale për personat që nuk shikojnë, e cila është pjesë e sistemit të arsimit të detyrueshëm. 60% e stafit pedagogjik, përfshi organet drejtuese, të shkollës speciale për personat që nuk shikojnë janë persona që nuk shikojnë dhe që zotërojnë gjuhën braille.

5. Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit merr masa për mbarrëvajtjen e procesit të shndërrimit të instituteve speciale për nxënësit e verbër në qendra burimore multidisiplinare.

6. Ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar zyrtarizon dhe publikon, brenda 1 viti nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi, kodin e gjuhës braille.

7. Ministria përgjegjëse për çështjet e rendit e të sigurisë pajis forcat e rendit me njohuri bazë për sinjalistikën me audio dhe forma të tjera të përshtatura për lëvizshmërinë e pavarur të njerëzve të verbër, njohjen e shkopit të bardhë, gjuhës braille dhe shenjave të tjera dalluese, si mjete identifikuese të individëve të verbër.

8. Institucionet e shërbimit të transportit publik/privat, përveç zbatimit të kërkesave për përshtatshmëri të parashikuara në vendimin nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores "Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara"", garantojnë sistem transporti për individët e verbër ose me dëmtim të shikimit, duke përfshirë sistem të shpjegimit me audio për orientim në linjat e transportit dhe ndërthurjen e tyre.

9. Shërbimet e transportit publik ofrojnë transport qytetas me mjete tërësisht të përshtatura minimumi çdo 1 (një) orë në çdo vendqëndrim dhe shërbim transporti ndërqytetas me mjete të përshtatura për personat me vështirësi në lëvizje, minimumi një herë në ditë.

10. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në bashkëpunim me bashkitë, realizojnë në raste të caktuara, sidomos gjatë periudhave zgjedhore, procese komunikimi konsultimi dhe këshillimi plotësisht të aksesueshme për individët e verbër, duke ofruar edhe formate të përshtatura me audio dhe/ose forma të tjera të porositura nga komuniteti i njerëzve që nuk shikojnë.

11. Operatorët e medias, ato përgjegjës për komunikimin on-line dhe subjekte që prodhojnë forma të tjera të transmetimit drejt audiencës, aplikojnë rregullat për aksesueshmëri nëpërmjet teknologjive të posaçme dhe ofrojnë për personat e verbër shpjegim në format audio të materialeve të transmetuara kryesisht me natyrë informuese, duke parashikuar në mënyrë progresive buxhetin përkatës për aplikim të përshtatshmërisë.

12. Subjektet, që ofrojnë shërbim publik, garantojnë proces komunikimi dhe informimi për individët me vështirësi në dëgjim ose që nuk dëgjojnë dhe nuk flasin, duke siguruar përkthim në gjuhën shqipe të shenjave gjatë ofrimit të shërbimit për këtë komunitet e duke parashikuar në mënyrë progresive edhe buxhetin përkatës të nevojshëm për përmbushjen e kësaj përshtatshmërie. Shërbimet e ofruara, ku përparësi kanë shërbimet e ofruara nga institucione të ligjit, të shëndetësisë, financiare, të arsimit, të transportit, të punësimit e të kulturës, respektojnë kërkesat e përcaktuara në këtë vendim me kushtin që personi përfitues të ketë marrë/caktuar paraprakisht takim me to.

13. Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit përfshin në kurrikulat e arsimit të detyrueshëm për shkollën speciale për personat që nuk dëgjojnë mësimin e gjuhës së shenjave shqipe, krahas mësimin të gjuhës shqipe, të shkruar dhe/ose të folur.

14. Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit merr masa që të paktën 10% e personelit pedagogjik të shkollës speciale për personat që nuk dëgjojnë janë persona që nuk dëgjojnë dhe nuk flasin dhe që zotërojnë gjuhën e shkruar dhe gjuhën e shenjave shqipe.

15. Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit ndërmerr politika për hapjen e një programi shkollimi në shkollë të lartë (bachelor/master) për përgatitjen e interpretëve/përkthyesve të gjuhës së shenjave shqipe, si dhe të personelit shkencor në këtë fushë.

16. Ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar, në bashkëpunim me organizatat e personave dhe për personat që kanë aftësi të kufizuara të dëgjimit, identifikojnë çdo dy vjet nevojat për interpretë/përkthyes dhe instruktorë të mësimin të gjuhës së shenjave shqipe.

17. Ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar zyrtarizon dhe publikon, brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, Fjalorin e Gjuhës së Shenjave Shqipe.



18. Televizionet kombëtare transmetojnë rregullisht emisionin kryesor të lajmeve në opsionin e transmetimit të shoqëruar me titra dhe me gjuhën e shenjave.

19. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në bashkëpunim me bashkitë, realizojnë në raste të caktuara, sidomos gjatë periudhave zgjedhore, procese komunikimi konsultimi dhe këshillimi në distancë, me ndihmën e teknologjisë (telefon /television/internet) si dhe nëpërmjet video-konferencave.

20. Në personat me aftësi të kufizuara të intelektit përfshihen:

a) personat që kanë vështirësi në të lexuar dhe në të nxënë nëpërmjet gjuhës (disleksi), në të shkruar (disgrafi);

b) personat me aftësi të kufizuara intelektuale /zhvillimi;

c) personat me aftësi të kufizuara të shëndetit mendor;

ç) personat me aftësi të kufizuara të të folurit/të të shqiptuarit.

21. Subjektet, që ofrojnë shërbim publik, garantojnë proces komunikimi dhe informacioni për personat me aftësi të kufizuara të intelektit, duke përdorur teknika në përshtatje me nivelin dhe formën e dëmtimit të intelektit të individit, duke parashikuar progresivisht edhe burimet njerëzore e buxhetore të nevojshme për përmbushjen e kësaj përshtatshmërie. Shërbimet e ofruara, ku përparësi kanë shërbimet e ofruara nga institucione të shëndetësisë, mbrojtjes shoqërore, arsimit, punësimit, transportit e të kulturës, respektojnë kërkesat e parashikuara në këtë vendim.

22. Në teknikat e përshtatura përfshihen minimumi:

a) dhënia e kohës së nevojshme për të procesuar, kuptuar dhe reaguari;

b) rimarrja dhe përsëritja e informacionit, shpjegimi i informacionit në gjuhë të thjeshtë, copëzimi i informacionit në koncepte më të thjeshtuara, pa e tepruar, dhënia e besimit dhe e sigurisë gjatë komunikimit;

c) të dëgjuarit e vëmendshëm, mosndërprerja e panevojshme e ligjëratës, përdorimi i fjalive e i fjalëve të thjeshta në të shkruar;

ç) përdorimi i figurave, fotove, ngjyrave në materiale të shtypura.

23. Ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar, në bashkëpunim me akademikë dhe ekspertizën e OJF-ve, përgatit, boton dhe shpërndan një udhëzues/manual për punonjësit e institucioneve të shërbimeve publike për mënyrat e komunikimit e të informimit të personave të përmendur në pikën 24, të këtij kreu, si dhe për mënyrën e përpilimit të materialeve të shkruara për këta persona.

24. Në çdo rast, çdo institucion, që komunikon dhe informon nëpërmjet teknologjisë së komunikimit dhe informimit on-line, merr masa progresive për zbatimin e kërkesave të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara të intelektit, duke ndërtuar dhe përshtatur në përputhje me nevojat e tyre çdo medium të komunikimit dhe informimit në internet të parashikuar për ta apo për konsum publik.

KREU III

MONITORIMI DHE ANKIMI

1. Monitorimi për zbatimin e këtij vendimi bëhet nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, i cili merr masat përkatëse sipas kompetencave të veta dhe njofton ministrinë që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar për çdo rast shkeljeje.

2. Ministria, që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, për rastet e moszbatimit të rregullave të parashikuara në këtë vendim nga institucionet sipas pikës 4, të kreut I, të këtij vendimi, u kërkon subjekteve përkatëse të marrin masat e nevojshme dhe të korrigjojnë shkeljen brenda një afati, jo më shumë se 1/2 e afatit të parashikuar në planifikim.

3. Moszbatimi i rregullave të vendosura në këtë vendim përbën shkak për dhënien e masave disiplinore për punonjësit përgjegjës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Çdo subjekt, person fizik ose juridik, paraqet para ministrit që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar ankesa për shkeljen e së drejtës për aksesueshmëri në shërbime publike.

5. Ministri përgjegjës për çështjet e aftësisë së kufizuar, nëpërmjet sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, merr në shqyrtim ankesën dhe u kërkon organeve kompetente referuese marrjen e masave administrative, si dhe përgatitjen e një informa-



cioni për Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 1075, datë 23.12.2015

PËR MASAT PËR KONTROLLIN E SHKARKIMIT TË PËRBËRËSVE ORGANIKË TË AVULLUESHËM (VOC), QË REZULTOJNË NGA MAGAZINIMI DHE SHPËRNDARJA E BENZINËS NGA TERMINALET NË STACIONET E SHITJES SË KARBURANTEVE¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të nenit 15, të ligjit nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është të llogaritet dhe të përcaktojnë masat për kontrollin e përbërësve organikë të avullueshëm (VOC), të cilat gjenden në avujt e benzinës të lëshuar në atmosferë, si rezultat i magazinimit, ngarkimit dhe transportit të benzinës nga një terminal në tjetrin apo nga një terminal në një stacion shitjeje karburanti, nga industria e marketingut të benzinës, me synim pakësimin e shkarkimeve të tyre në mjedis.

2. Ky vendim i shtrinë efektet e tij mbi të gjitha veprimet, instalimet, automjetet dhe anijet që përdoren për realizimin e operacioneve të cituara në pikën 1, më sipër.

3. Të gjithë termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e ligjit

nr.162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit”, ndërsa termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

a) “Anije”, çdo mjet që përdoret për lundrim në ujërat e brendshme, që ka një gjatësi (L) prej 20 metrash, ose më shumë, dhe produkti i gjatësisë (L), gjerësisë (G) dhe thellësisë (T) nuk është më i vogël se 100 m³;

b) “Avull”, çdo përbërës i gaztë që avullon nga benzina;

c) “Benzinë”, çdo derivat i naftës, i përzier ose jo me alkool apo shtesa të tjera, që ka një presion avulli reid prej 27,6 kilopaskal ose më shumë, i cili përdoret si karburant për mjete motorike, me përjashtim të gazit të lëngshëm të naftës (GLN);

ç) “Instalim ekzistues për magazinimin e benzinës, instalim ekzistues për ngarkimin e benzinës, stacion shitjeje karburanti ekzistues dhe kontejner i lëvizshëm ekzistues”, çdo instalim, stacion shitjeje karburanti dhe kontejner i lëvizshëm, që ka qenë në funksionim ose për të cilin është dhënë leje ndërtimi ose leje përdorimi, sipas legjislacionit të posaçëm, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

d) “Instalim i ri për magazinimin e benzinës, instalim i ri për ngarkimin e benzinës, stacion i ri shitjeje karburanti dhe kontejner i ri, i lëvizshëm”, çdo instalim, stacion shitjeje karburanti dhe kontejner i lëvizshëm, që vihet në funksionim pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

dh) “Instalim magazinimi”, çdo depozitë e palëvizshme në një terminal, e përdorur për magazinimin e benzinës;

e) “Instalim ngarkimi”, çdo mjet në terminal, nëpërmjet të cilit benzina mund të ngarkohet në kontejnerë të lëvizshëm. Instalimet e ngarkimit për cisternat për transport rrugor përfshijnë një ose më shumë “krahë ngarkimi”;

ë) “Kontejner i lëvizshëm”, çdo depozitë e transportuar nëpërmjet rrjetit rrugor, hekurudhor ose ujqor, e përdorur për transportimin e benzinës nga një terminal në tjetrin ose nga një terminal në stacionin e shitjes së karburanteve;

f) “Krah ngarkimi”, çdo strukturë në terminal, nëpërmjet së cilës benzina mund të ngarkohet, në çdo kohë, në një cisternë të vetme për transport rrugor. Distanca e tubit të ngarkimit nga dysHEMEJA e strukturës që do të ngarkohet të jetë jo më shumë se 15 cm;

¹Ky vendim përaftron Direktivën 94/63/EC mbi kontrollin e shkarkimeve të përbërësve organikë të avullueshëm (VOC) që rezultojnë nga magazinimi i benzinës dhe shpërndarjes së saj nga terminalet në pikat e shitjes. Numri CELEX 31994L0063. Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L 365, datë 31.12.1994 Fq. 0024 – 0033.



g) “Magazinimi i ndërmjetëm i avujve”, magazinimi i përkohshëm i avujve në depozitë me çati të fiksuar në një terminal, për transferim të mëvonshëm dhe rikuperim në një terminal tjetër;

gj) “Njësia e rikuperimit të avullit”, pajisja për rikuperimin e benzinës nga avujt, përfshirë sistemin e depozitave buferike në terminal;

h) “Stacion shitjeje karburanti”, çdo instalim, në të cilin benzina, nga depozitat e palëvizshme të magazinimit, shpërndahet në serbatorët e karburantit të mjeteve motorike;

i) “Shkop matës”, një matës në formë shkopi të shkallëzuar për të kryer matjen e thellësisë ose sasisë së lëngut në një enë, sikurse është benzina në cisternë;

j) “Terminal”, çdo pajisje e përdorur për magazinimin dhe ngarkimin e benzinës në cisterna për transport rrugor, hekurudhor ose me anije, përfshirë të gjitha instalimet e magazinimit në vendndodhjen e pajisjes;

k) “Vlerë referencë e synuar”, udhëzimi i dhënë për vlerësimin e përgjithshëm të përshtatshmërisë së masave teknike, të parashikuara në shtojcat e këtij vendimi. Kjo vlerë nuk është një vlerë kufi, kundrejt së cilës matet performanca e instalimeve individuale, terminaleve dhe stacioneve të shitjes së karburanteve;

l) “Xhiro vjetore”, sasia më e madhe, totale, vjetore, e benzinës së ngarkuar nga instalimi i magazinimit në terminal ose nga stacioni i shitjes së karburantit në kontejner të lëvizshëm, gjatë tri viteve paraardhëse.

KREU II INSTALIMET E MAGAZINIMIT NË TERMINALE

1. Vlera referencë e synuar e humbjes totale vjetore të benzinës, nga ngarkimi dhe magazinimi në çdo instalim magazinimi në terminale, duhet të jetë, maksimumi, 0,01% e xhiros vjetore peshë në peshë (p/p).

2. Operatorët, me qëllim që të pakësojnë humbjen totale vjetore të benzinës, që rezultojnë nga ngarkimi dhe magazinimi në çdo instalim magazinimi në terminale, nën vlerën e përcaktuar në pikën 1, të këtij kreu, projektojnë dhe/ose prokurojnë dhe vënë në funksionim instalime magazinimi që janë në përputhje me kërkesat

teknike, të parashikuara në shtojcën I, të këtij vendimi.

3. Ministri përgjegjës për mjedisin dhe ministri përgjegjës për shëndetësinë, mbështetur në rezultatet e monitorimit të cilësisë së ajrit dhe në gjendjen e shëndetit publik, përcaktojnë, me urdhër të përbashkët, rast pas rasti, zonat gjeografike ku kërkesat teknike duhet të jenë më shtrënguese se ato të parashikuara në shtojcën I, të këtij vendimi.

4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe Drejtoria Rajonale e Mjedisit (DRM), kur pajisin subjektet me lejet e mjedisit, përcaktojnë kërkesa teknike specifike për zonat gjeografike, të parashikuara në pikën 3, të këtij kreu.

5. Kërkesat e parashikuara në pikat 1 deri në 4, të këtij kreu, zbatohen për:

a) instalimet e reja, duke filluar nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

b) instalimet ekzistuese, në qoftë se xhiroja vjetore e ngarkimit në terminal është:

i) më e madhe se 50 000 ton/vit, duke filluar 3 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

ii) më e madhe se 25 000 ton/vit, duke filluar 6 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

c) të gjitha instalimet ekzistuese të magazinimit në terminale, duke filluar 9 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Ministri përgjegjës për mjedisin miraton listën e zonave me peizazh të veçantë, që kanë nevojë për mbrojtje nga VOC-at, dhe, mbi bazën e kësaj liste, operatorët marrin masat e nevojshme, referuar këtij vendimi, për mbrojtjen e tyre.

KREU III NGARKIMI DHE SHKARKIMI I KONTEJNERËVE TË LËVIZSHËM NË TERMINALE

1. Vlera referencë e synuar e humbjes totale vjetore të benzinës, nga ngarkimi dhe shkarkimi i kontejnerëve të lëvizshëm në terminale, duhet të jetë, maksimumi, 0,005% p/p e xhiros vjetore.

2. Operatorët, me qëllim që të reduktojnë humbjen vjetore të benzinës, që rezultojnë nga ngarkimi dhe shkarkimi i kontejnerëve të lëvizshëm në terminale, nën vlerën referencë, të përcaktuar në pikën 1, të këtij kreu, projektojnë dhe/ose prokurojnë dhe vënë në funksionim pajisje ngarkimi dhe shkarkimi që janë në



përputhje me kërkesat teknike, të parashikuara në shtojcën II, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ministri përgjegjës për mjedisin dhe ministri përgjegjës për shëndetësinë, mbështetur në rezultatet e monitorimit të cilësisë së ajrit dhe në gjendjen e shëndetit publik, përcaktojnë, me urdhër të përbashkët, rast pas rasti, zonat gjeografike ku kërkesat teknike, të parashikuara në pikën 2, të këtij kreu, duhet të jenë më shtrënguese se ato të përcaktuara në shtojcën II, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. AKM-ja dhe DRM-ja, kur pajisin subjektet me lejet e mjedisit, përcaktojnë kushte teknike specifike për zonat gjeografike, të parashikuara në pikën 3 të këtij kreu.

5. Operatorët e të gjitha terminaleve me mjete ngarkimi për cisternat për transport rrugor pajisen me, të paktën, një krah ngarkimi, që përputhet me specifikimet për pajisjen me ngarkim nga poshtë, të përcaktuar në shtojcën IV, bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Dispozitat e pikave 1 deri 5, të këtij kreu, zbatohen për:

a) terminalët e reja për ngarkimin në cisternat për transport rrugor, hekurudhor dhe/ose me anije, duke filluar nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

b) terminalët ekzistues për ngarkimin në cisternat për transport rrugor, hekurudhor dhe/ose me anije, në qoftë se:

i) sasia totale është më e madhe se 150 000 tonë/në vit, duke filluar 3 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

ii) xhiroja vjetore është më e madhe se 25 000 tonë/në vit, duke filluar 6 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

c) të gjitha instalimet e tjera ngarkuese ekzistuese në terminale, për ngarkimin në cisternat për transport rrugor dhe hekurudhor, duke filluar 9 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Për të gjitha cisternat për transport rrugor, krahët e ngarkimit në të gjithë terminalët, përveç rasteve kur janë përjashtuar, sipas parashikimeve të pikës 8, të këtij kreu, nga kërkesat për pajisjen e ngarkimit/furnizimit nga poshtë, të përcaktuara në shtojcën IV, bashkëlidhur këtij vendimi, do të zbatohen duke filluar 9 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Pavarësisht nga sa është parashikuar, pikat nga 1 deri në 5 dhe pika 7, të këtij kreu, nuk zbatohen në terminalët:

a) ekzistuese, me xhiro vjetore më të vogël se 10 000 tonë/vit;

b) e reja, me xhiro vjetore më të vogël se 5 000 tonë/vit, të vendosur në ishuj të vegjël, në distancë të largët.

KREU IV

KONTEJNERËT E LËVIZSHËM

1. Operatorët që projektojnë dhe/ose prokurojnë dhe vënë në funksionim kontejnerë të lëvizshëm, plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) Mbajnë në kontejner avujt e tyre, të mbetur pas shkarkimit të benzinës;

b) Pranojnë dhe mbajnë avujt e kthyer nga instalimet e magazinimit në stacionet e shitjes së karburanteve ose terminaleve, gjatë shpërndarjes së benzinës në stacionet e shitjes së karburanteve dhe në terminale. Për sa i takon cisternave për transport hekurudhor, kjo kërkohet vetëm në qoftë se ato furnizojnë me benzinë stacionet e shitjes së karburanteve ose terminalët ku bëhet magazinim i ndërmjetëm i avujve;

c) Mbajnë në kontejnerë të lëvizshëm avujt e përmendur në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, deri sa të ringarkohen në terminal, përfshirë edhe avujt e shkarkimit përmes valvulës së çlirimit të presionit.

Në qoftë se, menjëherë pas shkarkimit të benzinës, kontejneri i lëvizshëm përdoret për produkte të ndryshme nga benzina, për aq kohë sa rikuperimi i avujve ose magazinimi i ndërmjetëm i tyre nuk është i mundur, mund të lejohet ventilimi në një zonë gjeografike ku nuk ka gjasa që shkarkimet të shkaktojnë ndikime të rëndësishme në mjedis apo shëndet;

ç) Për cisternat/kontejnerët për transport rrugor kryhen teste të rregullta për mbajtjen e avujve;

d) Për funksionimin korrekt të valvulave të vakuumit/presionit në të gjithë kontejnerët e lëvizshëm kryhen inspektime periodike.

2. Kërkesat e parashikuara në pikën 1, të këtij kreu, zbatohen për cisternat:

a) e reja, për transport rrugor, hekurudhor dhe me anije, duke filluar nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;



b) ekzistuese, për transport hekurudhor dhe me anije, në qoftë se ngarkohen në një terminal ku zbatohen kërkesat e pikës 1, duke filluar 3 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

c) ekzistuese, për transport rrugor, që më pas përshtaten për ngarkim nga poshtë, në përputhje me specifikimet e përcaktuara në shtojcën IV, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Kërkesat e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij kreu, nuk zbatohen për humbjet e avujve që rezultojnë nga operacionet e matjes me shkopinj, për:

a) kontejnerët ekzistues të lëvizshëm;

b) kontejnerët e rinj të lëvizshëm, të cilët vihen në funksion brenda 4 viteve, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

KREU V

NGARKIMI NË INSTALIMET E MAGAZINIMIT NË STACIONET E SHITJES SË KARBURANTEVE

1. Vlera referencë e synuar e humbjes totale vjetore të benzinës, nga ngarkimi në instalimet e magazinimit në stacionet e shitjes së karburanteve, duhet të jetë, maksimumi, 0,01% p/p e xhiros vjetore.

2. Operatorët, me qëllim që të pakësojnë humbjen totale vjetore të benzinës, që rezulton nga ngarkimi në instalimet e magazinimit në stacionet e shitjes së karburanteve, nën vlerën referencë, të përcaktuar në pikën 1, të këtij kreu, projektojnë dhe/ose prokurojnë dhe vënë në funksionim pajisje ngarkimi dhe shkarkimi që janë në përputhje me kërkesat teknike, të parashikuara në shtojcën III, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ministri përgjegjës për mjedisin dhe ministri përgjegjës për shëndetësinë, mbështetur në rezultatet e monitorimit të cilësisë së ajrit dhe në gjendjen e shëndetit publik, përcaktojnë, me urdhër të përbashkët, sipas rastit, zonat gjeografike ku kërkesat teknike, të parashikuara në pikën 2, të këtij kreu, duhet të jenë më shtrënguese se ato të përcaktuara në shtojcën III, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. AKM-ja ose DRM-ja, kur pajisin subjektet me lejet e mjedisit, përcaktojnë kërkesat teknike specifike për zonat gjeografike, të parashikuara në pikën 3, të këtij kreu.

5. Kërkesat e parashikuara në pikat 1 deri në 3, të këtij kreu, zbatohen për:

a) stacionet e reja të shitjes së karburanteve, duke filluar nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

b) stacionet ekzistuese të shitjes së karburanteve, me xhiro vjetore:

i) më të madhe se 1 000 m³/në vit, duke filluar 3 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

ii) çfarëdo, kur ato ndodhen në zona të përhershme banimi ose zona ku punohet, duke filluar 3 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

iii) më të madhe se 500 m³/në vit, duke filluar 6 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

c) të gjitha stacionet e tjera ekzistuese të shitjes së karburanteve, duke filluar 9 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Rregullat e parashikuara në pikat 1 deri në 5, të këtij kreu, nuk zbatohen për stacionet e shitjes së karburanteve me xhiro vjetore më të ulët se 100 m³/në vit.

7. Rregullat e parashikuara në pikat 1 deri në 5, të këtij kreu, nuk zbatohen në stacionet e shitjes së karburanteve me xhiro vjetore më të ulët se 500 m³/në vit, kur stacioni i shitjes së karburantit është vendosur në një zonë gjeografike ose në një zonë ku shkarkimet e avujve nuk mund të shkaktojnë ndikime të rëndësishme në mjedis ose shëndet.

8. Ministri përgjegjës për mjedisin dhe ministri përgjegjës për shëndetësinë, mbështetur në rezultatet e monitorimit të cilësisë së ajrit dhe në gjendjen e shëndetit publik, përcaktojnë, sipas rastit, zonat gjeografike, të parashikuara në pikën 7, të këtij kreu.

KREU VI

SISTEMET E MIRËMBAJTJES

1. Të gjitha sistemet e njësive të rikuperimit të avujve gjatë punës duhet të mirëmbahen në mënyrën e duhur, në përputhje me specifikimet e prodhuesit, për të siguruar integritetin dhe efikasitetin e sistemit. Nëse:

a) një komponent i sistemit pëson një defekt të rëndësishëm, ai duhet të nxirret jashtë shërbimit;

b) defekti nuk e redukton efektivitetin e sistemit nën 95%, riparimi i tij duhet të bëhet në një periudhë, jo më shumë, se 5 ditë.

2. Ricertifikimi i sistemeve të rikuperimit të avujve të benzinës bëhet një herë në çdo 5 vjet dhe do të përfshijë të gjitha testet funksionale që janë të



nevojshme për vërtetimin fillestar. Ai nënkupton zëvendësimin, riparimin dhe përmirësimin e 75% të nyjeve funksionale dhe bëhet në prezencë të AKM-së dhe inspektoratit përgjegjës për mjedisin.

3. Poseduesit e sistemeve të rikuperimit të avujve të benzinës duhet të trajnojnë, minimalisht, një punonjës për përdorimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

4. Në rast transferimi ose dhënie me qira të sistemit, dorëzimi i tyre bëhet me dokumentacion të rregullt.

5. Të gjitha të dhënat e sistemeve të rikuperimit shënohen në libër të veçantë dhe ruhen për dy vjet. Poseduesi duhet t'i paraqesë të dhënat brenda 7 ditëve pune, pas njoftimit të marrë nga AKM-ja.

Të dhënat duhet të përmbajnë:

- sasinë e benzinës së furnizuar;
- sasinë e benzinës së shpërndarë;
- ditarin e mirëmbajtjes dhe inspektimit;
- rezultatet e testeve dhe faturat e punimeve të kryera në komponentët e sistemit;
- lejen e lëshuar nga AKM-ja për funksionimin e sistemit.

KREU VII MONITORIMI DHE RAPORTIMI

1. AKM-ja përgatit një raport 3-vjeçar për masat që ka marrë, me qëllim zbatimin e këtij vendimi, brenda fushës së përgjegjësisë së saj shtetërore, dhe ia dorëzon ministrit përgjegjës për mjedisin brenda 6 muajve, pas përfundimit të periudhës 3-vjeçare të mbuluar nga ky raport.

2. Raporti i parë mbulon periudhën 3-vjeçare pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Format i raportit miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për mjedisin.

4. Raporti 3-vjeçar publikohet në faqen elektronike zyrtare të ministrisë përgjegjëse për mjedisin.

KREU VIII INSPEKTIMI

1. Inspektorati përgjegjës për mjedisin inspekton rregullisht terminalët dhe stacionet e shitjes së karburanteve, që magazinonjë dhe shpërndajnë benzinë, kur ato janë në punë, për të verifikuar nëse:

a) ka rrjedhje në linjat e lidhjes në instalimet e tubave, dhe detyron operatorin të marrë masat e nevojshme;

b) pajisjet e ngarkimit dhe shkarkimit janë në përputhje me kërkesat teknike, të parashikuara në

shtojcën I, të këtij vendimi;

c) pajisjet e ngarkimit dhe shkarkimit janë në përputhje me kërkesat teknike, të parashikuara në shtojcën II, të këtij vendimi;

ç) pajisjet e ngarkimit, për cisternat për transport rrugor, pajisen me, të paktën, një krah ngarkimi, që përputhet me specifikimet për pajisjen me ngarkim nga poshtë, të përcaktuar në shtojcën IV, të këtij vendimi;

d) kontejnerët e lëvizshëm plotësojnë kërkesat e përcaktuara në kreun V, të këtij vendimi;

dh) pajisjet e ngarkimit dhe shkarkimit janë në përputhje me kërkesat teknike, të parashikuara në shtojcën III, të këtij vendimi.

2. Të dhënat e inspektimit duhet të përfshijnë:

a) datën e inspektimit;

b) rrjedhjet, të vërtetuara me një përshtkrim të tyre, nëse ka;

c) mënyrën e përcaktuar për gjetjen e rrjedhjes;

ç) veprimet që do të kryhen për eliminimin e rrjedhjeve, me afatet përkatëse;

d) emrin e inspektorit dhe nënshkrimin e tij.

KREU IX KUNDËRVAJTJET

Mospërmbyshja e kërkesave të këtij vendimi përbën kundërvajtje administrative dhe ndëshkohet sipas shkronjës “c”, të nenit 20, të ligjit nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, për veprimet/mosveprimet, nëse:

a) ka rrjedhje në linjat e lidhjes dhe instalimet e tubave, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në shtojcën II, të këtij vendimi;

b) instalimet e magazinimit nuk janë në përputhje me kërkesat teknike të shtojcës I, të parashikuara në pikën 2, të kreut II, të këtij vendimi;

c) pajisjet e ngarkimit dhe shkarkimit nuk janë në përputhje me kërkesat teknike të shtojcës II, të parashikuara në pikën 2, të kreut III, të këtij vendimi;

ç) pajisjet e ngarkimit për cisternat për transport rrugor nuk janë në përputhje me kërkesat teknike të shtojcës IV, të parashikuara në pikën 5, të kreut III, të këtij vendimi;

d) kontejnerët e lëvizshëm nuk janë në përputhje me kërkesat teknike të parashikuara në pikën 1, të kreut IV, të këtij vendimi;

dh) instalimet e magazinimit nuk janë në përputhje me kërkesat teknike të shtojcës III, të



parashikuara në pikën 2, të kreut V, të këtij vendimi.

KREU X

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Ngarkohen ministria përgjegjëse për mjedisin, ministria përgjegjëse për shëndetësinë, inspektorati përgjegjës për mjedisin dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2018.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA I

KËRKESAT PËR INSTALIMET E MAGAZINIMIT NË TERMINALE

1. Muret e jashtme dhe çatia e depozitave të vendosura mbi tokë lyhen me një ngjyrë që reflekton rrezatimin total të nxehtësisë në masën 70% ose më shumë. Këto funksione mund të programohen për t'u kryer si pjesë e ciklit të zakonshëm të mirëmbajtjes së depozitës, brenda një periudhe 3-vjeçare.

Ministri mund të lejojë përjashtime nga zbatimi i kësaj dispozite kur një gjë e tillë është e nevojshme për mbrojtjen e zonave me peizazh të veçantë, të cilat janë përcaktuar në përputhje me paragrafin 10.1, të këtij vendimi.

Kjo dispozitë nuk zbatohet për depozitat që janë të lidhura me një njësi rikuperimi të avullit, që përputhet me kërkesat e përcaktuara në shtojcën II, pika 2.

2. Depozitat me kapak të jashtëm lundruar pajisen me një guarnicion primar për të mbuluar hapësirën unazore midis murit të depozitës dhe perimetrit të jashtëm të kapakut lundruar dhe me një guarnicion sekondar të vendosur mbi guarnicionin primar. Guarnicionet projektohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë një hermetizim të përgjithshëm të avujve prej 95% ose më shumë se një depozitë e krahasueshme me kapak të palëvizshëm pa kontroll mbi hermetizimin e avullit (kjo është një depozitë me kapak të palëvizshëm dhe vetëm me valvul lëshimi vakum/presion).

3. Të gjitha instalimet e reja të magazinimit në terminale, ku, në përputhje me paragrafin 4, të këtij vendimi, kërkohet rikuperimi i avullit (shiko shtojcën II), duhet të jenë:

a) depozita me kapak të palëvizshëm, të lidhura me njësinë e rikuperimit të avullit, në përputhje me kërkesat e shtojcës II;

b) të projektuara me kapak lundruar, të jashtëm ose të brendshëm, të pajisur me guarnicion primar dhe sekondar, për të përmbushur kërkesat e performancës, të përcaktuara në pikën 2.

4. Depozitat ekzistuese me kapak të palëvizshëm duhet të jenë ose:

a) të lidhura me një njësi rikuperimi të avullit, në përputhje me kërkesat e shtojcës II;

b) të kenë kapak lundruar të brendshëm me guarnicion primar, i cili duhet të projektohet në mënyrë të tillë që të arrijë një hermetizim të përgjithshëm të avujve prej 90%, ose më shumë se një depozitë e krahasueshme me kapak të palëvizshëm, pa kontroll të avullit.

5. Kërkesat për kontrollin e hermetizimit të avullit, të parashikuara në pikat 3 dhe 4, nuk zbatohen në depozitat me kapak të palëvizshëm në terminale, kur magazinimi i ndërmjetëm i avujve është lejuar në përputhje me shtojcën II, pika 1.

SHTOJCA II

KËRKESAT PËR INSTALIMET E NGARKIMIT DHE SHKARKIMIT NË TERMINALE

1. Avujt e zhvendosur nga kontejneri i lëvizshëm, që po ngarkohet, duhet të kthehen, përmes një linje lidhjeje të papërshekueshme nga avulli, në një njësi rikuperimi të avujve, për rikuperim në terminal.

Kjo dispozitë nuk zbatohet për depozitat me ngarkim nga lart, për aq kohë sa lejohet ky sistem ngarkimi.

Në terminalët që ngarkojnë benzinë në anije, njësia e incinerimit të avujve mund të zëvendësohet me një njësi rikuperimi të tyre, në qoftë se rikuperimi i avullit është i pasigurt ose teknikisht i pamundur, për shkak të vëllimit të avullit të kthyer.

Kërkesat në lidhje me shkarkimet në atmosferë, nga njësia e rikuperimit të avullit, zbatohen edhe për njësinë e incinerimit të avullit.

Në terminalët me xhiro vjetore më të vogël se 25 000 ton/në vit, magazinimi i ndërmjetëm i avujve mund të zëvendësohet nga rikuperimi i menjëhershëm i avullit në terminal.

2. Përqendrimi mesatar i avujve në tubin e shkarkimit të njësisë së rikuperimit të avullit, e korrigjuar për hollimin që ndodh gjatë trajtimit, nuk



duhet të kalojë 35 g/metër kub normal (Nm^3), për çdo një orë.

AKM-ja përcakton matjen, metodat e analizës dhe shpeshtësinë e tyre. Matjet duhen bërë gjatë një dite të plotë pune (minimalisht shtatë orë), me xhiro vjetore normale.

Matjet mund të jenë të vazhdueshme ose jo të vazhdueshme. Në qoftë se përdoren matje jo të vazhdueshme, duhet të bëhen, të paktën, katër matje në orë.

Gabimi i përgjithshëm i matjes, për shkak të pajisjes së përdorur, gazit të kalibruar dhe procedurës së përdorur, nuk duhet të kalojë 10% të vlerës së matur.

Pajisja e përdorur duhet të jetë e aftë për matjen e përqendrimeve, të paktën, deri 3 g/ Nm^3 të ulëta.

Precizionin duhet të jetë, të paktën, 95% të vlerës së matur.

3. ISHMP-ja inspekton rregullisht për rrjedhje linjat e lidhjes dhe instalimet e tubave dhe detyron operatorin të marrë masat e nevojshme.

4. Operatorët duhet të sigurojnë që operacionet e ngarkimit të ndalen te krahu i ngarkimit, në rast rrjedhjeje të avullit. Pajisja për operacione të tilla ndaluese instalohet në krahun e ngarkimit.

5. Kur kontejnerët e lëvizshëm lejohen të ngarkohen nga lart, dalja e krahut të ngarkimit duhet të mbahet pranë fundit të kontejnerit të lëvizshëm, me qëllim që të shmangë stërkalat /piklat që hidhen përpjetë gjatë ngarkimit.

SHTOJCA III

KËRKESAT PËR INSTALIMET E NGARKIMIT DHE MAGAZINIMIT NË STACIONET E SHITJES SË KARBURANTEVE DHE TERMINALET KU KRYHET MAGAZINIMI I PËRKOHSHËM I AVUJVE

Avujt e zhvendosur gjatë futjes së benzinës në instalimet e magazinimit të stacioneve të shitjes së karburanteve dhe në cisternat me kapak të palëvizshëm që përdoren për magazinimin e përkohshëm të avujve, duhet të kthehen në kontejnerin e lëvizshëm që shpërndan benzinën përmes një tubi të papërshkueshëm nga avulli. Operacionet e ngarkimit nuk mund të kryhen, po qe se përgatitjet nuk janë bërë dhe funksionojnë siç duhet.

SHTOJCA IV

SPECIFIKIMET PËR NGARKIMIN NGA POSHTË, GRUMBULLIMIN E AVUJVE DHE MBROJTJEN NGA TEJMBUSHJA TË CISTERNAVE PËR TRANSPORT RRUGOR

1. Bashkuesit

1.1 Bashkuesi mbi krahun e ngarkimit duhet të jetë femër dhe të kapet me një përshtatës mashkull API 4 inç (101,6 mm), që ndodhet tek automjeti siç përkufizohet nga: - Praktika 1004 e Rekomanduar nga API, Botimi i Shtatë, nëntor 1988. Ngarkimi nga poshtë dhe rikuperimi i avujve për mjetet motorike me serbator MC-306 (seksioni 2.1.1.1 - Lloji i përshtatësit që përdoret për ngarkimin nga poshtë).

1.2 Bashkuesi që grumbullon avujt në tubin mbajtës të avujve të krahut të ngarkimit duhet të jetë një bashkues femër, Cam and Groove (me kanal shtrëngues), që kapet me një përshtatës mashkull (Cam-and-Groove), 4 -inch (101,6 mm), që ndodhet në mjet siç përcaktohet nga:

- Praktika 1004 e Rekomanduar nga API, botimi i shtatë, nëntor 1988.

Ngarkimi nga poshtë dhe rikuperimi/kthimi i avujve për mjetet motorike me serbator MC-306 (Seksioni 4.1.1.2-përshtatës për rikuperimin /kthimin e avujve).

2. Kushtet e ngarkimit

2.1 Shpejtësia normale e ngarkimit të lëngut duhet të jetë 2 300 litra për minutë (maksimumi 2 500 litra në minutë) për një krah ngarkimi.

2.2 Kur terminali operon në pikun e kërkesës, sistemi i grumbullimit të avujve të krahut të tij të ngarkimit përfshirë njësinë e rikuperimit/kthimit të avujve, lejohet të gjenerojë një kundërpresion maksimal prej 55 milibar në anën e automjeteve të përshtatësit të rikuperimit/kthimit të avujve.

2.3 Të gjitha automjetet e miratuara me ngarkim nga poshtë do të mbajnë një pllakë identifikimi që specifikon numrin maksimal të lejuar të krahëve ngarkues që mund të përdoren njëkohësisht duke siguruar ndërkohë se nuk janë lëshuar avuj përmes valvulave P dhe V të dhomës, kur presioni maksimal i impiantit kthyes është 55 milibar siç specifikohet në 2.2.

3. Lidhja e tokëzuesit të automjetit /detektimi i tejmbushjes

Krahu i ngarkimit duhet të jetë i pajisur me një njësi kontrolli të detektimit të tejmbushjes e cila,



kur lidhet me automjetin, duhet të japë (sigurojë) një sinjal të pranueshëm të një defekti jo të rrezikshëm për të mundësuar ngarkimin, për sa kohë që sensor i tejm bushjes së dhomëzave nuk ka detektuar një nivel të lartë.

3.1 Mjeti duhet të lidhet me njësinë e kontrollit të krahut të ngarkimit përmes një lidhësi standard - industrial elektrik me 10 kontakte. Lidhësi mashkull duhet të montohet në automjet dhe lidhësi femër duhet të bashkëngjitet te një lidhës elektrik shumë kontaktesh, i lidhur te njësia e kontrollit, e montuar në krahun e ngarkimit.

3.2 Detektorët e nivelit të lartë në mjet duhet të jenë ose sensorë termistorë me 2 tela, sensorë optikë me 2 tela, sensorë optikë me 5 tela ose një ekuivalent i pajtueshëm, me kusht që sistemi të jetë i mbrojtur nga defektet. (NB: Termistorët duhet të kenë një koeficient temperature negativ).

3.3 Njësia e kontrollit e krahut të ngarkimit duhet të jetë e përshtatshme për të dy sistemet e automjeteve me 2 dhe 5 tela.

3.4 Mjeti duhet të lidhet me krahun e ngarkimit përmes telit të kthimit të përbashkët të sensorëve të tejm bushjes, i cili duhet të jetë i lidhur për te 10 kontaktëshi në një lidhës mashkull pin 10 përmes shasisë së mjeteve. 10 kontaktëshi, në lidhësin femër duhet të jetë i lidhur me mbulesën e njësisë së kontrollit, e cila duhet të jetë e lidhur me tokëzuesin e krahut të ngarkimit.

3.5 Të gjitha mjetet e miratuara me ngarkim nga poshtë duhet të mbajnë një pllakë identifikimi (shih 2.3), e cila përcakton llojin e sensorëve të instaluar për detektimin e tejm bushjes (d.m.th., me 2 ose 5 tela).

4. Vendndodhja e lidhjeve

4.1 Dizenjimi i pajisjeve të ngarkimit të lëngut dhe rekuperimit të avujve në krahun e ngarkimit duhet të bazohet në paketën/mbështjelljen e lidhjeve të mjetit si më poshtë.

4.1.1 Lartësia e vijës qendrore të përshtatësve të lëngshëm duhet të jetë: maksimumi 1,4 metra (pa ngarkesë), minimumi 0,5 metër (i ngarkuar), lartësia e preferuar 0,7 deri 1,0 metra.

4.1.2 Hapësira horizontale e përshtatësve duhet të jetë jo më pak se 0,25 metra (hapësira minimale e preferuar është 0,3 metra).

4.1.3 Të gjithë përshtatësit e lëngshëm duhet të jenë të vendosur brenda një mbështjellëse që nuk i kalon 2,5 metra gjatësi.

4.1.4 Përshtatësi i tubit të rikuperimit të avujve

duhet të jetë i vendosur mundësisht në të djathtën e përshtatësve të lëngshëm dhe në një lartësi jo më tepër se 1,5 metra (pa ngarkesë), dhe jo më pak se 0,5 metra (me ngarkesë).

4.2 Lidhësi (elektrik), për tokëzuesin /tejm bushjen duhet të vendoset në të djathtë të përshtatësit të lëngut dhe tubit të rikuperimit të avujve dhe në një lartësi jo më tepër se 1,5 metra (pa ngarkesë), dhe jo më pak se 0,5 metër (me ngarkesë).

4.3 Lidhjet e mësipërme duhet të jenë të vendosura vetëm në njërën anë të mjetit.

5. Lidhjet siguruese

5.1 Detektimi i tokëzimit/tejm bushjes

Ngarkimi nuk duhet të lejohet po që se nuk jepet një sinjal lejues nga njësia e kontrollit të kombinuar të tokëzimit/tejm bushjes.

Në rastin e tejm bushjes, ose humbjes së tokëzimit të automjetit, njësia e kontrollit të krahut të ngarkimit duhet të mbyllë valvulën e kontrollit të krahut të ngarkimit.

5.2 Detektimi i grumbullimit të avujve

Ngarkimi nuk duhet të lejohet, po që se tubi i grumbullimit të avullit nuk është lidhur me mjetin dhe nuk ka rrugë të lirë për avujt që spostohen për të kaluar nga mjeti në drejtim të sistemit të impiantit të grumbullimit të avujve.

VENDIM

Nr. 1076, datë 23.12.2015

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. ARBEN DUKA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 932, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2015”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Arben Duka, në masën 262 000 (dyqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.



3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale përkatëse të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 1077, datë 23.12.2015

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR KRIJIMIN, RUAJTJEN DHE
PËRDITËSIMIN E METADATAVE,
STRUKTURËN E KATALOGIMIT DHE
AFATET E KRIJIMIT TË METADATAVE
SPECIFIKE PËR ÇDO TEMË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 13, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e metadatave, strukturën e katalogimit dhe afatet e krijimit të metadatave specifike për çdo temë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e rregullores, duhet të nxjerrë udhëzues teknik të detajuar për profilin e metadatave për krijuesit dhe përdoruesit.

3. Autoritetet përgjegjëse, sipas përcaktimeve të nenit 12, të ligjit nr. 72/2012, marrin masat për krijimin e metadatave përkatëse brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e rregullores.

4. Për temat, për të cilat nuk ekziston informacion gjeohapësinor, autoritetet publike përgjegjëse për krijimin, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore, depozitojnë pranë ASIG-ut, sipas përcaktimeve të nenit 12, të ligjit nr. 72/2012, të dhënat gjeohapësinore dhe metadatat përkatëse të krijuara në përputhje me këtë rregullore dhe

udhëzuesin teknik të përgatitur nga ASIG-u, sipas afateve të përcaktuara nga ky i fundit.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe autoritetet përgjegjëse sipas neneve 11 e 12, të ligjit nr. 72/2012, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLORE
PËR KRIJIMIN, RUAJTJEN DHE
PËRDITËSIMIN E METADATAVE,
STRUKTURËN E KATALOGIMIT DHE
AFATET E KRIJIMIT TË METADATAVE
SPECIFIKE PËR ÇDO TEMË

KREU I
TË PËRGJITHSHME

1. Fusha e veprimit

Kjo rregullore përcakton rregulla të hollësishme për krijimin, ruajtjen, përditësimin, dhe katalogimin e metadatave për të dhënat gjeohapësinore, grupet e të dhënave gjeohapësinore si dhe shërbimet e të dhënave gjeohapësinore për temat e listuara në nenin 11 të ligjit nr. 72/2012, datë 28.6.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe për çdo temë tjetër të miratuar me VKM.

2. Përkufizime

- “ASIG” - Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor

“Autoritet përgjegjës” - Autoritete publike sipas neneve 2, 12, të ligjit nr. 72/2012, datë 28.6.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.

- “Metadata” është informacioni që përshkruan të dhënat, grupet e të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimet që lidhen me to, të cilat mundësojnë zbulimin, inventarizimin dhe përdorimin e të dhënave e të grupeve të të dhënave gjeohapësinore.

- “Vlera domain” nënkupton përshkrimin e vlerave të lejuara të një atributi.

- “Varg karakteresh” nënkupton vlerën domain e elementeve të metadatës e shprehur si një grup karakteresh të cilat trajtohen si një njësi e vetme.



- “Text i lirë” nënkupton vlerën domain të një elementi të metadatës të shprehur në një ose më shumë gjuhë natyrore.

- “Çikli i jetës” nënkupton historinë e një grupi të dhënash, ciklin e jetës së tyre nga mbledhja përdorimi dhe përditësimi i tyre deri në formën aktuale, në përputhje me EN ISO 19101.

- “Element i metadatës” nënkupton një njësi diskrete të metadatës, në përputhje me EN ISO 19115.

- “Listë emrash” nënkupton një koleksion emrash, të identifikuar nga një Burim Identifikues Uniform (URI) i referencës, të cilat janë përdorur në gjuhën (XML) të dokumenteve si emrat e elementeve dhe atributet e tyre.

- “Cilësi” është tërësia e karakteristikave të një produkti që lidhet me aftësinë e saj për të kënaqur nevojat e deklaruara dhe të nënkuptuara, në përputhje me EN ISO 19101,

- “Të dhëna gjeohapësinore” është çdo e dhënë që i referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë një vendi ose zone gjeografike të veçantë

- “Grup të dhënash gjeohapësinore” nënkupton një koleksion të identifikueshëm të dhënash gjeohapësinore.

- “Shërbime për informacionin gjeohapësinor” janë operacionet që mund të realizohen, përmes aplikacioneve kompjuterike, për informacionin gjeohapësinor, të dhënat dhe grupet e të dhënave gjeohapësinore ose për metadatat që lidhen me to

3. Referencat për vlefshmërinë e të dhënave dhe grupeve të të dhënave gjeohapësinore do të adresohet në elementet e mëposhtme:

- Gama e hapësirës dhe kohës që i përkasin të dhënat,

- Nëse performanca e të dhënave është kontrolluar bazuar në një standard të caktuar.

- Shkalla në të cilën të dhënat janë të përshtatshme për qëllimin e kërkuar.

- Vlefshmëria ligjore e të dhënave gjeohapësinore.

KREU II

ELEMENTET E METADATAVE

1. Identifikimi

Elementet e mëposhtëm të metadatave janë të domosdoshëm:

Titulli i burimit:

Kjo karakteristikë është unike, shpreh emrin me të cilin burimi është i njohur.

Vlera domain e këtij elementi të metadatës është teksti i lirë.

1.2. Abstrakti i burimit:

Kjo është një përmbledhje e shkurtër që tregon përmbajtjen e burimit.

Vlera domain e këtij elementi të metadatave është teksti i lirë.

1.3. Tipi i burimit:

Ky është lloji i burimit të përshkruar nga metadata.

Vlera domain e këtij elementi të metadatave është përcaktuar në kreun IV.

1.4. Lokalizuesi i burimit:

Lokalizuesi i burimit/ve përcakton lidhjen për burimet ose informacion shtesë në lidhje me burimet.

Vlera domain e këtij elementi të metadatës është një varg karakteresh (URL)

1.5. Identifikuesi unik i burimit:

Një vlerë unike për identifikimin e burimit.

Vlera domain e këtij elementi të metadatës është një kod i detyrueshëm, varg karakteresh, i caktuar nga administratori (poseduesi i të dhënave) dhe një “namespace” varg karakteresh unike për identifikimin dhe kontekstin e kodit identifikues (për shembull, poseduesi i të dhënave).

1.6. Burimi i çiftëzuar:

Nëse burimi është një shërbim të dhënash gjeohapësinore kjo metadatë identifikon elemente, aty ku është e nevojshme, me objekt shërbimin e të dhënave gjeohapësinore, përmes identifikuesit unik të burimit.

Vlera domain e këtij elementi të metadatës është një kod i detyrueshëm, varg karakteresh, i caktuar nga administratori (poseduesi i të dhënave) dhe një “namespace” varg karakteresh unike për identifikimin dhe kontekstin e kodit identifikues (për shembull, poseduesi i të dhënave).

1.7. Gjuha e burimit:

Gjuha/ët e përdorura në burim.

Vlera domain e këtij elementi të metadatës është e kufizuar në gjuhët e përcaktuara në ISO 639-2.

2. Klasifikimi i të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore

2.1. Kategoria tema:

Kategoria tema është një skemë klasifikimi e nivelit të lartë për të ndihmuar në kërkimin dhe



grupimin e të dhënave gjeohapësinore mbi një bazë të disponueshme të burimit/eve të të dhënave.

Vlera domain e këtij elementi të metadatës është përcaktuar në kreun IV, pika 2

2.2. Lloji i të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore:

Ky është një klasifikim për të ndihmuar në kërkimin e të dhënave dhe shërbimeve të të dhënave të disponueshme gjeohapësinore. Një shërbim i veçantë do të kategorizohet vetëm në një kategori.

Vlera domain e këtij elementi të metadatës është përcaktuar në kreun IV, pika 3.

3. Fjalët kyçe

Nëse burimi është një shërbim i të dhënave gjeohapësinore, do të ofrohet të paktën një emërtim i kreut IV, pika 4.

Në qoftë se burimi është një e dhënë gjeohapësinore apo një grup të dhënash gjeohapësinore do të përdoret të paktën një fjalë kyçe, e cila përshkruan temën përkatëse për të dhënat gjeohapësinore të përcaktuara në nenin 11, të ligjit nr. 72/2012.

Për çdo fjalë kyçe, do të ofrohen elementet e mëposhtëm të metadatës:

3.1. Vlera e fjalës kyçe:

Vlera e fjalës kyçe është zakonisht një fjalë apo një frazë gjuhësore e formalizuar për të përshkruar temën. Kategoria tema është shumë e përgjithshme për pyetje të detajuara ndaj fjala kyçe do të ndihmojë për një kërkim të plotë të tekstit e do të na lejojë për një kërkim më të strukturuar.

Vlera domain e këtij elementi të metadatës është teksti i lirë.

3.2. Origjina e fjalorit të kontrolluar:

Nëse vlera e fjalës kyçe e ka origjinën nga një fjalor i kontrolluar (enciklopedi, ontologji), citimi i origjinës së fjalorit të kontrolluar është detyrueshëm. Ky citim duhet të përfshijë të paktën titullin dhe një datë reference (data e publikimit, data e rishikimit të fundit ose e krijimit) të origjinës.

4. Vendndodhja gjeografike

Kërkesa për vendndodhjen gjeografike, të përmendur në nenin 3, pika 9, të ligjit nr. 72/2012, do të shprehet me elementin “Kutiza e kornizës gjeografike” të metadatës.

4.1 Kjo është shkalla e saktësisë në hapësirën gjeografike, të dhënë si një kuti kornizë e cila duhet të shprehet me koordinata, në gradë dhjetore, me një saktësi prej të paktën dy decimale. (Bazuar në kornizën referuese gjeodezike shqiptare “KRGJSH 2010”).

5. Referenca kohore

Ky element i metadatës adreson kërkesën që të ketë informacion mbi dimensionin kohor të të dhënave siç referohet në nenin 18, të ligjit nr. 72/2012. Së paku një nga elementet e metadatës të përmendura në pikat 5.1 deri 5.4 do të ofrohen në këtë rast.

Vlera domain e elementeve të metadatës të përmendura në pikat 5.1 deri 5.4 është një grup i afateve kohore. Çdo datë do t'i referohet një sistemi referimi kohor dhe do të shprehet në një formë të përputhshme me atë sistem. Sistemi i referencës së parazgjedhur do të jetë kalendari gregorian, me datat e shprehura në përputhje me ISO 8601.

5.1. Dimensioni Kohor:

Shtrirja kohore e cila përcakton periudhën kohore të mbuluar nga përmbajtja e burimit. Ky afat mund të shprehet në një nga format që vijnë:

- një datë e përcaktuar;
- një interval kohor me datën e fillimit dhe mbarimit të intervalit;
- një përzierje e datave të veçanta dhe intervaleve kohore.

5.2. Data e publikimit:

Kjo është data e publikimit të burimit kur ekziston ose nga data e hyrjes në fuqi. Nuk mund të jetë më shumë se një data publikimi.

5.3. Data e rishikimit të fundit:

Kjo është data e rishikimit të fundit të burimit, nëse burimi është rishikuar. Nuk do të ketë më shumë se një datë të rishikimit të fundit.

5.4. Data e krijimit:

Kjo është data e krijimit të burimit. Nuk do të ketë më shumë se një datë të krijimit të burimit të metadatës

6. Cilësia dhe vlefshmëria

Kërkesat e përmendura në nenin 23, të ligjit nr. 72/2012, në lidhje me cilësinë dhe vlefshmërinë e të dhënave gjeohapësinore duhet të adresohen nga elementet në vijim të metadatës:

6.1. Cikli i Jetës:



Kjo është një deklaratë në historinë e procesit dhe/ose cilësinë e përgjithshme të të dhënave gjeohapësinore. Kur është e përshtatshme kjo mund të përfshijë një deklaratë nëse cilësia dhe siguria e të dhënave janë vërtetuar, nëse version i disponueshëm është versioni zyrtar (nëse ekzistojnë versione të shumta), dhe nëse ai ka vlefshmëri ligjore.

Vlera domain e këtij elementi të metadatës është teksti i lirë.

6.2. Rezolucioni gjeohapësinor:

Rezolucioni gjeohapësinor i referohet nivelit të detajeve të të dhënave gjeohapësinore. Ajo duhet të shprehet si një vlerë zero për rezolucionin e distancës (tipike për të produktet që rrjedhin nga imazhet) ose në shkallë ekuivalente (tipike për hartat apo produktet hartografike).

Një shkallë ekuivalente shprehet në përgjithësi si një vlerë numerike të plotë duke e shprehur shkallën në emërues.

Një distance rezolucioni shprehet si një vlerë numerike lidhur me një njësi të gjatësisë.

7. Konformiteti

Kërkesat e përmendura në nenin 3, pika 15, të ligjit nr. 72/2012, në lidhje me ndërveprueshmërinë, dhe shkallën e përputhshmërisë, me zbatimin e rregullave të ndërveprueshmërisë do të adresohen nga elementet në vijim të metadatave.

7.1. Specifikimi:

Ky është një citim i rregullave zbatuese të miratuara në bazë të nenit 18, të ligjit nr. 72/2012 dhe udhëzimet teknike të dala në zbatim të tyre. Ky citim do të përfshijë të paktën titullin dhe një datë reference (data e publikimit, data e rishikimit të fundit ose e krijimit) të VKM-së “Mbi rregullat e ndërveprueshmërisë”, dhe VKM-së për miratimin e standardit përkatës.

7.2. Shkalla e konformitetit:

Kjo është shkalla e konformitetit të të dhënave apo grupeve të të dhënave gjeohapësinore.

Vlera domain e këtij elementi të metadatës është përcaktuar në kreun IV, pika 5.

8. Kufizime në lidhje me aksesin dhe përdorimin

Metadata duhet të përshkruajë kufizimet në lidhje me aksesin dhe përdorimin të cilat mund të jenë secila ose të dyja së bashku:

- një sërë kushtesh që aplikohen për të hyrë dhe përdorur (8.1);

- një sërë kufizimesh për akses publik (8.2).

8.1. Kushtet që zbatohen për aksesin dhe përdorimin:

Ky element i metadatës përcakton kushtet për akses dhe shfrytëzim të të dhënave gjeohapësinore, grupeve të të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore, dhe ku janë të aplikueshme, si dhe tarifat përkatëse siç përcaktohet në nenin 26, të ligjit nr. 72/2012.

Vlera domain e këtij elementi të metadatës është teksti i lirë.

Elementi është i detyrueshëm të ketë vlerë. Nëse nuk ka kushte që zbatohen për aksesin dhe përdorimin e burimeve, duhet të citohet “nuk ka kushte për akses”. Nëse kushtet janë të panjohura, duhet të citohet “kushte të panjohura”.

Ky element gjithashtu duhet të japë informacion për tarifat e nevojshme për të hyrë dhe për të përdorur burimin, nëse ka tarifa, ose i referohet një lokalizuesi uniform të burimit (URL) ku informacioni mbi tarifat është në dispozicion.

8.2. Kufizimet në aksesin publik:

Kur autoriteti përgjegjës do të kufizojë aksesin e publikut në të dhënat gjeohapësinore, grupet e të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimet e të dhënave gjeohapësinore. Sipas përcaktimeve të nenit 25, të ligjit nr. 72/2012, ky element i metadatës do të japë informacion mbi kufizimet dhe arsyet për to. Nëse nuk ka kufizime për aksesin publik, ky element i metadatës do të tregojë këtë fakt.

Vlera domain e këtij elementi të metadatës është teksti i lirë.

9. Autoritetet përgjegjëse për krijimin, ruajtjen, përditësimin dhe shpërndarjen e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore

Për qëllimet e neneve 2 dhe 12, të ligjit nr. 72/2012, do të ofrohen dy elementet në vijim për metadatat:

9.1 Pala përgjegjëse:

Ky është përshkrimi i autoritetit përgjegjës për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore i cili duhet të përfshijë:

- emrin e autoritetit përgjegjës si tekst i lirë;



- një adresë e-maili të kontaktit si një varg karakteresh.

9.2 Roli i palës përgjegjëse:

Ky është roli i autoritetit përgjegjës për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore.

Vlera domain e këtij elementi të metadatës është përcaktuar në kreun IV, pika 6.

10. Metadata për metadatat

Për qëllimet e neneve 11 dhe 12, të ligjit nr. 72/2012, do të ofrohen elementet e mëposhtme të metadatave:

10.1 Pika e kontaktit të metadatës:

Ky është përshkrimi i autoritetit përgjegjës për krijimin mirëmbajtjen dhe administrimin e metadatës i cili duhet të përfshijë.

- emrin e autoritetit përgjegjës, si tekst i lirë;
- një adresë e-maili të kontaktit, si një varg karakteresh.

10.2 Data e metadatës:

Data e cila specifikon kur metadata është krijuar ose përditësuar. Kjo datë duhet të shprehet në përputhje me ISO 8601.

10.3 Gjuha e metadatës:

Kjo është gjuha në të cilën janë shprehur elementet e metadatës.

Vlera domain e këtij elementi të metadatës është e kufizuar në gjuhët e përcaktuara në ISO 639-2.

11. Sistemi koordinativ

Përcakton Sistemin Koordinativ Referencë në të cilën janë të dhënat gjeohapësinore, grupet e të dhënave gjeohapësinore si dhe shërbimet e të dhënave gjeohapësinore.

Vlera domain e këtij elementi të metadatës është teksti i lirë.

KREU III

INSTRUKSIONE MBI

SHUMËLLOJSHMËRINË DHE KUSHTET E ELEMENTEVE TË METADATËS

Metadata që përshkruan një burim që do të përmbahet një të dhënë gjeohapësinore ose një

grupi të dhënash gjeohapësinore, përbëhet nga elementet e metadatës ose një grup elementesh të metadatës të listuar në tabelën 1 ndërsa metadata që përshkruan një shërbim të dhënash gjeohapësinore përbëhet nga elementet e metadatës ose një grup elementesh të metadatës të listuar në tabelën 2.

Këto elemente ose grupe elementesh të metadatës duhet të jenë në përputhje me shumëllojshmërinë e parashikuar dhe kushtet përkatëse të paraqitura në tabelat 1 dhe 2.

Kur nuk është shprehur asnjë kusht në lidhje me një element specifik të metadatës, atëherë ai element është i detyrueshëm.

Tabelat paraqesin informacionin e mëposhtëm:

- Kolona e parë paraqet referencën në kreun II, duke përcaktuar elementin ose grupin e elementeve të metadatës.

- Kolona e dytë paraqet emrin e elementit ose grupit të elementeve të metadatës.

- Kolona e tretë specifikon shumëllojshmërinë e elementeve të metadatës. Shprehja e shumëllojshmërisë ndjek logjikën e shumëllojshmërisë së gjuhës së unifikuar të modelimit (UML) në të cilën:

- 1 do të thotë se duhet të ketë vetëm një instancë të këtij elementi të metadatës në rezultat.

- 1.. * do të thotë se duhet të ketë të paktën një instancë të këtij elementi në rezultat.

- 0..1 tregon se prezenca e këtij elementi të metadatës në rezultat është e kushtëzuar por mund të ndodhë vetëm një herë.

- 0.. * tregon se prezenca e këtij elementi të metadatës është e kushtëzuar por mund të ndodhë një herë ose më shumë.

- Kur shumëllojshmëria është 0..1 ose 0.. * kushtet përcaktojnë kur elementet e metadatës janë të mandatuara.

- Kolona e katërt përmban shprehje të kushteve kur shumëllojshmëria e elementit nuk i përkon të gjithë tipave të burimeve. Gjithë elementet janë të detyrueshme në kushte të ndryshme.



Tabela 1. Metadata për të dhëna dhe grupe të dhënash gjeohapësinore

Referenca	Elementet e metadatës	Shumëllojshmëria	Kushtet
1.1	Titulli i burimit	1	
1.2	Abstrakti i burimit	1	
1.3	Tipi i burimit	1	
1.4	Lokalizuesi i burimit	0..*	E detyrueshme n.q.s. një URL është e vlefshme për të marrë më shumë informacion mbi burimin dhe/ose shërbimet lidhur me aksesimin.
1.5	Identifikuesi unik i burimit	1..*	
1.7	Gjuha e burimit	0..*	E detyrueshme n.q.s. burimi përmban informacion të tipit tekst.
2.1	Kategoria e temës	1..*	
3	Fjalë kyçe	1..*	
4.1	Kuti e kornizës gjeografike	1..*	
5	Referenca kohore	1..*	
6.1	Cikli i jetës	1	
6.2	Rezolucioni gjeohapësinor	0..*	E detyrueshme për të dhëna ose grupe të dhënash n.q.s. një shkallë ekuivalence ose rezolucioni mund të specifikohet.
7	Përputhshmëria	1..*	
8.1	Kushtet e aksesimit dhe përdorimit	1..*	
8.2	Kufizimi për aksesin publik	1..*	
9	Autoriteti përgjegjës	1..*	
10.1	Pika e kontaktit të metadatës	1..*	
10.2	Data e metadatës	1	
10.3	Gjuha e metadatës	1	
11	Sistemi Koordinativ	1..*	

Tabela 2. Metadata për shërbimet gjeohapësinore

Referenca	Elementet e metadatës	Shumëllojshmëria	Kushtet
1.1	Titulli i burimit	1	
1.2	Abstrakti i burimit	1	
1.3	Tipi i burimit	1	
1.4	Lokalizuesi i burimit	0..*	E detyrueshme n.q.s. lidhja me shërbimin është e mundur
1.6	Burim i çiftëzuar	0..*	E detyrueshme n.q.s. lidhja me të dhënat mbi të cilat shërbimi operon është e mundur
2.2	Tipi i shërbimit të të dhënave gjeohapësinore	1	
3	Fjalë kyçe	1..*	
4.1	Kutia e kornizës gjeografike	0...*	E detyrueshme për shërbime me përmbajtje të përcaktuar gjeografike
5	Referenca kohore	1..*	
6.2	Rezolucioni gjeohapësinor	0..*	E detyrueshme kur ka një kufizim në rezolucionin hapësinor për këtë shërbim.
7	Përputhshmëria	1..*	



8.1	Kushtet për aksesim dhe përdorim	1..*	
8.2	Kufizimet për aksesin publik	1..*	
9	Autoriteti përgjegjës	1..*	
10.1	Pika e kontaktit të metadatës	1..*	
10.2	Data e metadatës	1	
10.3	Gjuha e metadatës	1	
11	Sistemi Koordinativ	1..*	

KREU IV

VLERAT “DOMAIN” DHE KATALOGIMI I METADATAVE

Për vlerat ku specifikohen elementet e metadatës të përcaktuara në kreun II, vlerat domain të përshkruara në këtë kre nga pika 1 deri në pikën 6, duhet të përdoren sipas kombinimeve të shprehura në tabelat 1 dhe 2 të kreut III.

Në lidhje me një temë të caktuar, secila vlerë përcaktohet nga:

- një identifikues numerik;
- një emër tekstual;
- një emër neutral gjuhësor për kompjuterë (vlera e shprehur në kllapa);
- një përshkrim opsional apo përkufizim.

1. Llojet e burimeve

1.1 Të dhënat gjeohapësinore (të dhënat)

1.2 Grupet e të dhënave gjeohapësinore (grupet e të dhënave)

1.3 Shërbimet e të dhënave apo grupe gjeohapësinore (shërbimet)

2. Përputhshmëria e EN ISO 19115 me temat e nenit 11 të ligjit nr. 72/2012

2.1. Fermat bujqësore - Rritja e kafshëve dhe/ose kultivimi i bimëve. Kjo kategori vlen për temën q) “Infrastruktura bujqësore dhe akuakultura” të nenit 11 të ligjit nr. 72/2012.

2.2. Biota - Flora dhe / ose fauna në mjedisin natyror. Kjo kategori vlen për temën xh) “Shpërndarja e specieve” të nenit 11 të ligjit nr. 72/2012.

2.3. Kufijtë- Juridiksioni territorial. Kjo kategori vlen për temën d) “Kufijtë e njësive administrative” dhe temën k) “Njësitet statistikore” të nenit 11 të ligjit nr. 72/2012.

2.4. Klimatologjia/ meteorologjia/ atmosfera. Proceset dhe fenomenet e atmosferës. Kjo kategori vlen për temën sh) “Kushtet atmosferike” dhe temën t) “Meteorologjia” të nenit 11 të ligjit nr. 72/2012.

2.5. Ekonomia – Aktivitetet ekonomike në fushën e energjisë dhe minierave. Kjo kategori vlen për temën y) “Burimet energjitike” dhe temën z) “Burimet minerare” të nenit 11 të ligjit nr. 72/2012.

2.6. Lartësia- Lartësia mbi ose nën nivelin e detit. Kjo kategori vlen për temën gj) “Modeli dixhital i terrenit” të nenit 11 të ligjit nr. 72/2012.

2.7. Mjedisi - Burimet e mjedisit, mbrojtja dhe ruajtja e tij. Kjo kategori vlen për temën g) “Zonat e mbrojtura” të nenit 11 të ligjit nr. 72/2012.

2.8. Informacioni gjeoshkencor- Informacioni në lidhje me shkencat e tokës. Kjo kategori vlen për temën j) “Gjeologjia” dhe temën s) “Zonat me rreziqe natyrore” të nenit 11 të ligjit nr. 72/2012.

2.9. Shëndeti- Shëndeti, shërbimet shëndetësore dhe siguria shëndetësore. Kjo kategori vlen për temën n) “Shëndeti inxhëzve dhe siguria e tij” të nenit 11 të ligjit nr. 72/2012.

2.10. Imazhi i hartës bazë / Mbulesa e tokës- Kjo kategori vlen për temën i) “Ortoimazheria” dhe temën h) “Mbulesa e tokës” të nenit 11 të ligjit nr. 72/2012.

2.11. Inteligjenca Ushtarake - Bazat ushtarake, strukturat dhe aktivitetet e tyre. Kjo kategori nuk zbatohet në mënyrë specifike për ndonjë nga temat nenit 11 të ligjit nr. 72/2012.

2.12. Ujërat - Karakteristika të burimeve ujore, sistemet e kullimit dhe karakteristikat e tyre. Kjo kategori vlen për temën f) “Hidrografia” të nenit 11 të ligjit nr. 72/2012

2.13. Emërtimet gjeografike dhe vendndodhja. Kjo kategori vlen për temën c) “Emërtimet gjeografike” dhe temën dh) “Sistemi i adresave” të nenit 11 të ligjit nr. 72/2012.

2.14. Oqeanet. Karakteristikat dhe kushtet fizike të oqeanëve. Kjo kategori vlen për temën u) “Detet” të nenit 11 të ligjit nr. 72/2012.



2.15 Kadastra dhe planifikimi - Informacion i cili përdoret për veprime të që kanë të bëjnë me përdorimin dhe statusin juridiktë tokës. Kjo kategori vlen për temën e) “Parcelat kadastrale”, temën m) “Përdorimi i tokës” dhe temën rr) “Zonat me përdorim të kufizuar” të nenit 11 të ligjit nr. 72/2012.

2.16. Shoqëria - Karakteristikat e shoqërisë dhe kulturave shoqërore. Kjo kategori vlen për temën r) “Demografia” të nenit 11 të ligjit nr. 72/2012.

2.17. Strukturat ndërtimore - Objekt të ndërtuara nga njeriu për qëllime të ndryshme. Kjo kategori vlen për temën l) “Ndërtesat”, temën o) “Infrastruktura për monitorimin e mjedisit” dhe temën p) “Infrastruktura industriale” të nenit 11 të ligjit nr. 72/2012.

2.18. Transporti - Infrastruktura dhe rrjetet për transportin e njerëzve dhe mallrave. Kjo kategori vlen për temën ë) “Rrjetet e transportit” të nenit 11 të ligjit nr. 72/2012.

2.19. Shërbimet/komunikimi - Shërbimet qeveritare që kanë të bëjnë me energjinë, ujën, pastrimin/infrastruktura e shërbimeve. Kjo kategori vlen për temën nj) “Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare” të nenit 11 të ligjit nr. 72/2012.

3. Llojet e shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore

3.1. Shërbimi i Kërkimit (zbulimit)- Shërbim që bën të mundur kërkimin e të dhënave gjeohapësinore, grupet e të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimet për të dhënat gjeohapësinore në bazë të përmbajtjes së metadatës korresponduese dhe për të shfaqur përmbajtjen e metadatave

3.2. Shërbimi i konsultimit (pamjes) - Shërbime me anë të të cilave bëhet e mundur minimalisht shfaqja, lundrimi, zmadhimi apo zvogëlimi, shtresëzimi i grupeve të të dhënave gjeohapësinore që shfaqen dhe shfaqja e legjendës së informacionit dhe të çdo përmbajtjeje relevante të metadatës;

3.3. Shërbimi i shkarkimit (daunlodimi) - Shërbim që mundëson shkarkimin e kopjeve ose pjesëve të grupeve të të dhënave gjeohapësinore dhe, kur është rasti, aksesit i drejtpërdrejtë në to.

3.4. Shërbimi për transformimin (transformimi) - Shërbim që mundëson cilave transformimin i grupeve të të dhënave gjeohapësinore, me qëllim realizimin e ndërveprueshmërisë.

3.5. Shërbimi i evokimit (thirrjes) - Shërbim që mundëson evokimin e shërbimeve për të dhënat, grupet e të dhënave dhe shërbimet gjeoha-pësinore.

3.6. Shërbime të tjera

4. Klasifikimi i shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore

Fjalët kyçe janë të bazuara në taksonominë e shërbimeve gjeografike të EN ISO 19119. Kjo taksonomi është e organizuar në kategori dhe nënkategori ku nënkategoritë përcaktojnë vlerën domain të shërbimeve të klasifikimit të të dhënave gjeohapësinore

4.1 Shërbime gjeografike të ndërveprimit njerëzor (humanInteractionService)

Kjo kategori përfshin nënkategoritë e mëposhtme:

4.1.1 Observuesi i katalogut (human Catalogue Viewer) - Shërbim klienti që lejon një përdorues të ndërveprojë me një katalog të lokalizuar, të kërkojë dhe të administrojë metadatat rreth të dhënave gjeografike dhe shërbimeve gjeografike

4.1.2 Observuesi gjeografik (human Geographic Viewer)- Shërbim klienti që lejon një përdorues të shikoj një ose më shumë mbledhje karakteristikash ose mbulime.

4.1.3 Observuesi gjeografik i faqes elektronike (human Geographic Spreadsheet Viewer) - Shërbim klienti që lejon një përdorues të ndërveprojë me disa objekte të dhënash dhe të kërkojë llogaritje të ngjashme me një faqe elektronike aritmetike por të shtrirë në të dhëna gjeografike.

4.1.4 Shërbim shtimi (human Service Editor) - Shërbim klienti që lejon një përdorues të kontrollojë shërbimet e përpunimeve gjeografik.

4.1.5 Zinxhiri (human Chain Definition Editor) - Siguron ndërveprim përdoruesi me një shërbim zinxhiri përcaktimi.

4.1.6 Administratori i aprovimit të fluksit (HumanWorkflowEnactmentManager) - Siguron ndërveprim të përdoruesit me një shërbim për aprovimin të fluksit të punës.

4.1.7 Editori i karakteristikave gjeografike (humanGeographicFeatureEditor) - Observuesi gjeografik që lejon një përdorues të ndërveprojë me karakteristikat e të dhënave.

4.1.8 Editori i simboleve gjeografike (human Geographic Symbol Editor) - Shërbim klienti



që lejon një përdorues të zgjedhë dhe administrojë simbole librarie.

4.1.9 Editori i karakteristikave përgjithësuese (humanFeatureGeneralizationEditor) - Shërbim klienti që lejon një përdorues të ndryshojë (modifikojë) karakteristikat hartografike të një karakteristike ose grupi karakteristikash duke thjeshtëzuar pamjen e tij, duke ruajtur elementet e tij të spikatur - ekuivalenti hapësinor i thjeshtëzimit.

4.1.10 Observuesi i strukturës së të dhënave gjeografike (human Geographic Data Structure Viewer). Shërbim klienti që lejon një përdorues të aksesojë një pjesë të të dhënës për të parë strukturën e saj të brendshme.

4.2 Shërbim i administrimit të modeleve/informacionit gjeografik (info Management Service)

Kjo kategori përfshin nënkategoritë e mëposhtme:

4.2.1 Shërbim i aksesimit të karakteristikave (infoFeatureAccessService) - Shërbim që i lejon një klienti të ketë akses për të administruar një grupi karakteristikash.

4.2.2 Shërbim i aksesimit të hartës (infoMapAccessService) - Shërbim që i mundëson një klienti aksesimin e një grafike gjeografike, p.sh., imazhe të të dhënave gjeografike.

4.2.3 Shërbim i aksesimit (hapjes) së mbulimit (info Coverage Access Service) - Shërbim që i mundëson një klienti aksesimin për dhe administrimin e një grupi mbulimi.

4.2.4 Shërbim i përshkrimit të sensorëve (info Sensor Description Service) - Shërbim që ofron përshkrimin e një sensori mbulimi, duke përfshirë sensor vendndodhjeje dhe orientimi, si dhe karakteristikat gjeometrike, dinamike dhe radiometrike të sensorit për qëllime gjeo-procesimi.

4.2.5 Shërbim i aksesimit të produktit (info Product Access Service) - Shërbim që ofron akses dhe administrim të një depozite produktesh gjeografike.

4.2.6 Shërbim për llojet e karakteristikave (info Feature Type Service) - Shërbim që i ofron klientit aksesim dhe administrim të një mbledhjeje e llojeve të përcaktimit

4.2.7 Shërbimi i katalogut (info Catalogue Service) - Shërbim që ofron shërbime zbulimi dhe administrimi në një grup metadash rreth

shembujve (fakteve).

4.2.8 Shërbim i regjistrimit (info Registry Service) - Shërbim që ofron akses te një grup metadash rreth tipave.

4.2.9 Shërbim informues (info Gazetteer Service) - Shërbim që ofron akses në një direktori të nënklasave të një klase apo klasave të fenomeneve të botës reale të cilat përmbajnë disa informacione në lidhje me pozicionin.

4.2.10 Shërbim i menaxhimit të porosive (info Order Handling Service) - Shërbim që i ofron klientit mundësinë të porositë produkte nga një furnitor.

4.2.11 Shërbim i kontrollit të statusit (info Standing Order Service) - Shërbim për menaxhimin e porosive që lejon një përdorues të kërkojë që një produkt që ndodhet në një zonë të caktuar gjeografike të shpërndahet pasi të jetë në dispozicion.

4.3 Shërbimet e menaxhimit të detyrës (task Management Service)

Kjo kategori përfshin nënkategoritë e mëposhtme:

4.3.1 Shërbimi zinxhir i përcaktimit (chain Definition Service) - Shërbim për të përcaktuar një zinxhir dhe për ta mundësuar atë të ekzekutohet nga shërbimi i miratimit të fluksit të punës.

4.3.2 Shërbim i miratimit të fluksit të punës (workflow Enactment Service) - Shërbimi i miratimit të fluksit të punës interpreton një zinxhir dhe kontrollon instalimin e shërbimeve dhe renditjes së aktiviteteve

4.3.3 Shërbimi i regjistrimit (subscription Service)- Shërbim që lejon klientët të regjistrohen për njoftime rreth ngjarjeve.

4.4 Shërbimet e përpunimit gjeohapësinor (spatial Processing Service)

Kjo kategori përfshin nënkategoritë e mëposhtme:

4.4.1 Shërbim i konvertimit të koordinatave (spatial Coordinate Conversion Service) - Shërbim për të ndryshuar koordinatat nga një sistem Koordinativ në një tjetër që është i lidhur me të njëjtën projeksion.

4.4.2 Shërbim i transformimit të kordinatave (spatial Coordinate Transformation Service) - Shërbim për të ndryshuar koordinatat nga një sistem referimi koordinatash bazuar në një projeksion te një sistem referimi koordinatash në



një projektion të dytë.

4.4.3 Shërbim i konvertimit të mbulimit / vector(spatial Coverage Vector Conversion Service) - Shërbim për të ndryshuar përfaqësimin hapësinor nga një skemë mbulimi në një skemë vektori, ose anasjelltas

4.4.4 Shërbim i konvertimit të koordinatave të imazhit (spatial Image Coordinate Conversion Service) - Shërbim konvertimi të koordinatave ose transformimi të koordinatave për të ndryshuar sistemin e referimit për një imazh.

4.4.5 Shërbim korrigjimi (spatial Rectification Service) - Shërbim për transformimin e një imazhi në projektion paralel ortogonal dhe rrjedhimisht në një shkallë konstante.

4.4.6 Shërbim i korrigjimit të ortofotos (spatial Orthorectification Service) - Një shërbim korrigjimi që eliminon animimin e imazhit dhe zhvendosjen për shkak të relievit të terrenit.

4.4.7 Shërbim i korrigjimit të gjeometrisë së elementeve gjeohapësinore (spatialSensor GeometryModelAdjustmentService) - Shërbimi që korrekton modelet e sensorëve gjeometrik në mënyrë që të përmirësojë lidhjen e imazheve me imazhe të tjera dhe/ose me pikat e njohura të terrenit.

4.4.8 Shërbim i konvertimit të gjeometrisë së imazhit gjeohapësinor (spatialImage Geometry Model Conversion Service) - Shërbim që konverton modelet e sensorëve gjeometrik në një tjetër por në të njëjtin model të sensorëve gjeometrik.

4.4.9 Shërbim i nën vendosjes (spatial Subsetting Service) - Shërbim që nxjerr të dhëna të vazhdueshme, nga një burim në një rajon gjeohapësinor, qoftë nga vendndodhja gjeografike ose nga rrjeti koordinativ.

4.4.10 Shërbim i shembullit (spatial Sampling Service) - Shërbim që nxjerr të dhëna nga një burim, duke përdorur një skemë konstante shembujsh qoftë nga vendndodhja gjeografike ose nga rrjeti Koordinativ.

4.4.11 Shërbim i ndryshimit të mbulesës (spatial Tiling Change Service) - Shërbim që ndryshon mbulesën e të dhënave gjeografike

4.4.12 Shërbim i matjes së dimensioneve (spatial Dimension Measurement Service) -

Shërbim për të llogaritur dimensione të objekteve të dukshëm në një imazh ose në të dhëna të tjera gjeografike.

4.4.13 Shërbime të manipulimit të karakteristikave (spatial Feature Manipulation Service) - Regjistron një karakteristikë të tjetra, një imazh, ose një tjetër grup të dhënash ose koordinatash, duke korrigjuar ndryshime relative ndërrimi, diferenca alternative, diferenca në shkallë dhe diferenca perspektive. Verifikon që të gjitha karakteristikat në koleksion janë topologjikisht konstante sipas rregullave të topologjisë së koleksionit të tipareve, dhe identifikon dhe/ose korrekton mospërputhjet që zbulohen

4.4.14 Shërbim i lidhjes së karakteristikave (spatial Feature Matching Service) - Shërbim që përcakton se cila karakteristikë dhe pjesë e karakteristikave përfaqëson të njëjtën entitet nga bota e vërtetë nga disa burime të dhënash, si p.sh., lidhje e skajeve dhe....

4.4.15 Shërbim i përgjithësimit të karakteristikës (spatial Feature Generalization Service) - Shërbim që zvogëlon variacionin hapësinor në një grup karakteristikash për të rritur efektivitetin e komunikimit duke iu kundërvënë efekteve të padëshiruara të reduktimit të të dhënave.

4.4.16 Shërbim i përcaktimit të itinerarit (spatial Route Determination Service) - Shërbim për të përcaktuar rrugën më të mirë midis dy pikave të specifikuar bazuar mbi parametrat e të dhënave dhe vetitë që janë në koleksionin e tipareve.

4.4.17 Shërbimi i pozicionimit (spatial Positioning Service) - Shërbim i siguar nga një pajisje pozicionimi për përdorim, e cila shumë qartësisht interpreton informacionin e pozicionit, dhe përcakton në qoftë se rezultatet arrijnë kërkesat për përdorim

4.4.18 Shërbim i analizës së përafërt (spatial Proximity Analysis Service) - Duke na u dhënë një pozicion ose karakteristike gjeografike, gjejmë të gjithë objektet me një grup atributesh të dhëna që janë të lokalizuar brenda pozicionit apo karakteristikës të specifikuar nga përdoruesi.

4.5 Shërbimi i përpunimit tematik (thematic Processing Service)

Kjo kategori përfshin nënkategoritë e mëposhtme:



4.5.1 Shërbim për llogaritjen e parametrit (thematic Goparameter Calculation Service) - Shërbim me anë të të cilit mund të nxjerrim rezultatet sasiore të aplikimit të kërkuar, që nuk janë në dispozicion nga vetë të dhënat e papërpunuara. Shërbim që gjeneron rezultate kuantitative të drejtuara drejtë aplikacionit, të cilat nuk janë të mundura të merren nga të dhënat e papërpunuara.

4.5.2 Shërbimi i klasifikimit të temave (thematic Classification Service) - Shërbim për të klasifikuar të dhëna rajonale gjeografike bazuar në attribute tematike. Shërbim për klasifikimin e rajoneve të të dhënave gjeografike duke u bazuar në atributet e temave

4.5.3 Shërbim i përgjithësimit të tiparit tematik (i grumbullimit të vetive) (thematic Feature Generalization Service) - Shërbim që përgjithëson lloje funksionesh në një koleksion funksionesh për të rritur efektivitetin e komunikimit dhe ulur efektet negative të reduktimit të të dhënave. Shërbim që grumbullon tipat e vetive në një koleksion vetish për të rritur efektivitetin e komunikimit duke luftuar efektet e padëshirueshme të reduktimit të të dhënave

4.5.4 Shërbimi i filtrimit (thematic Subsetting Service) - Shërbim që nxjerr të dhëna nga një burim duke u bazuar në vlerat e disa parametrave.

4.5.5 Shërbimi i numërimit gjeohapësinor (thematic Spatial Counting Service)- Shërbim që numëron vetitë gjeografike.

4.5.6 Shërbim i zbulimit (dedektimit) të ndryshimeve (thematic Change Detection Service) - Shërbim për të gjetur dallimet mes dy grupeve të të dhënave që përfaqësojnë të njëjtën zonë gjeografike në kohë të ndryshme. Shërbim për të gjetur ndryshimet midis dy data seteve që paraqesin të njëjtën zonë gjeografike në kohë të ndryshme.

4.5.7 Shërbimi i marrjes së informacionit gjeografik (thematic Geographic Information Extraction Service) - Shërbime që ndihmojnë në marrjen e informacionit mbi terrenin dhe vetitë e tij nga imazhe të largëta dhe të skanuara.

4.5.8 Shërbimi i përpunimit të imazhit (thematic Image Processing Service) - Shërbim për të ndryshuar vlerat e attributeve tematike të një imazhi duke përdorur një funksion matematikor. Shërbim për të ndryshuar vlerat e

attributeve të temave të një imazhi duke përdorur funksione matematike.

4.5.9 Shërbimi i gjenerimit me rezolucion të ulët (thematic Reduced Resolution Generation Service)- Shërbim që redukton rezolucionin e një imazhi.

4.5.10 Shërbim i manipulimit të imazhit (thematic Image Manipulation Service) - Shërbime për manipulimin e vlerave të të dhënave në një imazh: ndryshim i ngjyrave dhe kontrastit, vendosja e filtrave të ndryshëm, manipulimi i rezolucionit të imazhit, heqja e deformimeve të imazhit, korrigjime sistematike-radiometrike, ndryshime në ndriçim etj.

4.5.11 Shërbime për kuptimin e imazhit (thematic Image Understanding Service) - Shërbime që ofrojnë dedektim automatik të ndryshimit të imazhit, regjistrim të diferencës së imazhit, shfaqja dhe analizë të rëndësishme të diferencës, diferencim bazuar mbi zonë dhe model.

4.5.12 Shërbime të sintezës së imazhit (thematic Image Synthesis Service) - Shërbim për krijimin ose transformimin e imazhit duke përdorur modele gjeohapësinore kompjuterike, transformime në perspektivë, dhe manipulime të karakteristikave për të përmirësuar shikueshmërinë, mprehtësi e rezolucionit, dhe /ose reduktimi i mbulimit të faktorëve atmosferikë (reve dhe mjegullës)

4.5.13 Manipulimi i imazhit multiband (thematic Multiband Image Manipulation Service)- Shërbim që modifikon një imazh duke përdorur bandat e imazhit

4.5.14 Shërbimi i zbulimit të objektit (për dedektimin e imazhit) (thematic Object Detection Service)- Shërbim për të zbuluar objekte të botës reale në një imazh. Shërbim për detektimin e objekteve reale në një imazh

4.5.15 Shërbimi i analizës gramatikore të gjeoinformacionit (thematic Geoparsing Service) - Shërbim që skanon dokumente tekst për referenca bazuar mbi pozicionin, të tilla si emra vendesh, adresa, kode postare etj. duke i përgatitur për kalim të shërbimi i gjeokodimit.

4.5.16 Shërbimi i gjeokodimit (thematic Geocoding Service)- Shërbim që përmbush referencat tekst të bazuara mbi pozicionin me koordinata gjeografike (ose referenca të tjera gjeohapësinore)



4.6 Shërbimet e përpunimit gjeografik kohor (temporal Processing Service)

Kjo kategori përfshin nënkategoritë e mëposhtme:

4.6.1 Shërbim për transformimin e sistemit të referencës kohore (temporal Reference System Transformation Service) - Shërbim për të ndryshuar vlerat e instancave kohore nga një sistem referimi kohor në një sistem tjetër referimi kohor.

4.6.2 Shërbim filtrues (temporal Subsetting Service) - Shërbim që filtron të dhënat nga një burim në intervale të vazhdueshme bazuar në vlerat e pozicionimit kohor.

4.6.3 Shërbimi i marrjes së mostrave (temporal Sampling Service) - Shërbim që merr të dhënat nga një burim duke përdorur skema të qëndrueshme mostrash bazuar në vlerat e pozicionimit kohor

4.6.4 Shërbim i analizës së përafrimit kohor (temporal Proximity Analysis Service) - Duke u dhënë një interval kohor ose ngjarje, të gjenden të gjithë objektet me një atribut të caktuar që janë të lokalizuara brenda një intervali të specifikuar nga përdoruesi.

4.7 Shërbimet e përpunimit gjeografik të metadatave (metadata Processing Service)

Kjo kategori përfshin nënkategoritë e mëposhtme:

4.7.1 Shërbim për llogaritjen statistikore (metadata Statistical Calculation Service) - Shërbim për të llogaritur statistikën e një grupi të dhënash.

4.7.2 Shërbim për shënimet gjeografike (metadata Geographic Annotation Service) - Shërbim që shton informacion ndihmës për një imazh apo një veti në një koleksion vetish.

4.8 Shërbimet e komunikimit gjeografik (Comservice).

Kjo kategori përfshin nënkategoritë e mëposhtme:

4.8.1 Shërbime Kodimi (com Encoding Service) - Shërbim që ofron implementimin e rregullave të kodimit dhe ofron një ndërfaqe për funksionalitetet e kodimit dhe dekodimit

4.8.2 Shërbim i transferimit (com Transfer Service) - Shërbim që ofron implementimin e një ose më shumë protokolleve të transportit, që lejojnë të dhënat të transferohen midis sistemeve të shpërndara të informacionit mbi

linja komunikimi online ose offline.

4.8.3 Shërbimi i kompresimit gjeografik (com Geographic Compression Service) - Shërbim që konverton pozicione gjeografike të një grupi vetish në formë të kompresuar dhe anasjelltas.

4.8.4 Shërbimi për konvertimin e formatit (com Geographic Format Conversion Service) - Shërbim që konverton nga një format në një tjetër të dhënat gjeografike.

4.8.5 Shërbimi i mesazheve (com Messaging Service) - Shërbimi që i lejon disa përdorues të shikojnë, komentojnë dhe modifikojnë një grup vetish njëkohësisht.

4.8.6 Menaxhimi i informacionit në largësi (com Remote File And Executable Management) - Shërbim që mundëson aksesin e klientit në një memorie sekondare për vetitë gjeografike në mënyrë virtuale (sikur të ndodhej aty)

5. Shkalla e konformitetit

5.1 Konformant - Burimi është plotësisht konformant me specifikimet e miratuara.

5.2 Jokonformant - Burimi nuk përputhet me specifikimet e miratuara.

5.3 Nuk vlerësohet - Shkalla e konformitetit nuk është vlerësuar.

6. Rolet dhe përgjegjësitë

6.1 Ofruesi i të dhënave - Pala që mbledh (ofron) informacionin.

6.2 Kujdestari - Pala që pranon llogaridhënien dhe përgjegjësinë për të dhënat dhe siguron kujdesin dhe mirëmbajtjen e burimeve të përshtatshme.

6.3 Pronari - Pala që zotëron ose porosit informacionin gjeohapësinor sipas legjislacionit në fuqi (autoriteti përgjegjës për temën përkatëse).

6.4 Përdoruesi - Pala që përdor informacionin gjeohapësinor të publikuar.

6.5 Shpërndarësi - Pala që shpërndan informacionin.

6.6 Krijues - Pala që ka krijuar informacionin.

6.7 Pika e kontaktit (point Of Contact) - Pala që mund të kontaktohet për marrjen e informacionit në lidhje me burimin e të dhënave e shërbimeve apo përditësimin e tyre (personi i kontaktit të autoritetit përgjegjës për temën përkatëse).

6.8 Investigues kryesor - Pala përgjegjëse për hulumtimin e metodologjisë së mbledhjes së informacionit.



6.9 Përpunuesi - Pala që ka përpunuar të dhënat nëse burimi është modifikuar.

6.10 Botuesi -Pala që ka publikuar informacionin.

6.11 Autori -Autoriteti Përgjegjës për temën sipas nenit 11 të ligjit nr. 72/2012.

KREU V

METADATAT SPECIFIKE PËR ÇDO TEMË

Autoritetet publike përgjegjëse për krijimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave gjeohapësinore, të parashikuara në nenin 12 të ligjit nr. 72/2012, në bashkëpunim me ASIG-un, krijojnë, mbledhin dhe përditësojnë metadatat për të dhënat gjeohapësinore, grupet e të dhënave gjeohapësinore dhe shërbimet e të dhënave gjeohapësinore, sipas kësaj rregulloreje, për temat e mëposhtme:

1. Sistemet e rrjeteve gjeografike;
2. Emërtimet gjeografike;
3. Imazhi i hartës bazë;
3. Kufijtë e njësive administrative;
5. Sistemin e adresave;
6. Parcelat kadastrale;
7. Rrjetet e transportit;
8. Hidrografinë;
9. Zonat e mbrojtura(mjedisore dhe trashëgimisë kulturore);
10. Modelin dixhital të terrenit;
11. Mbulesën e tokës;
12. Ortoimazherinë;
13. Gjeologjinë;
14. Njësitë statistikore;
15. Nndërtesat;
16. Pedologjinë;
17. Përdorimin e tokës;
18. Shëndetin e njerëzve dhe sigurinë e tij;
19. Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare;
20. Infrastruktura për monitorimin e mjedisit;
21. Infrastruktura industriale;
22. Infrastruktura bujqësore dhe akua-kulturën;
23. Demografinë;
24. Zonat me përdorim të kufizuar;
25. Zonat me rreziqe natyrore;
26. Kushtet atmosferike;
27. Meteorologjinë;
28. Hidrologjinë;

29. Detet;

30. Zonat ekologjike;

31. Habitatet;

32. Shpërndarjen e specieve;

33. Burimet energjetike;

34. Burimet minerare.

VENDIM

Nr. 1079, datë 23.12.2015

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA SHPËRBLIM, TË NJË SIPËRFAQEJE PREJ 371 M², NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË AUTORITETIT SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOPAPËSINOR (ASIG), QENDRËS “PROTIK”, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 901 e vijues, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim, pa shpërblim, të sipërfaqes prej 371 (treqind e shtatëdhjetë e një) m², të zyrave të katit të parë të ndërtesës “Godina e Inovacionit”, me numër pasurie 1/12, zona kadastrale 8160, rruga “Papa Gjon Pali II”, nr. 3, në përgjegjësi administrimi të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), qendrës “PROTIK”, Tiranë, për një afat prej 2 vitesh, sipas planimetrisë në aneksin 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Autorizohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor të lidhë aktmarrëveshje me qendrën “PROTIK”, Tiranë, për marrjen përsipër, nga ASIG-u, të mbulimit të shpenzimeve për shërbimet utilitare që i nevojiten qendrës “PROTIK”, Tiranë, në këto ambiente.


3. Vendimi nr. 647, datë 19.9.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për dhënie në përdorim, pa shpërblim, të një sipërfaqeje prej 371.41m², në përgjegjësi administrimi të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, qendrës “PROTIK”, Tiranë,” shfuqizohet.



4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



VENDIM

Nr. 1080, datë 23.12.2015

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 10.11.2015, PËR ÇËSHTJEN “SHARRA DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË” (PËR ANKIMET NR. 25038/08, 64376/09, 64399/09, 347/10, 1376/10, 4036/10, 12889/10, 20240/10, 29442/10, 29617/10, 33154/11 DHE 2032/12)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 10.11.2015,

për çështjen “Sharra dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, për ankimet nr. 25038/08 (Sharra), nr. 64376/09 (Xibinaku dhe të tjerë), nr. 64399/09 (Frashëri), nr. 347/10 (Maçi), nr. 1376/10 (Çoka), nr. 4036/10 (Dvorani dhe Dume), nr. 12889/10 (Asllani), nr. 20240/10 (Agolli), nr. 29442/10 (Talipi/Peshkëpia), nr. 29617/10 (Katë), nr. 33154/11 (Vrioni) dhe nr. 2032/12 (Lelo), sipas listës së ankuesve, në shtojcën 1, dhe shumat e përcaktuara në shtojcën 2, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Ekzekutimin, në zbatim të vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të vendimeve të komisioneve të kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve, për aplikimet nr. 33154/11 (Vrioni) dhe nr. 347/10 (Maçi).

3. Vlerat e përcaktuara si detyrim, gjatë ekzekutimit të këtij vendimi, të konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

4. Vlerat e përcaktuara si detyrim, në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohen në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 10.11.2015, për secilën çështje.



5. Pagimi i shumave të depozituara, sipas përcaktimeve në pikën 3, të këtij vendimi, në favor të ankuesve të çështjes “Sharra dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, për ankimet nr. 25038/08 (Sharra), nr. 64376/09 (Xibinaku dhe të tjerë), nr. 64399/09 (Frashëri), nr. 1376/10 (Çoka), nr. 4036/10 (Dvorani dhe Dume), nr. 12889/10 (Asllani), nr. 20240/10 (Agolli), nr. 29442/10 (Talipi/Peshkëpia), nr. 29617/10 (Kati), dhe nr. 2032/12 (Lelo), të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave nga fondi i kontingjencës, brenda një afati 3-mujor, nga dita kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.

6. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të

përmendur në pikën 5, të këtij vendimi, mbi shumat e mësipërme të paguhen interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

7. Efektet financiare, të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi, të përballohen nga fondi i kontingjencës i buxhetit të shtetit.

8. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA 1 LISTA E APLIKANTËVE

Nr.	Çështja dhe numri	Emri i aplikuesve (viti i lindjes)	Vendbanimi	Përfaqësuar nga:	Data e prezantimit
1.	<i>Sharra</i> , nr. 25038/08	Zamira Sharra (1956)	Shqipëri	A. Brovina, avokat	15 maj 2008
2.	<i>Xibinaku dhe të tjerë</i> nr. 64376/09	<i>Miriam Xibinaku (1948)</i> <i>Sanie Kaceli (1948)</i> <i>Miron Nuri (1952)</i> <i>Qeriman Nuri (1935)</i> <i>Malfor Nuri (1964)</i> <i>Erina Llapaj (1952)</i> <i>Liliana Llapaj (1956)</i> <i>Nermin Harxhi (1957)</i> <i>Edmond Harxhi (1959)</i> <i>Shpresa Tartari (1940)</i> <i>Mirgjin Tartari (1941)</i> <i>Behare Tartari (1953)</i> <i>Enjana Tartari (1980)</i> <i>Stela Tartari (1983)</i> <i>Ledi Tartari (1991)</i> <i>Mirjane Tartari (1955)</i> <i>Arlind Tartari (1982)</i> <i>Ariona Tartari (1986)</i>	Shqipëri Kanada Shqipëri Itali SHBA Shqipëri Itali Shqipëri	S. Puto, avokat	4 dhjetor 2009
3.	<i>Frashëri</i> , nr. 64399/09	<i>Tarik Shkrelli (1950)</i> <i>Fiqirete Frashëri (1930)</i> <i>Hajri Frashëri (1951)</i> <i>Hysref Frashëri (1956)</i> <i>Ilona Ziso (1962)</i> <i>Naide (Nabide) Shkodra (1929)</i> <i>zëvendësobët nga trashëgimtarët e saj</i> <i>Rozafa Çabej Shkodra dhe Valbona</i> <i>Mardodaj Çabej Shkodra dhe</i> <i>Valbona Mardodaj Shkodra</i>	Shqipëri	S. Puto, avokat	4 dhjetor 2009
4.	<i>Maçi</i> , nr. 347/10	<i>Musa Maçi (1934)</i> <i>Kujtim Maçi (1943) gjithashtu</i> <i>përfaqësor Gjorgia dall'Olmo (Maçi)</i> <i>(1925),</i> <i>Roberto Maçi (1948),</i> <i>Alessandro Maçi (1955) dhe</i> <i>Tomor Maçi (1937))</i>	Shqipëri Shqipëri Itali	A. Tartari, avokat	13 dhjetor 2009
5.	<i>Çoka</i> , nr. 1376/10	<i>Sotir Çoka (1932)</i> <i>Tefia Çoka (1938)</i> <i>Teodor Çoka (1964)</i> <i>Arben Çoka (1960)</i>	Shqipëri	S. Puto and A. Memi Prifti, avokatë	22 dhjetor 2009



6.	<i>Dvorani dhe Dume</i> , nr. 4036/10	<i>Shpëtim Dvorani (1938)</i> <i>Valter Dvorani (1952)</i> <i>Pranvera Dvorani Begleri (1954)</i> <i>Diana Dvorani Qyteti (1958)</i> <i>Gurie Dvorani Starova (1925)</i> <i>zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj</i> <i>Lejla Ago Belli (1944)</i> <i>Sijetillana Dume (1949)</i> <i>Besa Dume (1952)</i> <i>Fatbardha Dume (1954)</i>	Shqipëri	S. Puto, avokat	23 dhjetor 2009
7.	<i>Asllani</i> , nr. 12889/10	<i>Albert Asllani (1939)</i>	Shqipëri	S. Dodbiba, avokat	5 shkurt 2010
8.	<i>Agolli</i> , nr. 20240/10	<i>Tefta Agolli (1931)</i> zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj <i>Ilir Shijaku (1950)</i> dhe <i>Deshira Keta Shijaku (1954)</i> <i>Arben Agolli (1957)</i> <i>Sokol Agolli (1951)</i> <i>Kreshnik Agolli (1956)</i> <i>Ganimet Agolli (1931)</i> <i>Ajferdita Agolli (1954)</i> <i>Elira Agolli (1963)</i> <i>Semira Agolli (1935)</i> <i>Artur Agolli (1958)</i> <i>Valbona Permeti Agolli (1963)</i> <i>Flutura Agolli (1946)</i> <i>Parid Agolli (1979)</i>	Shqipëri	A. Hajdari and A. Brovina, avokat	6 pPrill 2010
9.	<i>Talipi (Peshkëpia)</i> , nr. 29442/10	<i>Barilhyll Talipi (Peshkëpia) (1946)</i>	SHBA	S. Dodbiba, avokat	10 prill 2010
10.	<i>Kati</i> , nr. 29617/10	<i>Fabian Kati (1963)</i> <i>Anila Kati (1956)</i>	Shqipëria	A. Hajdari dhe A. Brovina, avokat	20 maj 2010
11.	<i>Vrioni</i> , nr. 33154/11	<i>Turhan Vrioni (1944)</i>	Shqipëria	A. Tartari, avokat	11 maj 2011
12.	<i>Lelo</i> , nr. 2032/12	<i>Ervin Lelo (1974)</i>	Shqipëria	S. Puto, avokat	19 dhjetor 2011

SHTOJCA 2

SHPËRBLIMI

Nr.	Aplikimi dhe numri	Dëmi pasuror dhe dëmi jopasuror	Kostot dhe shpenzimet
1.	<i>Sharra</i> , nr. 25038/08	191,400 euro (njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind)	850 euro (tetëqind e pesëdhjetë)
2.	<i>Xibinaku dhe të tjerë</i> , nr. 64376/09	87,000 euro (tetëdhjetë e shtatë mijë).	
3.	<i>Frashëri</i> , nr. 64399/09	670,000 euro (gjashtë qind e shtatëdhjetë mijë)	850 euro (tetëqind e pesëdhjetë)
4.	<i>Maçi</i> , nr. 347/10	Nuk ka ankesa (ankesat jashtë afatit)	Asnjë (nuk ka pretendime)
5.	<i>Çoka</i> , nr. 1376/10	2,331,400 euro (dy milionë e treqind e tridhjetë e një mijë e katërqind)	850 euro (tetëqind e pesëdhjetë)
6.	<i>Dvorani dhe Dume</i> , nr. 4036/10	748,900 euro (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind)	850 euro (tetëqind e pesëdhjetë)
7.	<i>Asllani</i> , nr. 12889/10	106,300 euro (njëqind e gjashtë mijë e treqind)	Asnjë (nuk është paraqitur faturë)
8.	<i>Agolli</i> , nr. 20240/10	732,450 euro (shtatëqind e tridhjetë e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë)	850 euro (tetëqind e pesëdhjetë).
9.	<i>Talipi (Peshkëpia)</i> , nr. 29442/10	19,300 euro (nëntëmbëdhjetë mijë e treqind)	Asnjë (nuk është paraqitur faturë)
10.	<i>Kati</i> , nr. 29617/10	235,200 euro (dyqind e tridhjetë e pesë mijë e dyqind)	850 euro (tetëqind e pesëdhjetë)
11.	<i>Vrioni</i> , nr. 33154/11	Asnjë (pretendimet jashtë afatit)	Asnjë (nuk ka pretendime)
12.	<i>Lelo</i> , nr. 2032/12	258,200 euro (dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind)	550 euro (pesëqind e pesëdhjetë)

**VENDIM****Nr. 1082, datë 24.12.2015****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 920, DATË 18.11.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MBYLLJEN E AGJENCISË SË KËRKIMIT, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT (AKTI)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të vendimit nr. 920, datë 18.11.2015, të Këshillit të Ministrave, fjalët “...fillon efektet nga data 1 janar 2016.” zëvendësohen me “...i fillon efektet në çastin e ngritjes e të funksionimit të institucionit të ri, sipas ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 1086, datë 28.12.2015****PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE, NGA KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËR KRIJIMIN E NJË FONDI NDIHME, NË KUADËR TË INICIATIVËS SË KËSHILLIT TË BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EVROPËS (CEB), “PËR FINANCIMIN E QENDRAVE TRANSITE DHE TË PRITJES PËR VENDET EVROPIANE QË PRESIN REFUGJATË DHE EMIGRANTË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, dhe neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e ndihmës financiare, nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, për krijimin e një fondi ndihme, në kuadër të iniciativës së Këshillit të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës (CEB), “Për financimin e qendrave transite dhe të pritjes për vendet evropiane që presin refugjatë dhe emigrantë”, në shumën 100 000 (njëqind mijë) euro.

2. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, në programin buxhetor 01120, “Mbështetje diplomatike jashtë shtetit”, shpenzime korrente, t’i shtohet kundërvlera në lekë e fondit prej 100 000 (njëqind mijë) eurosh, për t’u përdorur si ndihmë financiare për qendrat transite dhe të pritjes për vendet evropiane që presin refugjatë dhe emigrantë.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2015.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 1087, datë 28.12.2015****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (Lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:



Në listën e shkronjës “C”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, çregjistrohet individ i renditur në shkronjën “a”, të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për organizatën Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRO-RIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (“LISTA E OKB-së”)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA

a) Lista e ndryshuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”;

RAFIK; MOHAMAD; YOUSEF.

1. Shënim. Gjeneralitetet e tjera për personin emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahet në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

VENDIM

Nr. 1091, datë 28.12.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 212, DATË 11.3.2015, “PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR MINISTRINË E FINANCIVE, PËR PAGESËN E SHËRBIMEVE JURIDIKE PËR PËRFAQËSIMIN DHE MBROJTJEN NË ÇËSHTJEN E ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR ICC NO. 20447/MHM S2 ALBANIA SHPK DHE RAPISCAN SYSTEMS INC. KUNDËR REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 dhe 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të

ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shuma në pikën 1, të vendimit nr. 212, datë 11.3.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhet 645 000 (gjashtëqind e dyzet e pesë mijë) euro.

2. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi i kontingjencës, miratuar për vitin 2015.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 1093, datë 28.12.2015

PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE, KRITEREVE DHE PËRPARËSIVE PËR DHËNIEN E BONUSIT TË STREHIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1/1, të nenit 14, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e procedurave, kritereve dhe përparësive për dhënie e bonusit të strehimit nëpërmjet fondeve të buxhetit të shtetit, sipas shtojcës që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Përparësi në përfitimin e bonusit të strehimit, me fondet e buxhetit të shtetit, kanë kategoritë e përcaktuara në pikën 2, të nenit 24, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar, si më poshtë vijon:

a) Personat me statusin e jetimit;

b) Personat me aftësi të kufizuar, të cilët trajtohen në mbështetje të vendimit nr. 526, datë 6.8.2014, “Për kategoritë e personave me aftësi të kufizuara që trajtohen me përparësi nga programet sociale të strehimit”;

c) Familjet e policëve të rënë në detyrë;

ç) Familjet e komunitetit rom;

d) Emigrantët e rikthyer;



dh) Punëtori emigrant;

e) Punonjësit e Policisë së Shtetit.

3. Përfitues të bonusit të strehimit janë të gjitha njësitë e qeverisjes vendore që aplikojnë pranë ministrisë që mbulon çështjet e strehimit, bazuar në aplikimin e tyre për:

a) kërkesat e paraqitura për banesa sociale me qira;

b) mundësitë financiare të njësive të qeverisjes vendore;

c) listën e miratuar me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore për familjet përfituese, me vlerën respektive financiare të bonusit.

4. Njësitë e qeverisjes vendore, të cilat paraqesin kërkesën për bonus strehimi pranë ministrisë që mbulon çështjet e strehimit, duhet të plotësojnë kriteret, si më poshtë vijon:

a) Nuk disponojnë në pronësi banesa sociale me qira ose, nëse ka të tilla, t'u jenë shpërndarë përfituesve;

b) Të argumentojnë se buxheti vjetor i tyre nuk është i mjaftueshëm për të financuar bonusin e strehimit;

c) Kanë mundësi të financojnë bonusin e strehimit, por pagesa që duhet të bëjë familja, për diferencën ndërmjet qirasë së tregut dhe vlerës së bonusit, kalon 30 për qind të të ardhurave të familjes.

5. Njësitë e qeverisjes vendore llogaritin vlerën e bonusit të strehimit që financohet nga ministria që mbulon çështjet e strehimit, bazuar në përcaktimet e nenit 15 dhe shtojcës B, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar.

6. Njësitë e qeverisjes vendore, brenda datës

30 janar, të çdo viti, paraqesin pranë ministrisë që mbulon çështjet e strehimit kërkesat për bonus strehimi, sipas shtojcës A, të këtij vendimi, të shoqëruar me kostot financiare për çdo familje, si dhe listën e detajuar të familjeve përfituesve.

7. Ministria që mbulon çështjet e strehimit trajton kërkesat për bonus strehimi, të depozituara nga njësitë e qeverisjes vendore, në mbështetje të kriterëve të përcaktuara në pikat 3, 4 dhe 6, të këtij vendimi.

8. Ministria që mbulon çështjet e strehimit financon bonusin e strehimit, të barabartë me diferencën ndërmjet qirasë minimale në tregun e lirë, bonusit të financuar nga njësia e qeverisjes vendore dhe qirasë së përballeshme nga familja, në rastet kur diferenca ndërmjet qirasë së tregut dhe vlerës së bonusit kalon 30 për qind të të ardhurave të familjes.

9. Ministria që mbulon çështjet e strehimit, brenda muajit mars, të çdo viti, planifikon fondet për vitin pasardhës, për bonusin e strehimit, bazuar në tavanet vjetore, të përcaktuara në projektbuxhetin afatmesëm, kërkesat vjetore të njësive të qeverisjes vendore si dhe përcaktimeve të nenit 14, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar.

10. Ngarkohen ministria që mbulon çështjet e strehimit dhe njësitë e qeverisjes vendore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA A

Nr.	Emri, mbiemri i përfituesit	VKB që e ka miratuar	Kategoria sipas nenit 24 pika 2	Qiraja mujore në tregun e lirë	Të ardhurat mujore të familjes/lekë (sipas rastit)	Bonusi i qirasë nga buxheti i bashkisë / muaj ($\leq 50\%$ e qirasë së tregut)	% e bonusit nga buxheti i shtetit	Vlera vjetore e bonusit që kërkohet nga buxheti i shtetit ($\leq 50\%$ e pjesës së mbetur të qirasë pas bonusit nga bashkia)
1	2	3	4	5	6	$5-6*0.3$		$5*12*50\%$
1			Jetim		Ndihmë ekonomike		50%	
2			PAK		30000			



3			Familjet e policëve të rënë në detyrë		10000			
	TOTAL							

VENDIM**Nr. 1095, datë 28.12.2015**

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË
BASHKËRENDIMIT TË PUNËS,
NDËRMJET ALUIZNI-t DHE ZQRPP-së,
DHE TË PROCEDURAVE APO
KUFIZIMEVE QË ZBATOHEN PËR
EFEKT TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE
TË LEGALIZUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 30, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. RREGULLAT DHE PROCEDURAT E SHKËMBIMIT TË INFORMACIONIT NDËRMJET ALUIZNI-T DHE ZRPP-SË

1. ALUIZNI dhe ZRPP-ja bashkërendojnë aktivitetin, për:

a) verifikimin e gjendjes juridike të pronës ku janë ngritur ndërtimet informale;

b) përmirësimin/përditësimin e regjistrit të pasurive të paluajtshme, kartelave dhe hartave kadastrale, sipas blloqeve kadastrale ku janë ngritur ndërtimet informale;

c) regjistrimin e lejes së legalizimit dhe të pasurisë së legalizuar.

2. Kërkesa për informacion, për verifikimin e gjendjes juridike të pronës (statusit juridik), dërgohet nga ALUIZNI pranë ZVRPP-së, jo më vonë se 10 ditë nga data e evidentimit faktik në terren (data e “Procesverbalit të evidentimit në terren”) dhe shoqërohet nga harta vektoriale në format shkresor dhe elektronik.

3. ZVRPP-ja, brenda 15 ditëve nga administrimi i kërkesës, dërgon informacionin mbi gjendjen juridike të pronave në bllokun kadastral, në të cilin përfshihen:

a) të dhënat mbi pronarin e pasurisë,

b) harta kadastrale, në format shkresor dhe elektronik,

c) kartelat.

4. Informacioni mbi gjendjen juridike shërben vetëm për përcaktimin e titullarit të së drejtës së pronësisë, mbi parcelën ndërtimore të objektit informal, dhe për procedurën e kualifikimit, vetëm për ndërtimin informal që gjendet në kushtet e nenit 35, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

5. Kur ZVRPP-ja nuk dërgon informacion, sipas përcaktimeve të pikës 3, ALUIZNI vijon procedurat administrative për legalizimin e ndërtimit, duke kërkuar regjistrimin e tij, sipas krerëve II e III, të këtij vendimi.

6. Kur zona kadastrale nuk i është nënshtruar regjistrimit fillestar dhe poseduesi i ndërtimit nuk disponon dokumentacion që provon pronësinë mbi truallin, ALUIZNI vijon procedurat e kalimit të së drejtës së pronësisë, si në rastin e ndërtimeve informale të ngritura mbi truall “shtet”.

7. Përcaktimet e pikës 6, të këtij vendimi, në asnjë rast nuk cenojnë të drejtën e pronarit joposedues të truallit për kompensim, sipas nenit 15/1, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar. Nëse, gjatë procedurave të regjistrimit fillestar, ka pretendime pronësie mbi truallin, të mbështetura mbi tituj më të hershëm se leja e legalizimit, atëherë ZVRPP-ja i kërkon ALUIZNI-t hartimin e propozimeve për procedurat e kompensimit për pronarin joposedues.

8. Përcaktimet e pikave 5 e 6 nuk zbatohen për territoret ku dokumentet e miratuara të planifikimit të territorit parashikojnë ngritjen e ndërtimeve mbi gjashtë kate.

II. PARAQITJA E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E LEJES SË LEGALIZIMIT

9. Kërkesa për shërbimin e regjistrimit të lejes së legalizimit dhe për lëshimin e certifikatës së pronësisë, për pasurinë e legalizuar, paraqitet nga ALUIZNI, në emër të përfituesit të lejes, sipas formularit të kërkesës, të miratuar nga ZRPP-ja.



10. Kërkesa për regjistrim paraqitet në ZVRPP nga ALUIZNI, brenda 5 ditëve nga data e miratimit të lejes së legalizimit, dhe shoqërohet me dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- a) Leje legalizimi;
- b) Genplan i pasurisë së legalizuar, si fragment i hartës vektoriale të bllokut kadastral;
- c) Planimetri e ndërtimit informal (për çdo kat);
- ç) Kopje e certifikatës së gjendjes familjare të poseduesit, që disponon ALUIZNI, nga momenti i aplikimit për legalizim.

11. Në rastin kur poseduesi i ndërtimit të legalizuar gjendet në kushtet e nenit 16, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, apo kur ka lidhur me ALUIZNI-n kontratën e kalimit të pronësisë mbi parcelën ndërtimore, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, bashkë me dokumentacionin e pikës 10, të këtij vendimi, pranë ZVRPP-së dërgohet edhe dokumentacioni i pronësisë mbi parcelën ndërtimore.

12. Trajtimi i kërkesës së paraqitur nga ALUIZNI, sipas pikës 10, të këtij vendimi, nuk i nënshtrohet afateve dhe procedurave standarde, të përcaktuara në vendimin nr. 376, datë 6.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurën e lëshimit të dokumenteve nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

III. PROCEDURAT E REGJISTRIMIT TË LEJES SË LEGALIZIMIT

13. Regjistruesi, me paraqitjen e kërkesës, sipas pikës 10, të këtij vendimi, kryen, brenda 10 ditëve, regjistrimin e lejes së legalizimit, në përputhje me nenin 49, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Përcaktimi nëse pasuria (objekti i legalizuar) është individuale, familjare apo në bashkëpronësi (I/F/B) kryhet nga ZVRPP-ja, mbi bazën e lejes së legalizimit dhe certifikatës së gjendjes familjare, që përcillet nga ALUIZNI.

Procedurat e hollësishme të ofrimit nga ZVRPP-ja të shërbimit të regjistrimit dhe të lëshimit të certifikatës së pasurisë së paluajtshme të legalizuar përcaktohen me udhëzim të përbashkët të kryeregjistruesit dhe drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

14. Leja e legalizimit, e miratuar pa marrëdhënie pronësie me parcelën ndërtimore (truallin), regjistrohet nga ZVRPP-ja në një kartelë tjetër pasurie, nga ajo e truallit, duke bërë shënimet përkatëse në kartelë.

15. Heqja e shënimeve në kartelë dhe regjistrimi i pronësisë mbi parcelën ndërtimore, për lejen e regjistruar, sipas pikës 14, kryhet nga ZVRPP-ja menjëherë, me hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave që miraton kalimin e të drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore dhe kompensimin e pronarëve.

16. Krahas procedurave të përcaktuara në pikat 14 e 15, të këtij vendimi, ZVRPP-ja bën edhe regjistrimin e hipotekës ligjore, sipas pikës 2/1, të nenit 30, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar. Regjistrimi i hipotekës ligjore bëhet në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë së legalizuar.

17. Për ndërtimet që posedohen nga më shumë se një subjekt, në rast mospagese të pjesës takuese të detyrimit për parcelën ndërtimore, hipoteka ligjore vendoset për pjesën takuese të pasurisë së legalizuar.

18. Fshirja e hipotekës ligjore nga ZVRPP-ja kryhet jo më vonë se 5 ditë, nga data e njoftimit të ALUIZNI-t për shlyerjen e pagesave, njoftim që shoqërohet nga dokumentacioni provues.

19. Leja e legalizimit, e lëshuar për ndërtime, për të cilat subjekti disponon të drejtën e pronësisë mbi parcelën ndërtimore (truallin), sipas formës së kërkuar nga ligji, regjistrohet nga ZVRPP-ja në regjistrin e pasurive të paluajtshme, në përputhje me afatin e parashikuar në pikën 13, të këtij vendimi.

20. Leja e legalizimit regjistrohet në përputhje me dispozitat e Kodit të Familjes mbi regjimet pasurore martesore.

Për këtë qëllim, personat e interesuar, që përfitojnë lejen e legalizimit, dorëzojnë pranë ALUIZNI-t dokumentin që provon regjimin e veçantë martesor, i cili përcillet pranë ZVRPP-së. Në të kundërt, regjistrimi kryhet sipas regjimit të bashkësisë ligjore.

21. Kur leja e legalizimit është nxjerrë në favor të më shumë se një personi (fizik/juridik), për regjistrimin e saj zbatohen përcaktimet e pikës 2, të nenit 30, të ligjit nr.9482/2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

22. Në zbatim të pikës 11, të vendimit nr.488, datë 22.7.2014, të Këshillit të Ministrave, ALUIZNI i kërkon zyrtarisht Operatorit të



Shpërndarjes së Energjisë Elektrike konfirmim për përmbushjen ose jo të detyrimeve nga ana e subjekteve përfitues të lejeve të legalizimit. Nëse OSHEE-ja nuk kthen përgjigje brenda 10 ditëve nga administrimi i kërkesës, ALUIZNI njofton Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë.

23. Subjektet përfitues të lejeve të legalizimit, që konfirmohet se kanë shlyer pagesat e furnizimit me energji elektrike, gjatë një viti, nga momenti i njoftimit të pagesës së parcelës ndërtimore, përfitojnë faljen e 10% të vlerës. Për subjektet debitorë, ALUIZNI i kërkon ZVRPP-së vendosjen e kufizimit mbi pasurinë e legalizuar.

24. Leja e legalizimit, e lëshuar për projeksionin e soletës ose të volumit të mbështetur vetëm në një krah (konsolës), regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme, në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi.

25. Për regjistrimin e shtesës informale në lartësi, në pallatet me leje, ZVRPP-ja procedon sipas përcaktimeve të këtij vendimi. Për këtë qëllim, ZVRPP-ja kryen shënimet përkatëse në regjistrin e pasurive të paluajtshme, për rishpërndarjen e kuotave të pjesëmarrjes mbi truallin e ndërtesës ekzistuese, si dhe mbi hapësirën e përbashkët (në bashkëpronësi të detyrueshme).

26. Vendimi nr. 258, datë 4.5.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të legalizuara”, shfuqizohet.

27. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 1096 datë 28.12.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE, KUSHTEVE E PROCEDURAVE PËR PËRDORIMIN DHE MENAXHIMIN E HAPËSIRËS PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4/1, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLAT, KUSHTET E PROCEDURAT PËR PËRDORIMIN DHE MENAXHIMIN E HAPËSIRËS PUBLIKE

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Ky vendim përcakton rregullat, kushtet e procedurat për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike.

Neni 2 Objekti

Ky vendim rregullon hapësirat publike ekzistuese si dhe ato që krijohen në zbatim të dokumenteve të planifikimit.

Neni 3 Përkufizime

1. Në këtë akt, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) Marrëveshja e PDV-së, marrëveshja që lidhet ndërmjet palëve private dhe autoritetit vendor të planifikimit, për miratimin e një plani të detajuar vendor (PDV), dhe që ka si objekt



përcaktimin e të drejtave të zhvillimit të pronave të njësisë strukturore përkatëse, shpërndarjen e drejtë të detyrimeve dhe përfitimeve të palëve të përfshira si dhe kushtet për krijimin e infrastrukturës dhe hapësirës publike; marrëveshja e PDV-së përmban detyrimisht, të paktën, dispozitat e përcaktuara në modelin bashkëlidhur këtij vendimi, në shtojcën A, të tij.

b) Mobilimi urban, procesi i projektimit, ndërtimit dhe/ose vendosjes në hapësirë publike të objekteve apo ndërtimeve të lëvizshme ose jo, me qëllim përmirësimin e cilësisë funksionale dhe estetike të saj, rritjen e sigurisë publike dhe, sipas rastit, zbutjen e trafikut. Objektet e mobilimit urban përfshijnë vegjetacion, shtresat në sipërfaqen e hapësirave publike, stola, shatërvanë, instalime artistike, skulptura, tabela për emërtime të rrugëve apo reklamime, kabina telefonike, kosha për mbeturina, ndriçues, semaforë, trarë dhe objekte kufizimi të parkimit ose për ngadalësimin e automjeteve, kuti postare etj.

c) Pallat, një ndërtesë apo grup ndërtesash që shërbejnë për banim dhe që mund të kenë lokale shërbimesh e tregtie, i përbërë nga, të paktën, 5 njësi, sipas përkufizimit të termiit “njësi” në legjislacionin për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit.

ç) Shërbimet e lejuara, shërbimet që autoriteti vendor lejon të kryhen në hapësirë publike, sipas kategorive të lejuara të përdorimit të tokës, dhe që janë të përputhshme me ndërtimet rreth hapësirës ku ato krijohen, sipas ligjit dhe dokumenteve të planifikimit.

d) Studime urbanistike të miratuara, dokumente planifikimi të detajuara për një zonë të caktuar (si PDV, studime urbanistike pjesore), të miratuara përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar.

dh) Zona e vlerësimit të veçantë, një zonë në të cilën zbatohet një program për investime të reja/përmirësuese në infrastrukturë publike, të cilat ndikojnë në rritjen e vlerës së pasurisë së paluajtshme. Në zbatim të këtij programi, autoriteti publik ngarkon, të paktën, një pjesë të kostos së investimit publik te pronarët e zonës. Kërkesa për klasifikimin e zonës si zonë e vlerësimit të veçantë mund t’i vijë autoritetit publik vendor nga vetë pronarët dhe/ose banorët e zonës.

2. Termat e tjerë, të përdorur në këtë vendim, kanë të njëjtin kuptim me ata të përcaktuar në ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

KREU II

HAPËSIRA PUBLIKE EKZISTUESE

Neni 4

Regjimi i hapësirave publike ekzistuese

1. Hapësirat publike ekzistuese, si trotuare, rrugë, sheshe, lulishte, parqe, shëtitore, rrugëkalime e mjedise të tjera në përdorim publik, janë të pacenueshme dhe nuk mund të ndryshojnë destinacionin e tyre në shërbim të përdorimit publik, përveçse përmes dokumenteve të planifikimit, të parashikuara nga ligji.

2. Pjesa e parcelës apo parcelave të ndërtuara jashtë gjurmës së ndërtimit të pallateve është hapësirë publike dhe përdoret si e tillë nga bashkësia e qytetarëve. Kjo hapësirë nuk rrethohet, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në lejen e ndërtimit. Bashkia mbulon shpenzimet e mirëmbajtjes së saj.

3. Në rastet kur hapësira, sipas pikës 2, më sipër, është në shërbim të bashkësisë së pronarëve, sipas ligjit për bashkëpronësinë, asambleja e bashkëpronarëve kryen mirëmbajtjen dhe përmirësimin, sipas rregullave të përcaktuara nga bashkia, dhe mbulon shpenzimet përkatëse. Në të kundërt, mirëmbajtja dhe përmirësimet kryhen nga autoriteti vendor, në mënyrë të detyrueshme, dhe shpenzimet e ndërhyrjes i ngarkohen asamblesë së bashkëpronarëve.

Neni 5

Hapësirat publike sipas PDV-ve

1. Hapësirat publike, të parashikuara në një plan të detajuar vendor, të hartuar dhe miratuar sipas ligjit, kalojnë në pronësi të autoritetit publik, sipas marrëveshjes së PDV-së, që hartohet sipas modelit bashkëlidhur në shtojcën A, dhe mirëmbahen prej tij.

2. Hapësirat publike, të parashikuara në studime urbanistike të miratuara, ku kanë gjetur trajtim të drejtat e zhvillimit që u përkasin pronave të përfshira në studim, mirëmbahen dhe përmirësohen nga autoriteti publik, me shpenzimet e veta.



KREU III KRIJIMI I HAPËSIRËS PUBLIKE

Neni 6

Instrumentet për krijimin e infrastrukturës dhe hapësirës publike

1. Instrumentet që mund të përdorë autoriteti vendor i planifikimit për krijimin e financimit e infrastrukturës dhe hapësirës publike, bazuar në legjislacionin në fuqi, janë si më poshtë vijon:

- a) intensiteti i ndërtimit me kushte;
- b) transferimi i së drejtës për zhvillim midis parcelave;
- c) zona për zhvillimin e biznesit (BID);
- ç) pagesa, nga pronarët e zonës përfituese, të pjesës së përfitimit që rrjedh nga vlera e rritur e tokës;
- d) riorganizimi i parcelave;
- dh) zona e vlerësimit të veçantë (SAD—Special Assessment Districts), nëpërmjet së cilës subjektet private financojnë përmirësime të infrastrukturës së një zone të caktuar, ku kanë interes;

e) instrumente të tjera, sipas ligjit.

2. Zbatimi i instrumenteve të mësipërme për krijimin e hapësirës publike paraprihet nga hartimi dhe realizimi i programeve përkatëse.

3. Subjektet private dhe autoriteti publik, në marrëveshje ndërmjet tyre, mund të zbatojnë një ose më shumë nga instrumentet e mësipërme, në kuadrin e një partneriteti publik privat.

4. Hapësirat publike të krijuara janë, në çdo rast, lirisht të aksesueshme nga publiku.

5. Lejet e ndërtimit për pallate, në rastet kur Plani i Përgjithshëm Vendor nuk përcakton detyrimin e hartimit të një plani të detajuar vendor, duhen të përmbajnë kushtet për krijimin e hapësirës publike në pjesën e parcelës që mbetet jashtë gjurmës së ndërtimit. Rregullat për administrimin dhe kalimin në pronësi publike të hapësirës dhe infrastrukturës publike përcaktohen në marrëveshjen e lidhur nga zhvilluesi me autoritetin publik, që miraton lejen e ndërtimit.

Neni 7

Programi për krijimin e hapësirës publike

1. Programi për krijimin e hapësirës publike nëpërmjet instrumenteve të përmendura në pikën 1, të nenit 6, zbatohet nga autoriteti vendor i

planifikimit, përmes PDV-ve ose lejeve të ndërtimit, sipas rastit. Në rastin kur në Planin e Përgjithshëm Vendor zhvillimi i zonës përcaktohet të paraprihet nga hartimi i një plani të detajuar vendor, programi mund të zbatohet përmes PDV-ve.

2. Programi, sipas rastit, mund të përmbajë, si më poshtë vijon:

a) qëllimin dhe strategjinë e komunikimit publik;

b) instrumentet që do të përdoren për krijimin e hapësirës publike, sipas nenit 6, më sipër;

c) shpërndarjen e detyrimeve e përfitimeve ndërmjet palëve private, si dhe ndërmjet palës private dhe asaj publike, përfshirë, sipas rastit, pjesën e përfitimit të autoritetit vendor nga vlera e rritur e tokës, që vjen si rezultat i krijimit të infrastrukturave publike nga vetë autoriteti publik, apo i ndryshimeve përmirësuese të kushteve zhvillimore;

ç) studim fizibiliteti për zbatimin e programit;

d) buxhetin, afatin e zbatimit si dhe mënyrën dhe/ose strukturën e administrimit të programit.

Neni 8

Përmbajtja e PDV-së në funksion të krijimit të hapësirave publike

Në rastin kur programi zbatohet nëpërmjet një PDV-je, kjo e fundit duhet të përmbajë, detyrimisht:

a) hapat për krijimin e hapësirave publike për zonën e trajtuar me PDV, përfshirë përcaktimin e kontributit publik e privat për ndërtimin e infrastrukturës dhe hapësirës publike, sipas nenit 9, në vijim;

b) identifikimin e parcelave në pronësi private, ose pjesëve të tyre, që kalojnë në pronësi të bashkisë, pa shpërblim, me qëllim dhe destinacion krijimin e rrugëve, shërbimeve, infrastrukturës publike si dhe të hapësirës publike, në përgjithësi;

c) fazat e zbatimit të projektit;

ç) sanksionet që do të zbatohen, në rast shkeljeje të detyrimeve të përcaktuara në PDV, në përputhje me ligjet në fuqi;

d) marrëveshjen e PDV-së për ndarjen e drejtë të detyrimeve dhe përfitimeve të palëve të përfshira, sipas nenit 9, në vijim.



Neni 9

Përmbajtja e marrëveshjes së PDV-së

1. Marrëveshja e PDV-së, ndërmjet subjekteve private dhe autoritetit publik, sipas neneve 5 e 8, më sipër, duhet të përmbajë detyrimisht, të paktën:

a) detyrimin për financimin dhe kryerjen e punimeve të infrastrukturës e hapësirës publike nga subjektet e përfshira;

b) mënyrën e financimit dhe afatet përkatëse nga ana e subjekteve të përfshira në marrëveshje (si p.sh. përmes dhënies së kontributeve në natyrë, formave të taksimit, fondeve të përbashkëta, bonove, në përputhje me ligjin);

c) kalimin pa shpërblim në pronësi, në favor të bashkisë, në territorin e së cilës do të kryhet zhvillimi, të pronave ose pjesëve të tyre ku do të krijohen infrastruktura dhe hapësira publike, sipas marrëveshjes;

ç) afatet për zbatimin, sipas rastit, të PDV-së ose programit të krijimit të hapësirës publike dhe lëshimin e lejeve të zhvillimit, ndërtimit e përdorimit nga bashkia, përfshirë fazat përkatëse;

d) garancitë financiare, të siguruar nga zhvilluesit për zbatimin, sipas rastit, të PDV-së, programit të krijimit të hapësirës publike dhe/ose lejes së ndërtimit;

dh) sanksionet për rastet e mosrespektimit të detyrimeve të ndërmarra nga zhvilluesi, sipas marrëveshjes.

2. Nënshkrimi i marrëveshjes, si më sipër, është kusht për miratimin e PDV-së përkatëse.

KREU IV

**RREGULLA PËR PËRDORIMIN E
HAPËSIRËS PUBLIKE**

Neni 10

Veprimtari të lejuara

Në hapësirat publike lejohen të kryhen vetëm aktivitete që janë në përputhje me qëllimin e krijimit të tyre, duke respektuar funksionin, kushtet e përdorimit dhe shërbimet e lejuara, të përcaktuara nga autoriteti i planifikimit.

Neni 11

Zënia e hapësirës publike

1. Është e ndaluar zënia, edhe përkohësisht, me çfarëdo lloj objekti, e hapësirës publike dhe hapësirave mbi ose nën të, pa lejen apo autorizimin

e bashkisë apo autoritetit përgjegjës për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e tyre.

2. Përjashtohen nga rregulli i mësipërm rastet e mëposhtme:

a) stacionimi i automjeteve, publike a private, në vendqëndrimet e përcaktuara;

b) stacionimi i mjeteve të transportit në rrugë dhe sheshe, për kohën ngushtësisht të nevojshme për operacionet e ngarkim/shkarkimit;

c) vendosja e shkallëve të lëvizshme jashtë dyqaneve, për pastrimin e vitrinave, sipas orareve të përcaktuara nga njësia vendore për kryerjen e kësaj veprimtarie.

3. Ndalohet, në çdo rast, dhënia e autorizimit për zënie e hapësirave të parqeve apo lulishteve me çdo lloj objekti, nga privatët, përfshirë elemente të lëvizshme, si tryeza e karrige, me përjashtim të rasteve kur dokumentet e planifikimit e lejojnë, me kritere të përcaktuara qartësisht. Deri në hartimin e dokumenteve të planifikimit për territoret administrative të bashkive, lejohet dhënia e autorizimeve për zënie e përkohshme të hapësirës së parqeve për ofrimin e shërbimeve qytetarëve (bar, kafe, restorant), që nuk duhet të tejkalojë, në total, masën 0,5% të sipërfaqes së parkut.

Neni 12

Hedhja e mbeturinave

Është e ndaluar vendosja, braktisja ose hedhja, në hapësira publike, e mbeturinave dhe çdo lloj lënde tjetër, të ngurtë ose të lëngshme.

Neni 13

**Mbrojtja e monumenteve, ndërtesave, parqeve
dhe lulishteve publike**

Është e ndaluar prishja, dëmtimi apo përlyerja, edhe me postera, e monumenteve, ndërtesave publike dhe private, mureve, në hapësira publike, parqeve dhe lulishteve, gjetjeve arkeologjike, rrethimeve, shatërvanëve, mobilimit urban, vitrinave, qepenave të bizneseve tregtare dhe të tjera objekteve prezente në hapësira publike.

Neni 14

Sanksionet

Shkelja e detyrimeve të mësipërme kur nuk përbën vepër penale apo kundërvajtje administrative sipas ligjeve të veçanta, dënohet në bazë të akteve të këshillit bashkiak, brenda juridiksionit të caktuar territorial.



Neni 15

Rregulla shtesë

Autoritetet vendore përgjegjëse mund të miratojnë rregulla shtesë për përdorimin e hapësirës publike, sipas nevojave përkatëse.

KREU V

MENAXHIMI I HAPËSIRËS PUBLIKE

Neni 16

Hapësira publike në pronë private

1. Hapësirat publike që krijohen sipas kreut III, të këtij vendimi, të cilat janë në pronë private, mund të administrohen nga vetë pronarët, në përputhje me vendimmarrjen e autoritetit publik përgjegjës, sipas dispozitave të këtij vendimi, ose nga autoriteti vendor përgjegjës, sipas nenit 17, në vijim. Në çdo rast, pronarët përfitojnë nga të ardhurat që vijnë nga administrimi i hapësirave publike, në përputhje me tarifat e shërbimit publik, nëse janë përcaktuar të tilla nga autoriteti vendor i planifikimit.

2. Administruesi i hapësirës publike është përgjegjës për përcaktimin dhe zbatimin e mënyrave të administrimit, në përputhje me funksionin, kushtet e përdorimit dhe shërbimet e lejuara të përcaktuara nga autoriteti i planifikimit.

3. Administruesi është përgjegjës për mirëmbajtjen e hapësirës publike, që përfshin, por nuk kufizohet në mirëmbajtjen e elementeve të mobilimit urban, gjelbërimit, largimin e mbeturinave, sigurimin e ndriçimit dhe detyrime të tjera të nevojshme.

Neni 17

Hapësira publike në pronë publike

1. Hapësira publike në prona publike administrohet nga autoriteti publik përgjegjës, drejtpërdrejt ose përmes dhënies në administrim një subjekti privat, në bazë të një marrëveshjeje të partneritetit publik privat. 2. Subjekti që ka në administrim hapësirën publike është përgjegjës për mirëmbajtjen e saj dhe, në bazë të kushteve të marrëveshjes, mund të ketë përgjegjësi edhe për zhvillimin, promovimin, organizimin e aktiviteteve sociale dhe mbledhjen vullnetare të fondeve nga publiku i gjerë, në funksion të

mirëmbajtjes dhe përmirësimit të hapësirës publike.

KREU VI

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 18

Hyrja në fuqi

Këto rregulla hyjnë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SHTOJCA A

MODEL**MARRËVESHJE PËR MIRATIMIN E PLANIT TË DETAJUAR VENDOR ME NISMË PRIVATE**

Bazuar në ligjin 107/2014, datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.671, datë 29.7.2015, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”.

Sot, më datë ____/____/____, përpara meje noterit, anëtar i Dhomës së Noterëve të qytetit, me zyrë në adresën, NUIS, u paraqitën personalisht:

z., lindur në më, në cilësinë e tij si përfaqësues i bashkisë sipas vendimit, në vijim “bashkia” dhe

zotërinjtë, në cilësinë e pronarëve të ligjshëm të pasurive të paluajtshme të identifikuar si më poshtë brenda njësisë strukturore që parashikon hartimin e PDV-së, në vijim bashkërisht “Subjekti zbatues”.

DUKE QENË SE:

- zonat/pasuritë në bashki që përfshihen brenda njësisë strukturore nr., identifikohen nga ZRPP-ja si më poshtë vijon:

- pasuria nr., fleta me sipërfaqe me pronar/ë, (nëse shoqëri tregtare) me seli në adresën NUIS ...

- pasuria nr., fleta me sipërfaqe me pronar/ë, (nëse shoqëri tregtare) me seli në adresën NUIS ...

- për zonat/njësinë strukturore në fjalë Plani i Përgjithshëm Vendor i bashkisë parashikon përdorim/funksion....;



- dispozitat ligjore dhe Plan i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë, miratuar më datë ____/____/____ kushtëzojnë realizimin e ndërtimeve në këtë njësi strukturore me hartimin dhe miratimin e një planit të detajuar vendor, mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në rregulloren e planifikimit;

- z./znj. lindur në më dhe banues në.... (ose) shoqëria tregtare, me seli në adresën, NUIS, në cilësinë e përfaqësuesit të pronarëve të pasurive të paluajtshme të njësisë strukturore, që përfaqësojnë ...% të sipërfaqes së zonës për PDV-në, për një sipërfaqe totale prej m², i ka paraqitur bashkisë kërkesë për miratimin e Planit të Detajuar Vendor me nismë private për këtë njësi strukturore;

- kërkesa për miratimin e PDV-së është depozituar në bashki më datë, dhe ka marrë nr. protokollit dhe ka pasur bashkëlidhur materialin hartografik të projektit, me firmë të arkitektit;

- më datë, përgjegjësi i zyrës së planifikimit në bashki, ka verifikuar se dokumentacioni i paraqitur është i plotë dhe i saktë dhe i ka kaluar kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për shqyrtim kryetarit të bashkisë, së bashku me raportin teknik përkatës;

- më datë, Plan i Detajuar Vendor u botua në mjediset e bashkisë, në portalin *on-line* të bashkisë si dhe u afishua në mjediset e njësisë strukturore në studim, duke u lënë palëve të interesuara një afat 30 ditor për t'u njohur dhe paraqitur vërejtjet e tyre;

- gjatë afatit 30 ditor nuk u paraqitën vërejtje apo kundërshtime; ose gjatë afatit 30 ditor u paraqitën vërejtje dhe / ose kundërshtime të cilat u morën në konsideratë nga kryetari / nuk u morën në konsideratë për arsye të bëra publike;

- më datë, u paraqitën ndryshimet e projektit, bazuar në komentet / vërejtjet...;

- Kryetari i bashkisë, duke marrë parasysh raportin teknik të përgatitur nga Drejtoria e Planifikimit, dhe pasi ka shqyrtuar vërejtjet dhe komentet e palëve të interesuara, ka miratuar PDV-në për njësinë strukturore nr. me vendimin nr., datë

DUKE QENË SE EKZISTOJNË KËTO KUSHTET PARAPRAKE:

Palët bien dakord të nënshkruajnë këtë marrëveshje me termat si më poshtë vijon:

Neni 1

Kushtet paraprake

Kushtet paraprake janë pjesë përbërëse dhe thelbësore e kësaj marrëveshje.

Neni 2

Objekti i marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka si objekt përcaktimin e të drejtave të zhvillimit të pronave në njësinë strukturore nr., shpërndarjen e drejtë të detyrimeve dhe përfitimeve të palëve të përfshira si dhe kushtet për ndërtimin dhe kalimin në pronësi të shtetit, pa kundërshtpërblim, të infrastrukturës dhe hapësirës publike nga ana e subjektit zbatues, në zbatim të Planit të Detajuar Vendor për njësinë strukturore në fjalë.

Neni 3

Përmbajtja e PDV-së

PDV-ja përbëhet nga dokumentet si vijon:

- Teksti
- Materiali hartografik
- (të specifikohet sipas rastit).

Neni 4

Zbatimi dhe mirëmbajtja e punimeve të infrastrukturës

4.1. Punimet e infrastrukturës dhe hapësirës publike përcaktohen dhe rregullohen në planimetritë bashkëlidhur kësaj kontrate.

4.2. Punimet e infrastrukturës dhe hapësirës publike përbëhen nga:

- a) rrjeti rrugor, trotuare dhe rrugëkalime këmbësore ose për biçikleta;
- b) parkime publike;
- c) hapësira për kontejnerët e grumbullimit të mbeturinave;
- ç) rrjeti i shkarkimit të ujrave të zeza e të bardha;
- d) rrjeti i shkarkimit të ujrave të shiut;
- dh) ndriçimi publik;
- e) rrjeti për furnizimin me ujë (dhe gaz);
- ë) rrjeti për furnizimin me energji elektrike;
- f) rrjeti telefonik;
- g) lidhjet me rrjetet publike ekzistuese dhe ato që do të realizohen në të ardhmen;
- gj) gjelbërimi publik dhe lulishte dhe/ose mobilimi i hapësirës publike.
- h) të tjera (për t'u specifikuar, sipas rastit).



4.3. Subjekti zbatues merr përsipër, për vete dhe personat që fitojnë të drejta prej tij:

- të realizojë me shpenzimet e tij të gjitha punimet e infrastrukturës dhe hapësirave publike, të përcaktuara në pikën 4.2., më sipër, sipas planimetrive bashkëlidhur:

a) zonat me ngjyrë ... me sipërfaqe totale m², me destinacion “rrugë”;

b) zonat me ngjyrë me sipërfaqe totale m², me destinacion “trotuare”;

c) zonat me ngjyrë me sipërfaqe totale m², me destinacion “rrugë ciklo-pedonale”;

ç) zonat me ngjyrë me sipërfaqe totale m², me destinacion “hapësira të gjelbra”;

d) zonat me ngjyrë me sipërfaqe totale m², me destinacion “parkime / vendqëndrime publike”;

dh) (të tjera për t’u specifikuar, sipas rastit).

- të përballojë, sipas rastit, shpenzimet që lidhen me realizimin e punimeve të mëposhtme të infrastrukturës që janë jashtë zonës së ndërhyrjes si vijon:

a) _____

b) _____

Parkimet publike duhet të realizohen të kompletuar me të gjitha instalimet e nevojshme, sipas projektit të miratuar.

4.4. Subjekti zbatues merr përsipër, edhe për llogari të subjekteve të mundshme ndërtuese, të zbatojë punimet në përputhje me standardet më të mira teknike dhe profesionale në BE.

Neni 5

Lejet e ndërtimit për realizimin e ndërhyrjeve në territor

5.1. Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje është kusht paraprak dhe një nga dokumentet e nevojshëm për miratimin e lejeve të ndërtimit për ndërhyrjet e parashikuara në Planin e Detajuar Vendor përkatës.

5.2. Fillimi i punimeve për ndërtesat e parashikuara në Planin e Detajuar Vendor duhet të paraprihet nga realizimi i punimeve të infrastrukturës kryesore dhe dytësore, sipas nenit 45, të ligjit nr.107/2014, datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

Neni 6

Afatet për realizimin dhe kolaudimin e punimeve

6.1. Punimet e infrastrukturës dhe hapësirës publike duhet të përfundojnë dhe të kolaudohen jo më vonë se muaj nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje. Bashkia, pasi të ketë vlerësuar interesin publik dhe në rast se nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, ka të drejtën të zgjasë afatin e përcaktuar si më sipër. Në çdo rast, afati për përfundimin e punimeve të infrastrukturës dhe hapësirës publike, duke përfshirë edhe mundësinë e shtyrjes së tij, nuk mund të tejkalojë vjet nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje.

6.2. Kolaudatori caktohet nga bashkia brenda ditëve nga njoftimi i fillimit të punimeve nga ana e subjektit zbatues dhe duhet të kryejë kolaudimin e veprave të realizuara brenda ditëve nga kërkesa zyrtare e subjektit zbatues, që duhet të paraqitet jo më vonë se 3 muaj pas njoftimit të përfundimit të punimeve.

Neni 7

Kalimi në pronësi të bashkisë i infrastrukturës dhe hapësirës publike

7.1. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, subjekti zbatues i kalon në pronësi, pa shpërblim, bashkisë (ose bashkëpronarëve, në rastin e lagjeve të gardhuara dhe vetëadministruara), në bazë të nenit 706, të Kodit Civil pronësinë e truallit dhe të gjitha infrastrukturat e hapësirat publike që do të ndërtohen mbi të në momentin që këto të fundit të jenë kolauduar, sikurse parashikohen në planimetrinë bashkëlidhur, dhe konkretisht:

a) rrugë për rreth m²;

b) parkime publike për rreth m², për një total prej nr. vendqëndrime automjetesh;

c) gjelbërim publik për parqe dhe lulishte dhe /ose arredim urban sipas udhëzimeve të kushteve teknike të identifikuar (të specifikohen rast pas rasti);

ç) sheshe për vendosjen e kontejnerëve për grumbullimin e mbeturinave të ngurta urbane dhe për rreth m²;

d)(të tjera për t’u specifikuar, sipas rastit).

7.2. Subjekti zbatues garanton se zonat dhe/ose objektet që i kalojnë bashkisë, sipas



pikës 7.1. më sipër, janë të lira nga barra, kufizime, servitute, të drejta reale në favor të tij apo të personave të tretë. Në momentin e kalimit të pronësisë, që përkon me aktin e kolaudimit të punimeve të kryera, këto pasuri kategorizohen si pronë e paluajtshme e shtetit, në përdorim/pronësi të bashkisë përkatëse.

7.3. Brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje, subjekti zbatues regjistron në ZVRPP-në kompetente kopje të kësaj marrëveshjeje për kryerjen e regjistrimeve përkatëse.

Neni 8 Garancitë

8.1. Për të garantuar zbatimin në kohë dhe me përpikmëri, të të gjitha punimeve të infrastrukturës dhe hapësirës publike e respektimin e të gjitha dispozitave ligjore dhe kërkesave të kësaj marrëveshjeje, subjekti zbatues paraqet përpara nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, garanci në formën e garancisë/dorëzarisë bankare ose sigurorese, të vlefshme deri në marrjen në dorëzim të veprave nga ana e bashkisë, në përfundim të inspektimit, në vlerën (....) lekë, të përcaktuar sipas kostos totale të punimeve plus% TVSH. Dorëzania duhet të parashikojë shprehimisht që bashkia të ketë të drejtën e tërheqjes së menjëhershme të garancisë, brenda 15 ditëve nga kërkesa me shkrim e bashkisë, në rast se shkelen nga zhvilluesi kushtet e marrëveshjes.

8.2. Në rast shkeljeje të detyrimeve të marra përsipër me këtë marrëveshje, bashkia ka të drejtën të tërheqë shumat e lëna në garanci nga subjekti zbatues, sipas pikës 8.1. më sipër, në vlerë proporcionale me mospërmbushjen.

8.3. Garancia mund të hiqet me kërkesë të palës së garantuar (bashkisë), pas marrjes në dorëzim nga kjo e fundit të punimeve të realizuara.

Neni 9 Zbatimi i detyrueshëm

9.1. Bashkia rezervon të drejtën për të vënë në zbatim ose për të përfunduar punimet e infrastrukturës dhe hapësirës publike, në zëvendësim të subjektit zbatues dhe me shpenzimet e këtij të fundit, në rast se ky nuk i përmbush detyrimet e tij. Për këtë qëllim, me

nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje dhe me anë të saj, subjekti zbatues autorizon bashkinë që, në rast shkeljeje të afateve të kësaj marrëveshjeje, kjo e fundit të ketë akses në zonat ku kryhen punimet e infrastrukturës me subjektet ndërtuese përkatëse.

9.2. Realizimi i punimeve të infrastrukturave dhe hapësirave publike dhe kolaudimi i tyre ose, në rastet kur bashkia i ekzekuton ato vetë, pagesa e shpenzimeve të nevojshme për kryerjen e këtyre punimeve, duke përfshirë këtu edhe mbajtjen e tyre nga garacia sipas nenit 8, të marrëveshjes, është parakusht për marrjen e lejes së përdorimit për të gjitha veprat e realizuara sipas PDV-së përkatëse.

Neni 10 Afati i marrëveshjes

10.1. Kjo marrëveshje ka vlefshmëri për një afat vjeçar nga nënshkrimi i saj, për përfundimin e të gjitha ndërhyrjeve /punimeve të parashikuara në PDV. Për arsye të justifikuara mund të pranohet një shtyrje e afatit për një periudhë të mëtejshme ... vjeçare.

Neni 11 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe ligji i zbatueshëm

11.1. Palët do të bëjnë çdo përpjekje që t'i zgjidhin të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje me mirëkuptim ndërmjet tyre.

11.2. Nëse dështon kjo mënyrë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, palët do t'i drejtohen gjykatës kompetente.

11.3. Për sa nuk parashikohet në këtë marrëveshje, do të gjejnë zbatim dispozitat ligjore në fuqi.

Bashkia
Subjekti Zbatues
NOTERI

VENDIM **Nr. 1097, datë 28.12.2015** **PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES SË** **KËSHILLIT KOMBËTAR TË** **TERRITORIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 6, të nenit 6, të ligjit nr.



107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli Kombëtar i Territorit, si autoritet kombëtar i planifikimit, kryesohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje:

- | | |
|--|------------------|
| - Ministrin e Zhvillimit Urban | zëvendëskryetar; |
| - Ministrin e Punëve të Brendshme | anëtar; |
| - Ministrin e Transportit dhe Infrastrukturës | anëtar; |
| - Ministrin e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes | anëtar; |
| - Ministrin e Drejtësisë | anëtar; |
| - Ministrin e Kulturës | anëtar; |
| - Ministrin e Energjisë dhe Industrisë | anëtar; |
| - Ministrin e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave | anëtar; |
| - Ministrin e Mjedisit | anëtar; |
| - Zëvendësministrin e Zhvillimit Urban | anëtar; |
| - Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit | sekretar. |

2. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Territorit, për çdo pjesëmarrje në mbledhje, shpërblehen me 20 000 (njëzet mijë) lekë.

3. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Territorit të përballohet nga buxhetet e miratuara për çdo institucion përkatës që ata përfaqësojnë.

4. Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT), brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga dita e zhvillimit të mbledhjes, zbardh vendimet e KKT-së, të cilat ua dërgon për nënshkrim Kryeministrit, në cilësinë e kryetarit të Këshillit, dhe ministrit të Zhvillimit Urban.

5. Vendimi nr. 877, datë 3.10.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, shfuqizohet.

6. Ngarkohen të gjitha institucionet, përfaqësuesit e të cilave janë përcaktuar në pikën 1, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 1098, datë 28.12.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 54, DATË 21.1.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I OBJEKTIT “STUDIM, PROJEKTIM, LIDHJA E RRUGËS TRANSBALLKANIKE ME SUPERSTRADËN FIER - VLORË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 54, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në pikat 3 dhe 4, vlera 582 942 635.82 (pesëqind e tetëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e dyzet e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë pikë tetëdhjetë e dy) lekë, ndryshon dhe bëhet 582 288 595.82 (pesëqind e tetëdhjetë e dy milionë e dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë pikë tetëdhjetë e dy) lekë.

2. Në tabelën bashkëlidhur vendimit bëhen ndryshimet në numrat rendorë përkatës, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



Nr.	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Pronari	Sipërfaqe trualli	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i truallit lekë	Çmimi i ndërtimit lekë	Vlera e truallit lekë	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera truall dhe ndërtësë	Shënime
25	8605	2/57+1-1	Hava Hysaj		50	8300	52,024.00			2,482,427.00	Konfirmuar nga ZRPP-ja
			Meço Hysaj								
			Edmond Hysaj								
38	8605	11/92	Afrim Agalliu (90/1080)	2045.4	0	8300	52,024.00	16,976,820.00	-	1,414,735.00	Konfirmuar nga ZRPP-ja
			Agron Dine (15/1080)							235,789.17	
			Arbana Haxhi (3/1080)							47,157.83	
			Ardian Dine (15/1080)							235,789.17	
			Avdul Haxhi (12/1080)							188,631.33	
			Barjam Haxhi (12/1080)							188,631.33	
			Bozhure Agalliu (60/1080)							943,156.67	
			Brunilda Haxhi (3/1080)							47,157.83	
			Dashamir Agalliu (90/1080)							1,414,735.00	
			Dyrfiras Sorra (15/1080)							235,789.17	
			Edison Haxhi (3/1080)							47,157.83	
			Engjell Dine (15/1080)							235,789.17	
			Engjell Sorra (15/1080)							235,789.17	
			Enrita Zinxhiria (10/1080)							157,192.78	
			Firdus Agalliu (10/1080)							157,192.78	
			Hiqmet Qemali (30/1080)							471,578.33	
			Illir Agalliu (10/1080)							157,192.78	
			Lejla Haxhi (12/1080)							188,631.33	
			Leonel Kokoshi (60/1080)							943,156.67	
			Lindita Kili (15/1080)							235,789.17	
			Marjana Drasa (agalliu) (90/1080)							1,414,735.00	
			Merushe Agalliu (10/1080)							157,192.78	
			Mynevere Cobani (30/1080)							471,578.33	
			Natasha Toto (15/1080)							235,789.17	
			Osvalda Balli							1,886,313.33	



			(120/1080)								
			Refit Agalliu (10/1080)							157,192.78	
			Sanie Haxhi (12/1080)							188,631.33	
			Selvi Sina (15/1080)							235,789.17	
			Servet Sorra (15/1080)							235,789.17	
			Shkelqim Agalliu (10/1080)							157,192.78	
			Shpend Topallaj (20/1080)							314,385.56	
			Sokol Kokoshi (60/1080)							943,156.67	
			Spartak Topallaj (20/1080)							314,385.56	
			Teferi Caushaj (agalliu) (90/1080)							1,414,735.00	
			Themida Kondi (15/1080)							235,789.17	
			Tomorr Sorra (15/1080)							235,789.17	
			Yllka Lamaj (15/1080)							235,789.17	
			Zhaneta Graceni (20/1080)							314,385.56	
			Zyrha Haxhi (3/1080)							47,157.83	
40	8605	11/177	Afrim Agalliu (90/1080)	8385.9	0	8300	52,024.00	69,602,970.00		5,800,247.50	Konfirmuar nga Zvrpp
			Agron Dine (15/1080)							966,707.92	
			Arbana Haxhi (3/1080)							193,341.58	
			Ardian Dine (15/1080)							966,707.92	
			Avdul Haxhi (12/1080)							773,366.33	
			Barjam Haxhi (12/1080)							773,366.33	
			Bozhure Agalliu (60/1080)							3,866,831.67	
			Brunilda Haxhi (3/1080)							193,341.58	
			Dashmir Agalliu (90/1080)							5,800,247.50	
			Dyrfiras Sorra (15/1080)							966,707.92	
			Edison Haxhi (3/1080)							193,341.58	
			Engjell Dine (15/1080)							966,707.92	
			Engjell Sorra (15/1080)							966,707.92	
			Enrita Zinxhiria (10/1080)							644,471.94	



			Firdus Agalliu (10/1080)						644,471.94	
			Hiqmet Qemali (30/1080)						1,933,415.83	
			Ilir Agalliu (10/1080)						644,471.94	
			Lejla Haxhi (12/1080)						773,366.33	
			Leonel Kokoshi (60/1080)						3,866,831.67	
			Lindita Kili (15/1080)						966,707.92	
			Marijana Drasa (agalliu) (90/1080)						5,800,247.50	
			Merushe Agalliu (10/1080)						644,471.94	
			Mynevere Cobani (30/1080)						1,933,415.83	
			Natasha Toto (15/1080)						966,707.92	
			Osvolda Balli (120/1080)						7,733,663.33	
			Refit Agalliu (10/1080)						644,471.94	
			Sanie Haxhi (12/1080)						773,366.33	
			Selvi Sina (15/1080)						966,707.92	
			Servet Sorra (15/1080)						966,707.92	
			Shkelqim Agalliu (10/1080)						644,471.94	
			Shpend Topallaj (20/1080)						1,288,943.89	
			Sokol Kokoshi (60/1080)						3,866,831.67	
			Spartak Topallaj (20/1080)						1,288,943.89	
			Teferi Caushaj (agalliu) (90/1080)						5,800,247.50	
			Themida Kondi (15/1080)						966,707.92	
			Tomorr Sorra (15/1080)						966,707.92	
			Yllka Lamaj (15/1080)						966,707.92	
			Zhaneta Graceni (20/1080)						1,288,943.89	
			Zyrha Haxhi (3/1080)						193,341.58	
44	8605	11/139	Afrim Agalliu (90/1080)	1040	0	8300	52,024.00	8,632,000.00	719,333.33	Konfirmuar nga ZRPP-ja
			Agron Dine (15/1080)						119,888.89	
			Arbana Haxhi (3/1080)						23,977.78	
			Ardian Dine (15/1080)						119,888.89	



			Avdul Haxhi (12/1080)							95,911.11	
			Barjam Haxhi (12/1080)							95,911.11	
			Bozhure Agalliu (60/1080)							479,555.56	
			Brunilda Haxhi (3/1080)							23,977.78	
			Dashamir Agalliu (90/1080)							719,333.33	
			Dyrfiras Sorra (15/1080)							119,888.89	
			Edison Haxhi (3/1080)							23,977.78	
			Engjell Dine (15/1080)							119,888.89	
			Engjell Sorra (15/1080)							119,888.89	
			Enrita Zinxhiria (10/1080)							79,925.93	
			Firdus Agalliu (10/1080)							79,925.93	
			Hiqmet Qemali (30/1080)							239,777.78	
			Illir Agalliu (10/1080)							79,925.93	
			Lejla Haxhi (12/1080)							95,911.11	
			Leonel Kokoshi (60/1080)							479,555.56	
			Lindita Kili (15/1080)							119,888.89	
			Marjana Drasa (agalliu) (90/1080)							719,333.33	
			Merushe Agalliu (10/1080)							79,925.93	
			Mynevere Cobani (30/1080)							239,777.78	
			Natasha Toto (15/1080)							119,888.89	
			Osvalda Balli (120/1080)							959,111.11	
			Refit Agalliu (10/1080)							79,925.93	
			Sanie Haxhi (12/1080)							95,911.11	
			Selvi Sina (15/1080)							119,888.89	
			Servet Sorra (15/1080)							119,888.89	
			Shkelqim Agalliu (10/1080)							79,925.93	
			Shpend Topallaj (20/1080)							159,851.85	
			Sokol Kokoshi (60/1080)							479,555.56	
			Spartak Topallaj (20/1080)							159,851.85	



			Teferi Caushaj (agalliu) (90/1080)							719,333.33	
			Themida Kondi (15/1080)							119,888.89	
			Tomorr Sorra (15/1080)							119,888.89	
			Yllka Lamaj (15/1080)							119,888.89	
			Zhaneta Graceni (20/1080)							159,851.85	
			Zyrha Haxhi (3/1080)							23,977.78	

VENDIM**Nr. 1099, datë 28.12.2015**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE
SHITESA NË VENDIMIN NR. 488, DATË
22.7.2014, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E
ÇMIMIT FAVORIZUES TË SHITJES SË
PARCELËS NDËRTIMORE PËR
NDËRTIMET PA LEJE ME FUNKSION
BANIMI DHE TË PËRZIER, TË
SUBJEKTEVE QË PËRFITOJNË FALJE
TË PAGESËS, SI DHE TË MËNYRËS E
AFATEVE TË PAGESËS”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 17, të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 488, datë 22.7.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 2, fjalët “...territorit administrativ të komunave...” dhe “...territorit administrativ të bashkive...” zëvendësohen, përkatësisht, me “...territorit të njësive administrative fshat...” dhe “...territorit të njësive administrative qytet...”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Për ndërtimet pa leje, me funksion banimi, dhe për shtesat, me funksion banimi, çmimi i shitjes së parcelës ndërtimore, deri në/dhe përfshirë 500 m², llogaritet sipas pikave 1 e 2, të këtij vendimi.”.

3. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1. Për poseduesit e ndërtimeve pa leje, që kanë statusin e invalidit të punës ose që kanë bashkëshortë me këtë status, në kuptim të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidëve të punës”, me paraqitjen e dëshmisë zyrtare përkatëse, pranë drejtorisë së ALUIZNI-t, detyrimi financiar për parcelën ndërtimore zbritet në masën 50%, nga vlera e llogaritur në bazë të kreut I, të këtij vendimi.”.

4. Pas pikës 5 shtohen pikat 5/1, 5/2 e 5/3, me përmbajtje, si më poshtë vijon:

“5/1. Subjektet e parashikuara në pikat 4, 4/1 dhe 5, të këtij vendimi, përfitojnë vetëm një herë faljen apo zbritjen nga detyrimi për parcelën ndërtimore, cilido qoftë funksioni i ndërtimit. Lehtësitë, sipas pikave të mësipërme, përfitohen për ato ndërtime për të cilat nuk është shlyer ende detyrimi financiar për parcelën ndërtimore. Këto lehtësi aplikohen pavarësisht nëse subjektet kanë përfituar legalizim të ndërtimeve të tjera, përpara datës 4 gusht 2014.

5/2. Përfitojnë faljen apo zbritjen e detyrimit për parcelën ndërtimore subjektet që janë aplikues për legalizim ose që u janë njohur të drejta mbi ndërtimin pa leje, me vendim gjyqësor të formës së prerë. Nuk përfitojnë lehtësitë, për shkak të statusit të veçantë, të parashikuara në pikat 4, 4/1 e 5, të këtij vendimi, subjektet të cilëve u është transferuar e drejta e legalizimit të ndërtimit pa leje përmes një veprimi juridiko-civil.

5/3. Bashkësitë fetare, që kanë lidhur marrëveshje me Këshillin e Ministrave, për objektet e kultit, institucionet e arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar, objektet me destinacion për shërbime sociale a



shëndetësore, përjashtohen nga pagesa për parcelën ndërtimore, në përputhje me nenin 12, të ligjit nr. 10140, datë 15.5.2009, “Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”.

Ky përjashtim vlen edhe për objektet e tjera, në kuptim të nenit 25, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.”.

5. Pas pikës 6 shtohen pikat 6/1 e 6/2, me përmbajtje, si më poshtë vijon:

“6/1. Njoftimi dërgohet në rrugë postare ose i jepet në dorëzim subjektit, nga drejtoria përkatëse e ALUIZNI-t, pas miratimit të kalimit të së drejtës së pronësisë me vendim të Këshillit të Ministrave.

6/2. Kur njoftimi nuk mund të dërgohet në rrugë postare, për shkak të mungesës së adresës, apo kur subjekti refuzon të marrë në dorëzim njoftimin, ai afishohet për 30 ditë në një vend të dukshëm, pranë njësisë administrative ku ndodhet ndërtimi pa leje. Llogaritja e afatit për pagesën, në këtë rast, fillon të nesërmen e ditës së fundit të afishimit.”.

6. Pika 10 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“10. Deri në shlyerjen e detyrimit financiar të parcelës ndërtimore, ndërtimi i legalizuar regjistrohet me hipotekë ligjore, sipas nenit 54, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.”.

7. Pas pikës 10 shtohet pika 10/1, me këtë përmbajtje:

“10/1. Kur kalimi i së drejtës së pronësisë është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, përpara datës 31.12.2015, dhe nuk është lëshuar ende leja e legalizimit, ALUIZNI njofton subjektin për detyrimin financiar, sipas procedurës së përcaktuar në këtë vendim. Subjekti ka 60 ditë afat për shlyerjen e detyrimit financiar.

Për subjektet posedues të ndërtimeve pa leje, që janë njoftuar nga ALUIZNI për detyrimin financiar deri në datën 31.12.2015, për të cilët nuk është lëshuar ende leja e legalizimit, do të respektohet afati 6-mujor për shlyerjen e detyrimit, duke filluar nga data e njoftimit.

Në rast mospagese të detyrimit financiar, sipas afateve të përcaktuara në këtë pikë, ALUIZNI miraton lejen e legalizimit dhe e dërgon për

regjistrim me hipotekë ligjore, sipas nenit 54, të ligjit nr.33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

8. Pas pikës 11 shtohet pika 11/1, me këtë përmbajtje:

“11/1. Të drejtat, detyrimet dhe procedurat e parashikuara në kërret II e III, të këtij vendimi, zbatohen si për objektet pa leje edhe për shtesat në ndërtime me leje, që i nënshtrohen kalimit të pronësisë mbi parcelën ndërtimore.”.

9. Kudo në tekst, fjalët “...anësore dhe/ose në lartësi...” shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 1101, datë 28.12.2015

PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE DHE PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR TRANSPORTIN RRUGOR TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARASHKOLLOR, PARAUNIVERSITAR DHE TË STUDENTËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 24, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, dhe nenit 19, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, ministrit të Punëve të Brendshme dhe ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kushteve dhe përcaktimin e rregullave për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe të studentëve, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Urdhri i përbashkët nr. 417, datë 29.8.2012, “Për marrjen e masave për mbarëvajtjen e transportit rrugor të mësuesve, nxënësve dhe të studentëve”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe



njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

KUSHTE DHE RREGULLA
PËR TRANSPORTIN RRUGOR TË
NXËNËSVE TË ARSIMIT PARASHKOLLOR,
PARAUNIVERSITAR DHE STUDENTËVE

1. Qëllimi

Rregullimi i shërbimeve të transportit rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentëve në përputhje me standardet evropiane, rritja e sigurisë në transport, nëpërmjet zbatimit të kushteve dhe rregullave, nga subjektet transportuese dhe organet e kontrollit në rrugë.

2. Fusha e zbatimit

2.1. Transporti rrugor i nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentëve me autobus;

2.2. Transporti rrugor i nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentëve kryhet përmes shërbimit të rregullt të specializuar, operacioneve të transportit për llogari të vet dhe shërbimeve të rastit;

2.3 Këto rregulla nuk zbatohen për transportin publik në linja të rregullta qytetas dhe rrethqytetas të parauniversitarëve dhe studentëve;

2.4. Në shërbimet e rastit, këto rregulla zbatohen vetëm për parauniversitarët dhe studentët.

3. Përkufizime

Për qëllime të plotësimit të kushteve dhe përcaktimit të rregullave për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentëve, përdoren përkufizimet e mëposhtme:

a) Transportues është personi fizik ose juridik i licencuar për të tretë sipas legjislacionit në fuqi ose i pajisur me certifikatë për llogari të vet për operatorët e transportit për llogari të vet;

b) Mjet transporti shkollor është automjeti që ka karakteristika teknike të vendosura sipas kësaj Rregullore dhe përkufizimeve të përcaktuara në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

c) Institucion arsimor parashkollor, parauniversitar dhe i lartë, publik apo privat, është

institucioni, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin parashkollor, arsimin bazë ku përfshihet arsimi fillor dhe arsimi i mesëm i ulët, arsimi i mesëm i lartë dhe arsimi i lartë, publik dhe privat;

ç) Licencë është akti administrativ i lëshuar për një periudhë të caktuar kohe, i vlefshëm për të ushtruar veprimtari transporti udhëtarësh;

d) Certifikatë është dokumenti që mbahet në mjet dhe që,

i) shoqëron licencën për rastet e transporteve rrugore, që janë subjekt licencimi;

ii) i jep të drejtën një institucioni arsimor për transportin për llogari të vet të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentëve.

e) Shërbimet e rregullta të specializuara janë shërbimet që sigurojnë transportin:

i) shtëpi – institucion parashkollor (kopshti i fëmijëve) dhe anasjelltas, sipas përcaktimeve të pikës 7.4;

ii) shtëpi – institucion shkollor ose universitet, i parauniversitarëve dhe studentëve dhe anasjelltas, sipas përcaktimeve të pikës 7.4.

ë) Shërbime transporti të rastit janë ato shërbime transporti që nuk i përgjigjen përkufizimit të shërbimeve të rregullta të specializuara.

Në shërbimet e rastit, nuk lejohen të lihen ose të merren udhëtarë gjatë udhëtimit.

Këto shërbime kryhen për qëllime të aktivitetit edukativo-mësimor dhe argëtues të parauniversitarëve dhe studentëve jashtë qendrës urbane ku ndodhet institucioni i edukimit, shkollor apo universitar.

Shërbimet e transportit të rastit nuk zbatohen për nxënësit e arsimit parashkollor.

f) Transportet për llogari të vet janë transportet e kryera për qëllime jo-tregtare dhe jo-fitimprurëse nga një institucion arsimor, me kusht që:

i) veprimtaria e transportit të jetë vetëm një veprimtari ndihmëse për institucionin;

ii) mjetet e përdorura të jenë pronë e institucionit, ose të jenë të blera me këste prej tij, ose të jenë objekt i një kontrate qiramarrje afatgjatë dhe të drejtohen nga një punonjës apo anëtar i institucionit arsimor.

g) dokument kontrolli janë licenca, certifikata, fleta ose libri udhëtimit, kontrata udhëtimit dhe çdo dokument që i përket automjetit, drejtuesit të



mjetit dhe operimit në rrugë, që mbahen në origjinal ose kopje e njehsuar me origjinalin në bordin e automjetit gjatë gjithë udhëtimit.

4. Licenca dhe Certifikata

4.1 Janë subjekt licencimi dhe certifikimi personat fizikë ose juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e transportit, për:

a) shërbimet e rregullta, përfshirë shërbimet e rregullta të specializuara për nxënës të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentët;

b) shërbimet e rastit për parauniversitarët dhe studentët;

c) transportet për llogari të vet, të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentëve.

4.2 Licenca lëshohet në bazë të nenit 5, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 325, datë 19.3.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuar për këta operator”, të ndryshuar;

4.3 Shërbimet e rregullta, përfshirë shërbimet e rregullta të specializuara dhe shërbimet e rastit janë subjekt i licencës të lëshuar nga autoriteti sipas pikës 5 të kësaj rregullore;

4.4 Autoriteti kompetent i lëshimit të licencës, lëshon certifikata për çdo mjet që është në përdorim, edhe nëse këto mjete janë pronë e institucionit arsimor apo të marra me qira;

4.5 Çdo mjet është i pajisur edhe me certifikatën e operimit, e cila është dhe pjesë përbërëse e kontratës të lidhur ndërmjet transportuesit dhe institucionit;

4.6 Shërbimet e rregullta përfshirë shërbimet e rregullta të specializuara të transportit të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentëve, janë subjekt kontrolli i certifikatës së operimit dhe kontratës së lidhur midis subjektit transportues dhe institucionit për të cilin kryhet shërbimi;

4.7 Certifikata për llogari të vet është subjekt i kryerjes së transportit për llogari të vet institucionit;

4.8 Shërbimet e transportit të rastit (turistike) të parauniversitarëve dhe studentëve, janë subjekt kontrolli i dokumentit të udhëtimit dhe kontratës së lidhur midis subjektit transportues i licencuar

për këtë lloj transporti dhe agjencisë turistike të udhëtimit;

5. Autoriteti kompetent për lëshimin e licencës/certifikatës

5.1 Autoriteti /autoritetet kompetent/e për lëshimin e dokumenteve për pranimin në profesion dhe hyrjen në tregun e transportit rrugor, transportuesve që kryejnë transport të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentëve, caktohen sipas legjislacionit në fuqi.

6. Kushtet që duhet të plotësojë mjete i transportit

6.1 Mjetet e transportit për shërbimin e rregullt dhe të rastit të transportit të institucioneve arsimore parashkollore, parauniversitar dhe universitar, duhet në çdo kohë të jenë të pajisura me certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, të lëshuar në përputhje me legjislacionin në fuqi;

6.2 Të jenë të pajisura me aktvlerësimin në plotësim të kushteve për komoditetin e autobusëve në transportin e udhëtarëve brenda vendit, të lëshuar në përputhje me nenin 9, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar; si dhe udhëzimit nr. 1649, datë 16.8.1999, “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar.

6.3 Transporti i nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentëve kryhet vetëm me autobusë, me përjashtim të rasteve të zonave ku infrastruktura rrugore nuk përmbush kriteret e udhëtimit me autobus dhe numri i fëmijëve të institucioneve arsimore parashkollore dhe parauniversitarëve është më i vogël se 8 persona, lejohet përdorimi i autoveturës me 8+1 vende;

6.4 Përdorimi i autoveturave me 8+1 vende për transportin e nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar bëhet vetëm me miratimin e bashkisë;

6.5 Viti i prodhimit të automjeteve nuk lejohet më shumë se 10 vjet. Automjetet do të kenë ngjyrë portokalli (kodi heksadecimal #FF6600), të kenë të shkruar dukshëm në mënyrë të rregullt në të gjitha anët e mjetit në qendër poshtë xhamave, me ngjyrë të zezë, fjalët “AUTOBUS SHKOLLE”, lloji i germës impact, lartësi shkrimi 12 cm. Poshtë shkrimit, në qendër



ose anash vendoset logo me shenjën e fëmijëve të shkollës, sipas fig. II 304, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 9.4.2000, “Rregullore për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ilustrimi sipas lidhjes 1 bashkëlidhur).

Në këto mjete nuk duhet vendosur asnjë lloj reklame.

6.6 Gjithashtu, automjeti duhet të ketë të montuar dhe një krah me gjatësi jo më të madhe se 15 cm, me tabelën “STOP” (sipas fig. II.37 të sinjaleve të përparësisë të Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor), në anën e jashtme në krahun e majtë, në fund të karrocërisë ose pranë derës së drejtuesit të mjetit ose në të dy anët së bashku (lidhja 3 bashkëlidhur).

Kur mjeti ndalet për hipje zbritje pasagjerësh krahu lëviz 900 pingul me aksin gjatësor të rrugës (lidhja 2 bashkëlidhur).

6.7 Të gjitha automjetet e transportit të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar, duhet të kenë dhe dalje emergjence;

6.8 Të gjitha automjetet e transportit të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar, duhet të kenë të montuar në ndenjësë, rripat e sigurimit funksional dhe/ose ndenjësët e posaçme për fëmijët nga 4 deri në 12 vjeç;

6.9 Automjetet e pajisur me certifikatë operimi për transport udhëtarësh për një subjekt të caktuar, nuk lejohet të pajisen me certifikatë operimi për të njëjtën periudhë, për llogari të subjekteve të tjerë të transportit. Në rast se gjatë kësaj periudhe kërkohen ndryshime, subjekti për të cilin automjeti është certifikuar duhet të dorëzojë në zyrën e licencave të autoritetit që e ka lëshuar, certifikatën origjinale të automjetit;

6.10 Një automjet që përdoret për shërbimet e rregullta të specializuara për transportin e nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentëve nuk lejohet të përdoret për transportin në shërbimet e linjave të rregullta, apo shërbime të rastit;

6.11 Asnjë subjekt nuk mund të marrë me qira një automjet të destinuar për shërbime të rregullta të specializuara të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentëve, nëse nuk është i pajisur me licencë për të tretë në transportin e udhëtarëve;

6.12 Certifikata e operimit e lëshuar për një automjet të destinuar për shërbimet e rregullta të specializuara për parashkollorët, parauniversitarët dhe studentët lëshohet në emër të subjektit të transportit;

6.13 Certifikata e operimit e lëshuar për një automjet të destinuar për shërbimet e rregullta të specializuara për nxënësit e arsimit parashkollor, parauniversitar lëshohet me afat 5 (pesë) vjet dhe nuk është e transferueshme. Në certifikatën e operimit vendoset itinerari që përshkruan automjeti, e shoqëruar me vendndalimet;

6.14 Një automjet që përdoret për shërbime në linja të rregullta të udhëtarëve apo për shërbimet e rastit, nuk ka të drejtë të operojë në shërbimet e rregullta të specializuara për nxënësit e arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentët;

6.15 Një automjet i pajisur me certifikatë operimi për transportin e parauniversitarëve për llogari të vet nuk lejohet të përdoret në shërbimet e rregullta të specializuara apo shërbimet e rastit të transportit të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentëve;

6.16 Një automjet që përdoret në shërbime të tjera të transportit të udhëtarëve nuk lejohet të përdoret në transportet për llogari të vet të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentëve;

7. Drejtuesi i mjetit

7.1 Drejtuesi i mjetit të certifikuar për transport të rregullt të specializuar, ose për llogari të vet, për nxënësit e arsimit parashkollor, parauniversitar dhe studentët duhet:

a) të ketë kryer/përfunduar, të paktën arsimin e mesëm;

b) të jetë pajisur me lejedrejtimi të kategorisë D1, D1E, D dhe DE;

c) të jetë pajisur me Certifikatën e Aftësisë Profesionale përkatëse (CAP);

d) të ketë reputacion dhe sjellje të mirë.

Për plotësimin e shkronjës “d” të pikës 7.1, drejtuesi i mjetit duhet të vërtetojë reputacionin dhe sjelljen e tij të mirë me dokumente, si më poshtë:

i) trajnime që lidhen me kohën e drejtimit të mjetit dhe periudhat e pushimit të drejtuesve të mjeteve, kohën e punës (të detyrueshme për marrjen e Certifikatës së Aftësisë Profesionale CAP);



ii) mirëmbajtjen dhe kontrollin e detyrueshëm teknik, periodik e vjetor të mjeteve;

iii) trajnime mbi rregullat e operimit në tregun e transportit të mallrave dhe udhëtarëve (të detyrueshme për marrjen e Certifikatës së Aftësisë Profesionale CAP);

iv) vërtetime nga qendrat shëndetësore për mos përdorim të alkoolit, lëndëve droguese ose psikotrope;

v) vërtetime nga organet e policisë rrugore për mos ndëshkime në drejtimin e mjetit nën efektin e alkoolit, lëndëve droguese ose psikotrope.

vi) vërtetim nga organet e drejtësisë për mos trafikimin e qenieve njerëzore apo drogës dhe të mos jetë i dënuar asnjëherë më parë, me veprën penale kundër personit.

7.3 Drejtuesi i mjetit do të informojë me shkrim autoritetin që ka lëshuar licencën ose certifikatën për llogari të vet për çdo dënim që ka marrë brenda 21 ditëve nga data e dënimit dhe në rast apelimi brenda 21 ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit nga apeli;

7.4 Ndalesat për hipjen dhe, ose zbritjen e parauniversitarëve kryhen vetëm në vendet e paracaktuara nga drejtoria e institucionit mësimor, në bashkëpunim me njësinë e qeverisjes vendore, transportuesin dhe organet e policisë rrugore;

7.5 Drejtuesi i mjetit duhet të jetë i veshur me uniformën e tij dalluese dhe në kraharor, mbi xhakët ose këmbishë të ketë distinktivin (shenja dalluese) të përcaktuara nga institucioni mësimor;

7.6 Drejtuesi i mjetit ka përgjegjësi mbi sigurinë e nxënësve të institucioneve arsimore parashkollore, parauniversitare dhe studentëve gjatë shërbimit të transportit.

7.7 Përgjegjësia e drejtuesit të mjetit në shërbimin e rregullt të transportit të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar përfshin:

a) verifikimin, kontrollin dhe sistemimin në ndenjësë për nxënësit e arsimit parashkollor, parauniversitarë përpara se mjeti të fillojë lëvizjen;

b) evitimin e çdo sjellje të rrezikshme brenda në automjet gjatë udhëtimit;

c) të rrisë në maksimum sigurinë gjatë zbritjes dhe, ose hipjes të parauniversitarëve dhe studentëve në ndalesat e paracaktuara. Ndalesat për hipjen dhe, ose zbritjen e parauniversitarëve dhe studentëve kryhen vetëm në vendet e paracaktuara nga organet sipas pikës 7.4;

ç) marrjen, shoqërimin dhe dorëzimin e nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar, të prindërit e tyre, në vendin e paracaktuar për ndalimin e mjetit, ose qëndrimit të përkohshëm;

d) evitimin në çdo rast të mungesës së sjelljes jo korrekte ndaj nxënësve të arsimit parashkollor dhe parauniversitar;

dh) raportimin në drejtorinë e shkollës për sjelljet problematike të parauniversitarëve gjatë transportit;

Drejtuesi i mjetit gjatë udhëtimit asiston nxënësit dhe parauniversitarët në hipje dhe zbritje duke mbajtur në dorë tabelën e kuqe, me simbolin “STOP” dhe të jetë i veshur me një jelek fosforeshent;

7.8 Drejtuesi i mjetit vazhdimisht duhet të ketë me vete:

a) listën me numrat e telefonave të prindërve;

b) adresat e shtëpisë së secilit nxënës apo parauniversitar;

c) numrat e telefonave të emergjencave civile (policia e shtetit, urgjenca mjekësore dhe shërbimi zjarrfikës etj.);

ç) çdo të dhënë tjetër të nevojshme.

8. Organizimi i shërbimit të transportit për ekskursione e udhëtime didaktike jashtë vendbanimit

8.1 Shërbimet e rastit për qëllime turistike si, ekskursione ose për aktivitete didaktike jashtë qendrës urbane të vendndodhjes, bëhet vetëm nga subjekte të licencuara dhe me autobus të certifikuar sipas legjislacionit në fuqi për transportin.

8.2 Drejtoria e shkollës në fillim të çdo viti shkollor i komunikon agjencisë turistike të përzgjedhur, listën me datat dhe me destinacionet përkatëse.

8.3 Drejtoria e shkollës në çdo rast para nisjes, për çdo automjet, harton listën e parauniversitarëve apo studentëve e përditësuar, ku një kopje e së cilës qëndron pranë institucionit arsimor dhe një kopje i jepet transportuesit.

8.4 Me propozim të njësisë arsimore vendore dhe, ose bordit të prindërve, shoqëria e transportit, në bashkëpunim me agjencinë e udhëtimit, përgatitin një plan udhëtimi për çdo itinerar jashtë qytetit ku përcaktohet pika e nisjes, orari i nisjes dhe ndalesat përgjatë rrugës. Plani i udhëtimit i paraqitet shërbimeve të policisë rrugore të qarqeve;

8.5 Për sigurinë e parauniversitarëve dhe studentëve, shërbimet e policisë rrugore të qarqeve



mund të ndërhyjnë e të ndryshojnë planin e udhëtimit. Plani i ndryshuar i itinerarit të udhëtimit i dërgohet institucionit arsimor së bashku me arsyetimet e ndryshimit/ndryshimeve;

8.6 Në çdo udhëtim jashtë qytetit për arsye ekskursioni ose didaktike duhet të jetë i pranishëm përfaqësuesi i institucionit arsimor;

9. Koha e udhëtimit

Koha e udhëtimit për në dhe nga institucioni i edukimit të fëmijëve dhe parauniversitarëve brenda qytetit nuk i kalon 50 min, ndërsa në zonat rurale kjo kohë mund të shtrihet deri në 70 min.

10. Lidhja e kontratës për transport të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar, dhe universitar

10.1 Njësitë e qeverisjes vendore dhe njësitë arsimore vendore për arsimin parashkollor publik dhe privat, parauniversitar publik dhe privat dhe institucionet e arsimit të lartë publike dhe private, janë përgjegjëse për lidhjen e kontratës ndërmjet institucionit dhe organizatorit të transportit për nxënësit e arsimit parashkollor, para-universitarëve dhe studentëve;

10.2 Kontrata duhet të përmbajë elementet e përcaktuara nga kodi civil dhe elementet shtesë të përcaktuar, si vijon:

- a) përcaktimin e orareve të nisjes dhe të kthimit;
- b) itinerarin e përcaktuar të mjetit shkollor;
- c) vendndalimet e paracaktuara gjatë itinerarit;
- ç) kohëzgjatjen e udhëtimit.

10.3 Një kopje e kontratës së nënshkruar është pjesë e dokumenteve të nevojshme për qarkullim dhe i paraqitet organeve të kontrollit në rrugë sa herë kërkohet prej tyre;

10.4 Kontrata do të konsiderohet e pavlefshme në rast se nuk plotësohen kushtet thelbësore të parashikuara në Kodin Civil dhe kushtet e parashikuara në këtë Rregullore.

11. Dokumentet e kontrollit

Organet e kontrollit në rrugë ushtrojnë kontroll të dokumenteve të operimit për operatorët e transportit. Drejtuesit e mjeteve janë të detyruar të paraqesin sa herë kërkohen prej organeve të kontrollit, dokumentet si vijon:

A. Shërbime transporti për të tretë

1. Shërbimeve të rregullta të specializuara:

- a) licencën origjinale ose kopje të barasvlershme me origjinalin;
- b) certifikatën e operimit të autobusit;
- c) kopjen e kontratës ndërmjet organizatorit dhe

transportuesit e barasvlershme me origjinalin;

- ç) dokumentin e kualifikimit të drejtuesit (CAP);
- d) aktin e plotësimit të kushteve të komoditetit.

2. Shërbime të rastit:

a) kopjen e licencës e barasvlershme me origjinalin;

b) bllokun e udhëtimit me listën e plotësuar të parauniversitarëve apo studentëve;

c) certifikatën e operimit të autobusit;

ç) kontratën ndërmjet agjencisë së udhëtimit dhe transportuesit;

d) dokumentin e kualifikimit të drejtuesit (CAP);

dh) aktin e plotësimit të kushteve të komoditetit të autobusit;

Shënim. Në rastin e shërbimeve ndër-kombëtare të rastit për parauniversitarët dhe studentët, me përjashtim të shkronjave “ç” dhe “e”, të gjithë dokumentet e tjerë duhet t’i përgjigjen kërkesave të transportit ndërkombëtar të udhëtarëve.

B. Shërbime transporti për llogari të vet.

a) kopjen origjinale të certifikatës që lëshohet në emër të institucionit;

b) dokumentin që dëshmon se drejtuesi i mjetit është anëtar i stafit të institucionit ose i punësuar me kontratë;

c) dokumentin që dëshmon se veprimtaria e transportit është vetëm një aktivitet ndihmës i institucionit (lista e parashkollorëve, parauniversitarëve dhe studentëve).

ç) certifikatën e operimit të autobusit;

d) dokumentin e kualifikimit të drejtuesit (CAP);

dh) aktin e plotësimit të kushteve të komoditetit të autobusit;

12. Sigurimi i detyrueshëm

Subjektet e transportit të automjeteve të autorizuar të shërbimit të rregullt dhe të rastit të transportit parashkollor, parauniversitar dhe atij universitar janë të detyruar të pajisin automjetin edhe me kontratën për sigurimin e aksidenteve të pasagjerëve, sipas dispozitave të ligjit nr. 10076, datë 12.2.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, të ndryshuar.

13. Masat administrative


Në rast shkeljesh të kërkesave të kësaj Rregullore, zbatohen sanksionet e parashikuara në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar.

14. Dispozita kalimtare

Efektet e pikës 6.5 fillojnë 12 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore




LIDHJA 1





LIDHJA 2

Pamje nga sipër



LIDHJA 3

Mekanizmi



**VENDIM****Nr. 1103, datë 28.12.2015**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E
ARSIMIT DHE SPORTIT TE MINISTRIA
E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL
DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE,
TË SIPËRFAQES SË TOKËS
BUJQËSORE 21.4 HA, ZONA
KADASTRALE 1323, FSHATI BURONJË,
DELVINË, DHE PËR NJË SHITESË NË
VENDIMIN NR. 820, DATË 13.10.2010, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT
TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE TË INSTITUCIONEVE
TË VARËSISË, TË CILAT I KALOJNË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE
MBROJTJES SË KONSUMATORIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit te Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të sipërfaqes së tokës prej 21.4 (njëzet e

një pikë katër) ha, tokë arë, ngastrat me numrat kadastrale 4, 8, 10 e 12, të ndodhura në zonën kadastrale 1323, fshati Buronjë, Delvinë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi, për t’u përdorur nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave në kuadër të politikave dhe strategjisë së këtij institucioni për shfrytëzimin e sipërfaqes së tokës bujqësore dhe vënien në efikasitet të tokave të pakultivuara dhe të lëna djerrë.


2. Prona e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 820, datë 13.10.2010, të Këshillit të Ministrave, për nxitjen e investimeve në bujqësi dhe blegtori, nëpërmjet shfrytëzimit të tokës bujqësore.

3. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave nuk mund të ndryshojë destinacionin e pronës së përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, funksioni kryesor i së cilës është prodhimi bujqësor.

4. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Arsimit dhe Sportit si dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**



VENDIM
Nr. 1104, datë 28.12.2015

**PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE PËR
PARANDALIMIN E SHKARKIMIT TË
MBETJEVE, TË KRIJUARA NGA ANIJET
DHE TEPRICAT NGA NGARKESAT,
NË DET¹**

¹ Ky vendim përafuron plotësisht Direktivën 2000/59/EC "Mbi instalimet marrëse portuale për mbetjet e krijuara nga anija dhe teprica nga ngarkesat" ndryshuar nga Direktiva 2002/84/EC, Rregullorja (EC) 2007/71/EC dhe Rregullorja (EC) 1137/2008. Numri CELEX 32000L0059, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr.332, datë 28.12.2000, faqe 81. Faqe| 16716

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 40, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin, vendosjen dhe miratimin e kërkesave për parandalimin e shkarkimit të mbetjeve, të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat e tyre, në det, me synim mbrojtjen e mjedisit detar nga anijet, gjatë përdorimit të porteve të Republikës së Shqipërisë.



2. Rregullat e përcaktuara në këtë vendim do të zbatohen për:

a) të gjitha anijet, përfshirë mjetet e peshkimit dhe mjetet lundruese për argëtim, pavarësisht nga flamuri, shenja e thirrjes apo veprimtaria e tyre brenda një porti shqiptar;

b) të gjitha portet e Shqipërisë që ankorohen nga anijet e përcaktuara në shkronjën “a”, më sipër.

3. Drejtoria e Përgjithshme Detare siguron që anijet e përfshira në shkronjën “a”, të pikës 2, të këtij vendimi, të dorëzojnë mbetjet e krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat e tyre, në mënyrë të vazhdueshme, tek operatorët e licencuar për grumbullimin dhe trajtimin e tyre, referuar legjislacionit në fuqi.

4. Përkufizimet e nenit 3, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9130, datë 8.9.2003, “Për autoritetin portual”, ligjit nr. 10109, datë 2.4.2009, “Për administratën detare të Republikës së Shqipërisë”, dhe ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

a) “Certifikata e dorëzimit të mbetjeve”, formulari (që jepet në aneksin IV, të këtij vendimi) i plotësuar, që vërteton se anija ia ka dorëzuar mbetjet operatorit të instalimeve marrëse, sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim.

b) “Marpol 73/78”, Konventa Ndërkombëtare për parandalimin e ndotjes nga anijet, 1973, të ndryshuar nga Protokollin i 1978 në lidhje me të, i miratuar me ligjin nr. 9594, datë 27.7.2006, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare për Parandalimin e Ndotjeve nga anijet, 1973, të ndryshuar me Protokollin e vitit 1973”.

c) “Mjet lundrues për argëtim”, mjet lundrues i çdo lloji, pavarësisht mënyrës së forcës shtytëse, që përdoret për qëllime sportive ose jo.

ç) “(Mjet) Anije peshkimi”, çdo anije e pajisur me mjete përkatëse ose që përdoret për kapjen e gjallesave ujore.

d) “IMO”, Organizata Ndërkombëtare Detare.

dh) “Operator”, në kuptim të këtij vendimi, çdo person fizik ose juridik, mbajtës i lejeve dhe

licencave, referuar legjislacionit në fuqi, për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve në portet dhe radat e tyre.

e) “Tepricat nga ngarkesat”, tepricat nga ngarkesat detare, përfshirë mbetjet e çdo lloji të ngarkesës në bord, nga mbajtëset e ngarkesave ose cisternat, të cilat teprojnë pas përfundimit të procedurave të shkarkimit dhe pastrimit.

ë) “Tarifë ekologjike e mbetjeve”, pagesa e detyrueshme që kryen çdo anije dhe mjet lundrues që prek portet e hapura dhe radat e tyre, për mbulimin e kostove të instalimeve marrëse portuale për mbetjet e krijuara nga anijet, përfshirë trajtimin dhe asgjësimin e tyre nga operatorët e licencuar, të kontraktuar nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, që ofrojnë shërbimin e tërheqjes së mbetjeve, referuar aneksit VI, bashkëngjitur.

5. Drejtoria e Përgjithshme Detare sigurohet që kapacitetet e instalimeve marrëse portuale, të instaluar nga operatorët e licencuar, të jenë të mjaftueshme dhe të plotësojnë nevojat e anijeve, pa i shkaktuar atyre vonesa të pajustificuara. Për këtë gjë, kapiteneritë e porteve ngarkohen për verifikimin e kapaciteteve të instalimeve portuale marrëse dhe, në rastet e verifikimit të mosefikasitetit të tyre, detyrohen të njoftojnë Drejtorinë e Përgjithshme Detare për marrjen e masave.

6. Drejtoria e Përgjithshme Detare ngarkohet për transportin, në përputhje me kërkesat e IMO-s, duke përcaktuar, me urdhër, procedurat e raportimit në Kapitenerinë e Portit, në rastet kur pretendohet për efikasitet të pamjaftueshëm të instalimeve marrëse portuale.

7. Operatorët e licencuar, të kontraktuar nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, duhet të zotërojnë kapacitetet e nevojshme për të tërhequr sasinë dhe llojet e mbetjeve, të krijuara nga anijet që përdorin atë port normalisht, dhe tepricat nga ngarkesat e tyre, duke marrë parasysh nevojat funksionale të përdoruesve të portit, madhësinë dhe pozicionin gjeografik të portit, llojin e anijeve që japin shenjën e thirrjes në atë port, si dhe të garantojnë trajtimin e këtyre mbetjeve në impiantet e tyre, të certifikuar dhe licencuar sipas legjislacionit mjedisor në fuqi dhe standardeve e normave të lejuara evropiane.

8. Drejtoria e Përgjithshme Detare, në konsultim me palët e interesuara, veçanërisht me



përdoruesit e porteve, harton dhe zbaton, për çdo port, një plan të përshtatshëm për marrjen dhe trajtimin e mbetjeve, duke kontraktuar operatorë të licencuar, që plotësojnë standardet, referuar kërkesave të pikave 5 deri 24, të këtij vendimi. Kërkesat specifike për hartimin e këtyre planeve përcaktohen në aneksin I, bashkëlidhur këtij vendimi.

9. Plan, referuar në pikën 8, më sipër, hartohet në nivel rajonal ose kombëtar, me përfshirjen e çdo porti, duke siguruar që nevojat për instalimet marrëse dhe disponibiliteti i tyre të specifikohen individualisht, për çdo port, dhe miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për transportin.

10. Ministria përgjegjëse për transportin vlerëson dhe monitoron më tej zbatimin e planit, referuar në pikat 8 e 9. Plan rishikohet dhe miratohet, të paktën, çdo tre vjet, si dhe pas ndryshimeve të rëndësishme në funksionimin e portit, apo në rastet kur operatorët e licencuar prezantojnë një projekt të ri, sipas standerdeve më të fundit të teknologjisë, i cili garanton menaxhimin më të mirë të mundshëm të mbetjeve portuale të anijeve dhe mjeteve lundruese.

11. Kapitani i anijes, që detyrohet të ankorohet në një port në Shqipëri, duhet të plotësojë, me anë të vetdeklarimit, me vërtetësi dhe saktësi, formularin e paraqitur në aneksin II, dhe t'ia njoftojë Kapitenerisë së Portit, nëpërmjet agjencive detare;

a) të paktën 24 orë para mbërritjes, në qoftë se porti i thirrjes është i njohur;

b) sapo të njihet porti i thirrjes, në qoftë se informacioni i kërkuar sigurohet në më pak se 24 orë përpara mbërritjes;

c) pak kohë pas largimit nga porti i mëparshëm, në qoftë se kohëzgjatja e udhëtimit është më pak se 24 orë.

12. Kapiteneria e Portit i dërgon një kopje të njoftimit, të përcaktuar në pikën 11, të këtij vendimi, Autoritetit Portual dhe operatorit të instalimeve marrëse portuale. Operatori është i detyruar të mbajë një regjistër për njoftimet dhe certifikatat e dorëzimit të mbetjeve dhe t'ia përcjellë ato, çdo muaj, Drejtorisë së Përgjithshme Detare.

13. Kapitani i anijes ruan kopje të informacionit, të përcaktuar në pikën 11, të këtij

vendimi, për një periudhë dyvjeçare, në bordin e anijes, dhe, me kërkesën e tyre, ua vë në dispozicion Drejtorisë së Përgjithshme Detare ose organeve të tjera, të caktuara për këtë qëllim nga ministria përgjegjëse për transportin dhe ministria përgjegjëse për mjedisin.

14. Kapitani i anijes që ankorohet në një port shqiptar, përpara largimit nga porti, i dorëzon të gjitha mbetjet e krijuara nga anija, sipas aneksit IV, të këtij vendimi.

15. Anija nuk është e detyruar të dorëzojë çdo ditë mbetjet e krijuara, por mund të vazhdojë për në portin tjetër të thirrjes pa i dorëzuar ato, në qoftë se, sipas informacionit të dhënë, në përputhje me aneksin II, ka kapacitet magazinimi të mjaftueshëm për të gjitha mbetjet e krijuara dhe ato të mundshme të krijohen gjatë udhëtimit të planifikuar të anijes deri në portin e dorëzimit.

16. Drejtoria e Përgjithshme Detare, kur ka arsye të mjaftueshme për të besuar se porti i planifikuar për dorëzimin e mbetjeve nuk disponon instalimet e duhura ose në qoftë se ky port është i panjohur dhe, si pasojë, ka rrezik që mbetjet të shkarkohen në det, merr të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar ndotjen detare dhe/ose i kërkon anijes të dorëzojë mbetjet e saj përpara largimit nga porti.

17. Ministria përgjegjëse për transportin, pas konsultimeve me ministrinë përgjegjëse për mjedisin, sigurojnë që kostot e instalimeve marrëse portuale për mbetjet e krijuara nga anijet, përfshirë trajtimin dhe largimin e tyre, të mbulohen përmes mbledhjes së tarifës ekologjike, të detyruar për anijet dhe mjetet lundruese për mbetjet.

18. Ministri përgjegjës për transportin dhe ministri përgjegjës për financat, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme Detare, bazuar në modelet e ngjashme të porteve të rajonit, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 84, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", miratojnë, me udhëzim të përbashkët, vlerën e tarifës ekologjike të detyruar për anijet dhe mjetet lundruese, me qëllim marrjen e shërbimit, referuar në pikën 17, më sipër. Përllogaritja e përcaktimit të vlerës së kësaj tarife ekologjike bëhet bazuar në tonazhin përkatës të çdo mjeti lundrues, referuar parimit "Ndotësi paguan".



19. Tarifën ekologjike të marrjes dhe përpunimit të mbetjeve e paguajnë të gjitha anijet dhe mjetet e lundrimit që ankorohen në portet e hapura dhe radat e tyre, pranë Drejtorisë së Përgjithshme Detare dhe, më pas, kjo e fundit likuidon, për çdo rast shërbimi, operatorin e instalimeve marrëse portuale, referuar kontratës përkatëse.

20. Tarifa ekologjike dhe sistemi i mbulimit të kostos, për përdorimin e instalimeve marrëse portuale, duhet të mos stimulojnë anijet dhe mjetet lundruese që të shkarkojnë mbetjet e tyre në det.

21. Tarifa ekologjike për anijet e peshkimit, anijet e shërbimit detar (rimorkiator, pilotina dhe bargat e ndryshme, që përdoren për punime në port), si dhe mjetet që përdoren për argëtim (jahtet, skafet sprotive, mjetet e vogla për gjueti amatore si dhe mjetet e vogla detare me më pak se 12 pasagjerë) do të jetë e ndryshme nga ajo e përcaktuar në pikën 20, të këtij vendimi. Ajo do t'i nënshtrohet një regjimi tjetër, për vet llojin e aktivitetit që ato ushtrojnë, sipas modelit më të përshtatshëm që do të propozohet nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, dhe do të miratohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për transportin dhe ministrit përgjegjës për financat.

22. Kapiteni i anijes që akomodohet në portet e hapura dhe radat e tyre në Republikën e Shqipërisë duhet të sigurojë që tepricat nga ngarkesat të dorëzohen në një instalim marrës portual, në përputhje me dispozitat Marpol 73/78. Përdoruesi i instalimeve marrëse pagan tarifën për dorëzimin e tepricave nga ngarkesat.

23. Kontrolli Shtetëror Portual/Kapiteneria e Portit duhet të sigurojë që çdo anije të jetë objekt inspektimi për verifikimin e përputhshmërisë së saj me rregullat e përcaktuara në pikat 14, 15, 16 e 24, të këtij vendimi.

24. Kontrolli Shtetëror Portual/Kapiteneria e Portit, kur inspekton anijet e autorizuar për të mbajtur jo më shumë se 12 pasagjerë, përveç mjeteve të peshkimit dhe mjeteve lundruese për argëtim, gjatë inspektimit:

a) vepron në kuadër të ligjit nr. 9852, datë 26.12.2007, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Memorandumin e Mirëkuptimit, "Për Kontrollin Shtetëror Portual";

b) në qoftë se nuk bindet nga rezultatet e këtij inspektimi, duhet të sigurojë që anija të mos

largohet nga porti pa dorëzuar, sipas pikave 14, 15 e 16, të këtij vendimi, mbetjet e krijuara dhe tepricat nga ngarkesat e saj në instalimin marrës portual;

c) informon autoritetin kompetent të portit tjetër të thirrjes, kur ka të dhëna të sigurta se anija ka dalë në det pa plotësuar rregullat e përcaktuara në pikat 14, 15 e 16, të këtij vendimi. Ky i fundit, përveç sa parashikohet në pikën 30, të këtij vendimi, nuk duhet ta lejojë anijen të largohet nga ai port derisa të kryejë një vlerësim më të detajuar të zbatimit të këtij vendimi, veçanërisht të saktësisë së çdo informacioni të dhënë, sipas pikave 11, 12 e 13, të këtij vendimi.

25. Drejtoria e Përgjithshme Detare përcakton procedurat e kontrollit që sigurojnë plotësimin e kërkesave të këtij vendimi nga mjetet e peshkimit dhe mjeteve lundruese për argëtim, të autorizuar të mbajnë jo më shumë se 12 pasagjerë, anijet e shërbimit detar, rimorkiatorët, pilotazhet, bargat etj.

26. Ministria përgjegjëse për transportin duhet të:

a) marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që kapitenët e anijeve, operatorët e instalimeve marrëse portuale dhe personat e tjerë të interesuar të informohen në mënyrën e duhur dhe të plotësojnë detyrimet që u burojnë nga ky vendim;

b) bashkëpunojë me autoritetet përkatëse ndërkombëtare, përfshirë IMO-n, dhe çdo ent tjetër tregtar, për të siguruar zbatimin efektiv të këtij vendimi;

c) sigurojë që informacioni i njoftuar nga kapitenët e anijeve, në përputhje me pikat 11, 12 e 13, të këtij vendimi, të shqyrtohet në mënyrën e duhur;

ç) sigurojë që formalitetet, në lidhje me përdorimin e instalimeve marrëse portuale, të jenë të thjeshta e të shpejta dhe nxitin kapitenët e anijeve të përdorin instalimet marrëse portuale e të shmangin vonesat e pajustificuara të anijeve;

d) sigurojë që trajtimi, nxjerrja ose largimi i mbetjeve të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat e tyre të kryhen vetëm nga operatorë të licencuar dhe të miratuar nga Ministria e Mjedisit, me lejet dhe licencat përkatëse, referuar legjislacionit në fuqi.

dh) informojë të gjitha palët e përfshira në dorëzimin ose marrjen e mbetjeve të krijuara nga



anijet ose tepricat nga ngarkesat e tyre, për efekt kompensimi për dëmin e shkaktuar nga vonesa të pajustificuara, në përputhje me Kodin Civil dhe Kodin Detar të Republikës së Shqipërisë.

27. Anija që ka dorëzuar mbetjet e krijuara prej saj mund të largohet nga porti.

28. Ministria përgjegjëse për transportin bashkëpunon me autoritetet përkatëse ndërkombëtare, përfshirë IMO-n, për ngritjen e një sistemi të përshtatshëm informacioni, identifikimi të anijeve dhe monitorimi, që:

a) lehtëson identifikimin e anijeve që nuk kanë dorëzuar mbetjet e krijuara dhe tepricat nga ngarkesat e tyre, sipas këtij vendimi;

b) lejon të vlerësohet nëse është arritur qëllimi i përcaktuar në pikën 27, të këtij vendimi.

29. Ministria përgjegjëse për transportin bashkëpunon me autoritetet përkatëse ndërkombëtare, përfshirë IMO-n, për përcaktimin e kriterëve të përbashkëta për identifikimin e anijeve.

30. Shkeljet e dispozitave të këtij vendimi, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen sipas pikës 38, të nenit 62, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

31. Drejtoria e Përgjithshme Detare paraqet çdo vit, në ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe në ministrinë përgjegjëse për transportin, raportin për zbatimin e këtij vendimi.

32. Ministria përgjegjëse për mjedisin dhe ministria përgjegjëse për transportin bashkëpunojnë me Drejtorinë e Përgjithshme Detare për të siguruar përputhshmëri me parashikimet në fuqi të IMO-s, në qoftë se është i nevojshëm përmirësimi i regjimit të përcaktuar nga ky vendim, por pa zgjeruar objektin e këtij vendimi, referencat në instrumentet IMO dhe anekset e këtij vendimi.

33. Ngarkohen ministria përgjegjëse për transportin, ministria përgjegjëse për mjedisin dhe Drejtoria e Përgjithshme Detare për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI I

KËRKESAT PËR PLANIN E MARRJES DHE TRAJTIMIT TË MBETJEVE NË PORT

Plani i marrjes dhe trajtimit të mbetjeve në port duhet të mbulojë të gjitha llojet e mbetjeve të krijuara dhe tepricat nga ngarkesat në det që vijnë nga anijet që vizitojnë portin normalisht. Ai duhet të hartohet në përputhje me madhësinë e portit dhe llojet e anijeve që japin shenjë të thirrjes në atë port.

Plani duhet të përfshijë elementet e mëposhtme:

a) vlerësimin e nevojës për instalime marrëse portuale nisur nga nevojat e anijeve që vizitojnë portin normalisht;

b) përshkrimin e llojit dhe kapacitetit të instalimeve marrëse portuale;

c) përshkrimin e hollësishëm të procedurave për marrjen dhe mbledhjen e mbetjeve të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat;

d) përshkrimin e sistemit të pagesës;

- Detaje të tarifës së propozuar sipas modeleve të ngjashme të rajonit dhe BE-së;

- Metodën e llogaritjes.

e) procedurat për raportimin mbi mangësitë e pretenduara të instalimeve marrëse portuale;

f) procedurat për konsultimet e vazhdueshme me përdoruesit e portit, kontraktuesit e mbetjeve, operatorët e terminalit dhe palët e tjera të interesuara;

g) llojet dhe sasinë e mbetjeve të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat të marra dhe të trajtuara;

h) Një përmbledhje të legjislacionit përkatës dhe të formaliteteve për dorëzimin e mbetjeve dhe tepricave;

i) Identifikimin e personit ose personave përgjegjës për zbatimin e planit;

j) Një përshkrim të pajisjeve dhe proceseve paratrajtuese në port, nëse ka ose jashtë tij;

k) Një përshkrim të metodave që janë përdorur për raportimin e përdorimit aktual të instalimeve marrëse portuale;

l) Një përshkrim të metodave që janë përdorur për raportimin e të dhënave mbi sasinë e mbetjeve dhe tepricat e ngarkesave të dorëzuara nga anijet;



m) Një përshkrim të mënyrës së largimit të mbetjeve të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat.

Procedurat për marrjen, mbledhjen, magazinimin, trajtimin dhe largimin e mbetjeve dhe tepricave nga ngarkesat e anijeve duhet të jenë në përputhje me sistemet e menaxhimit të mjedisit sipas standardeve me të fundit evropiane dhe të miratuara, gjithashtu, nga ministria përgjegjëse për mjedisin.

Informacioni që i vihet në dispozicion të gjithë përdoruesve të portit:

- Një referencë e shkurtër mbi rëndësinë e dorëzimit të mbetjeve të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat në përputhje me kërkesat e këtij vendimi;

- Vendndodhja e instalimeve marrëse portuale të aplikueshme në çdo vend ankorimi me diagram /hartë;

- Lista e mbetjeve të krijuara nga anijet dhe tepricat nga ngarkesat që trajton normalisht;

- Lista e pikave të kontaktit, operatorët e licencuar dhe shërbimet e ofruara;

- Procedura e dorëzimit;

- Sistemi i pagesës; dhe

- Procedurat për raportimin e mangësive të pretenduara për instalimet marrëse portuale.

ANEKSI II INFORMACIONI QË ANIJA DUHET TË NJOFTOJË PËRPARA HYRJES NË PORTET SHQIPTARE

1. Emri, shenja e thirrjes dhe sipas rastit, numri IMO i identifikimit të anijes:

2. Flamuri i shtetit:

3. Koha e vlerësuar e mbërritjes (ETA):

4. Koha e vlerësuar e nisjes (ETD):

5. Porti i mëparshëm i thirrjes:

6. Porti tjetër i thirrjes:

7. Porti i fundit dhe data kur janë dorëzuar mbetjet e krijuara nga anija:

8. Në instalimin marrës portual do të dorëzoni (shëno kutinë e duhur):

☐ Të gjitha ☐ disa ☐ asnjë nga mbetjet tuaja?

9. Llojin dhe sasinë e mbetjeve dhe tepricave që do të dorëzohen dhe/ose mbahen në bord dhe përqindjen që ato zënë në raport me kapacitetin maksimal të magazinimit:

Në qoftë se dorëzoni të gjitha mbetjet plotësoni kolonën e dytë.

Në qoftë se dorëzoni disa ose nuk dorëzoni mbetje, plotësoni të gjitha kolonat.

Lloji	Mbetjet që do të dorëzohen (në m ³)	Kapaciteti maksimal i magazinimit (në m ³)	Sasinë e mbetjeve që do të mbahen në bord (në m ³)	Porti ku do të dorëzohen mbetjet e mbajtura	Sasia e vlerësuar e mbetjeve që do të gjenerohet nga moment i njoftimit deri në mbërritjen në portin tjetër të thirrjes (në m ³)
Vajra të përdorur					
Llumra					
Ujë i sentinave					
Të tjera (specifikoni)					
Mbetje të ngurta					
Mbetje nga ushqimet					
Mbetje plastike					
Mbetje të tjera					
Ujëra të ndotura (1)					
Mbetje që shoqërojnë ngarkesat (specifikoni) (2)					
Tepricat nga ngarkesat (2) (përcaktimi)					

1. Ujërat e ndotura mund të shkarkohen në det në përputhje me Rregulloren 11 të aneksit IV të Marpol 73/78. Në rast të një shkarkimi të autorizuar në det kutitë përkatëse nuk plotësohen.

2. Mund të jenë vlerësime.



ANEKSI III KRITERET MINIMALE PËR PËRCAKTIMIN VLERËS SE TARIFËS EKOLOGJIKE PËR MBETJET

Tarifa për shërbimet dhe përdorimin e instalimeve marrëse portuale do të hartohen në bazë të kriterëve minimale të përcaktuara në këtë aneks sipas pikave A dhe B.

A. Tarifa ekologjike e mbetjeve llogaritet duke shumëzuar tarifën për njësi, që propozohet nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, me faktorin e përcaktuar në pikën B, më poshtë.

B. Përlllogaritja e tarifës ekologjike të mbetjeve do të bëhet sipas formulës çmim për njësi (që do të propozohet nga Drejtoria e Përgjithshme Detare) x GRT e anijes përkatëse. Me anën e aplikimit të kësaj formule bazuar në modelin evropian, nuk është e nevojshme që të bëhet klasifikimi sipas llojit të anijes (ngarkesa të Përgjithshme, cisterna, anije pasagjeresh etj.) dhe tarifimi vjen në progresion aritmetik në lidhje me tonazhin e anijes dhe generimin e të gjitha llojeve të mbetjeve

ANEKSI IV VËRTETIMI PËR DORËZIMIN E MBETJEVE DHE MBETURINAVE TË ANIJES

1. Emri i anijes dhe numri i IMO, IMO number/ _____
Name, IMO identification number of ship.
2. Flamuri i shtetit / Flag country: _____
3. Vendi i shkarkimit / Place of discharge: _____
4. Agjenti / Agent: _____
5. Data e mbërritjes / Date of arrival: _____
6. Data e nisjes / Date of departure: _____
7. Koha e shkarkimit / Time of discharge: _____
8. Tipi dhe sasia e mbetjeve të dorëzuara / Type and quantity of waste delivered (bej shënime në kutinë përkatëse/ tick appropriate box):

Tipi i mbetjeve <i>Type of waste</i>	Sasia e mbetjeve të raportuara në / <i>Amount to waste report ed in the order</i> m ³	Sasia e mbetjeve të tërhequra / <i>Amount of waste received</i> m ³
1. Mbetje nga karburati (Waste oils)		
1.1 Llumra (<i>Sludge</i>)		
1.2 Ujë sentinash (<i>Bilge water</i>)		
1.3 Slope (<i>Slops</i>)		
1.4 Të tjera (<i>pervakt</i>)		
1.4. Pece me karburant (<i>Oil rags</i>)		
2. Mbeturina (Garbage)		
2.1 Mbeturina ushqimesh (<i>Food waste</i>) Bej shënime në se keni mbledhur mbeturinat dhe do ti dorëzoni më vete veç (<i>Mark only if you have collected and will discharge separately</i>)		
2.2 Mbeturina të riciklueshme mbeturina të paketuara (Recyclable waste, packaging waste) Bej shënime në se keni mbledhur mbeturinat dhe do ti dorëzoni më vete (<i>Mark only if you have collected and will discharge separately</i>)		
2.2.1 Plastik (<i>Plastic</i>)		
2.2.2 Letër (<i>Paper</i>)		
2.2.3 Xham (<i>Glass</i>)		
2.2.4 Metale (<i>Tin</i>)		
2.3 Mbeturina sanitare të përziera (<i>Mixed domestic Waste</i>)		
2.4 Të tjera specifiko (<i>Other, specify</i>)		



2.4.1 Mbetje të rrezikshme/ <i>Hazardous waste</i> (Täpsustada, specify)		
3. Mbeturina që dalin nga ngarkesa <i>Cargo associated waste</i> (Täpsustada, specify)		
4. Mbetje të ngarkesës <i>(Cargo residues)</i>		
5. Ujëra të ndotura <i>(Sewage)</i>		
DORËZUAR NGA / TËRHEQUR NGA / <i>RECEIVED BY</i> <i>DELIVERED Emri Firma dhe</i> <i>Emri Firma (Name, signature)</i> <i>Vula e anijes (Name, signature, vessel's stamp)</i>		Shënime / <i>NOTES</i>

ANEKSI V

FORMATI I NJOFTIMIT PËR MBETJET TË GRUMBULLUARA NGA ANIJET
 NOTIFICATION FORM FOR SHIP-GENERATED WASTE

Sipas ligjit nr. 9594, datë 27.7.2006 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare "Për parandalimin e ndotjeve nga anijet, 1973 të ndryshuar me protokollin e vitit 1978 (marpol73/78)"

Për: KAPITANERINË E PORTIT TË ____

To _____ **HARBOUR MASTER OFFICE**

1. DETAJE TË ANIJES
SHIP DATUM

1.1 EMRI I ANIJES Ship's name	1.5 SHENJA NDËRKOMBËTARE E THIRRJES Call sign
1.2 NUMRI I I.M.O. I.M.O. Number	1.6 SHTETI I FLAMURIT Flag State
1.3 PRONARI OSE CHARTERUESI Owner or the Charterer	
1.4. Tipi i anijes 1.4 Tipo di nave ☒ naftëmbajtëse ☐ kimikatesh ☐ transport rifuxho ☐ konteiner <i>Oil Tankers</i> <i>Chemical carrier</i> <i>Bulk carrier</i> <i>Container</i> ☐ anije të tjera ngarkese ☐ anije pasagjere ☐ Ro-Ro ☐ Të tjera (specifikojë) <i>Others cargo ship</i> <i>passengers ship</i> <i>Ro-Ro</i> <i>Others (specify)</i>	

2. DETAJE TË PORTIT TË FUNDIT DHE UDHETIMIT

Last port and voyage datum

2.1 Data dhe ora e parashikuar e mbërritjes Date and E.T.A.	2.6 Porti i fundit i prekjes në të cilin janë dorëzuar mbeturinat e grumbulluara në anije Last port of call and date when liquid waste was delivered
2.2 Data dhe ora e parashikuar e nisjes Date and E.T.D	2.7 Data e fundit e dorëzimit të mbeturinave Last port of call and date where solid waste was delivered
2.4 Porti i fundit i prekjes dhe shteti Last previous port of call and State	2.8 Emri i Kapitenit të anijes që njofton këtë model Name of the Master ship that notifies this model
2.5 Porti i ardhshëm i prekjes Next port of call	2.9 Emri i agjencisë The name of the agency

Mendoni të dorëzoni mbeturinat në impiantet portuale të mbledhjes? ☐ TË GJITHA ☐ DISA ☐ ASGJË
Are you delivering all, some, none of your waste into port reception facilities? ALL SOME NONE



**TIPI DHE SASIA E MBETJEVE PËR TË DORËZUAR DHE/OSE DO TË MBAHEN NË BORDIN E ANIJES
DHE PËRQINDJA E DEPOZITIMIT MAKSIMAL
TYPE AND AMMOUNT OF WASTE AND RESIDUES TO BE DELIVERED AND/OR REMAINING ON
BOARD, AND PERCENTAGE OF MAXIMUM STORAGE**

Në rastet kur mendoni të shkarkoni të gjitha mbeturinat që janë në bord, plotësoni vetëm kolonën e dytë (Mbeturinat që dorëzohen në m³), në rast se mendoni të dorëzoni disa ose asgjë plotësoni të gjitha kolonat (Mbeturinat që dorëzohen në m³)
If delivering all waste, complete second column as appropriate - If delivering some or no waste, complete all columns

TIPI <i>TYPE</i>	Mbeturinat për dorëzim m ³ <i>Waste to be delivered m³</i>	Kapaciteti max i depozitimit m ³ <i>Maximum dedicated storage capacity m³</i>	Sasia e mbeturinave që mbahen në bord m ³ <i>Amount of waste retained on board m³</i>	Porti në të cilin do të dorëzohen mbeturinat e mbetura në bord <i>Port at which remaining waste will be delivered</i>	Sasia e llogaritur mbeturinave që do të gjenerohen që nga njoftimi e deri në portin e ardhshëm të prekjes në m ³ <i>Estimated amount of waste to be generated between notification and next port of call m³</i>
MARPOL – Aneksi 1 OLI – oil					
Ujë sentinash <i>Oily Bilge water</i>					
Mbetje vajore - Slaxhe – <i>Oily residues (Sludge)</i>					
Ujë vajor pas larjes së cisternave <i>Oily tank washings</i>					
Ujë i ndotur i ballasteve <i>Dirty ballast water</i>					
Mbeturina dhe slaxhe pas larjes së cisternave <i>Scales and sludge from tank cleaning</i>					
Të tjera (specifiko) <i>Others (please specify)</i>					
Mbetje nga ngarkesa (specifiko) <i>Cargo residues (specify)</i>					
MARPOL Aneksi II – Materiale helmuese të lëngshme – (m³) /emri Marpol Annex II – Noxious Liquid Substances – (m³) /name					
Materiale të kategorisë X <i>Kategoria e ndotjes X Materiali</i>					
Materiale të kategorisë Y <i>Kategoria e ndotjes Y Materiali</i>					
Materiale të tjera <i>Other substances (OS)</i>					
Mbetje nga ngarkesa (specifiko) <i>Cargo residues (specify)</i>					
MARPOL Aneksi IV – Ujë i zbrazur MARPOL Annex IV – Sewage					
Ujë i zbrazur <i>Sewage</i>					
MARPOL Aneksi V – Plehra MARPOL Annex V – Garbage					
Mbeturina ushqimore <i>Food waste</i>					
Plastike <i>Plastic</i>					
Mbeturina të ngarkesës (pajisje të ambalazhimit dhe mbulimit të ngarkesës etj.) <i>Cargo associated waste (Floating dunnage, lining, packing materials, etc)</i>					
Prodhime të letrës, leckë, xhama, pece,					



metalike, shishe etj.)					
Mbeturina të djegieve <i>Incinerator ash</i>					
Plehra të tjera (specifiko) <i>Others refuse types</i>					
Mbetje nga ngarkesa (specifiko) <i>Cargo residues (specify)</i>					

(1) Ujërat e zbrazjes mund të shkarkohen në det në përputhje me rregullat 11 të aneksit IV të protokollit Marpol 73/78. Kutitë korresponduese nuk plotësohen nëse mendoni që të bëni një shkarkim të autorizuar në det.

Sewage may be discharged at sea in accordance with Regulation 11 of Annex IV Marpol 73/78. The corresponding boxes do not need to be completed if it is the intention to make an authorised discharge at sea.

(2) Mund të llogariten.

May be estimates

(3) Moduli i paraqitur duhet të plotësohet i gjithë edhe në rastet e një përjashtimi për anijen

This form is to be completed unless the ship is covered by an exemption.

-Unë i nënshkruari konfirmoj

-I undersigned confirm

- Që informacioni i dhënë në këtë njoftim është i saktë dhe i sigurtë

- that the above details are accurate and correct

- që në bord ekziston një kapacitet i mjaftueshëm për depozitimin e mbeturinave të gjeneruara nga momenti i njoftimit dhe deri në portin e ardhshëm në të cilin mbeturinat do të dorëzohen.

there is sufficient dedicated on board capacity to store all waste generated between notification and the next port at which waste will be delivered

Data _____

Date

Ora _____

Time

Firma _____

ANEKSI VI

LLOJET MBETJEVE TË GRUMBULLUARA NGA ANIJET TË CILAT PËRFSHIHEN NË SHËRBIMIN E OFRUAR BRENDË VLERËS SË TARIFËS EKOLOGJIKE TË DETYRUAR NGA TË GJITHA ANIJET DHE MJETET LUNDRUESE

MARPOL – Aneksi 1 OLI – oil	
Ujë sentinash <i>Oil Bilge water</i>	
Mbetje vajore - Slaxhe – <i>Oil residues (Sludge)</i>	
Ujë i ndotur i ballasteve <i>Dirty ballast water</i>	
MARPOL Aneksi II – Materiale helmuese të lëngshme – (m³) /emri <i>Marpol Annex II – Noxious Liquid Substances – (m³) /name</i>	
MARPOL Aneksi IV – Ujë i zbrazur <i>MARPOL Annex IV – Sewage</i>	
Ujë i zbrazur <i>Sewage</i>	
MARPOL Aneksi V – Plehra <i>MARPOL Annex V – Garbage</i>	
Mbeturina ushqimore <i>Food waste</i>	
Plastikë	



<i>Plastic</i>
Mbeturina të ngarkesës (pajisje të ambalazhimit dhe mbulimit të ngarkesës etj.) <i>Cargo associated waste (Floating dunnage, lining, packing materials, etc)</i>
Prodhime të letrës, lecka, xhama, pece, metalike, shishe etj.)
Mbeturina të djegieve <i>Incinerator ash</i>
Plehra të tjera (specifiko) <i>Others refuse types</i>

VENDIM**Nr. 1105, datë 28.12.2015**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA “NDËRTIMI I
RRJETIT TË KANALIZIMEVE TË
VLORËS, FAZA 2, IPA 2012”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga “Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të Vlorës, faza 2, IPA 2012”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për tokë “truall”, me sipërfaqe 30 (tridhjetë) m² dhe vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 198 570 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) lekësh.

4. Vlera përgjithshme e shpronësimit, prej 198 570 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) lekësh, të përballohet, si më poshtë vijon:

- Vlera 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, nga buxheti i vitit 2015, zëri “Kosto lokale”, me kod (M063148).

- Pjesa tjetër e vlerës, nga buxheti vitit 2016, zëri “Kosto lokale”.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive që përmenden në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat është bërë shënim “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, “Vërtetim hipotekor”, “Certifikatë pronësie”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.



11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetës - Kanalizimeve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTTIT “NDËRTIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMEVE NË VLORË, FAZA2, IPA 2012”

Nr.	Stacioni i pompimit	Nr. i pas	ZK	Indeksi i hartës	Pronarët	Lloji i pasurisë	Sip.	Çmimi lekë/m ²
1	PS N4	45/23	8602	V1; AC-11	Irakli Cavo Evriniqi Stefa Vasilika Dushani Lefteri Gjyli	Toke truall	30m2	6 619 lek/m ²
	Vlera totale							198 570 lekë

VENDIM

Nr. 1107, datë 30.12.2015

**PËR KRIJIMIN E BORDEVE RAJONALE
TË KULLIMIT LEZHË, DURRËS, FIER
DHE KORÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41, të ligjit nr. 8518, datë 30.7.1999, “Për ujitjen dhe kullimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bordeve rajonale të kullimit Lezhë, Durrës, Fier dhe Korçë, të cilat financohen nga buxheti i shtetit, i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

2. Zonat e shërbimit të kullimit, mbrojtjes nga përmbytja dhe ujitjes me infrastrukturën përkatëse në administrim të këtyre bordeve të jenë, si më poshtë vijon:

- Bordi Rajonal i Kullimit Lezhë: zona e shërbimit përfshin qarqet e Lezhës, Shkodrës dhe Kukësit;

- Bordi Rajonal i Kullimit Durrës: zona e shërbimit përfshin qarqet e Durrësit, Tiranës dhe Dibrës;

- Bordi Rajonal i Kullimit Fier: zona e shërbimit përfshin qarqet e Fierit, Vlorës dhe Gjirokastrës;

- Bordi Rajonal i Kullimit Korçë: zona e shërbimit përfshin qarqet e Korçës, Elbasanit dhe Beratit.

3. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 28.1.2005, “Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Beratit”, nr. 280, datë 16.4.2004, “Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Durrës”, të ndryshuar, nr. 286, datë 16.4.2004, “Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Elbasanit”, nr. 288, datë 16.4.2004, “Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Fierit”, nr. 66, datë 28.1.2005, “Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Gjirokastrës”, nr. 264, datë 7.4.2010, “Për krijimin e bordeve të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit Tiranë-Kavajë, Korçë-Pogradec e Vlorë-Sarandë, si dhe për një shtesë në vendimin nr. 286, datë 16.4.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit Elbasan”, nr. 120, datë 25.2.2005, “Për krijimin e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Kukësit”, nr. 283, datë 16.4.2004, “Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Lezhës”, të ndryshuar, nr. 94, datë 13.2.2003, “Për krijimin e bordit të kullimit për rrethin e Lushnjës”, nr. 119, datë 25.2.2005, “Për krijimin e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Dibrës”, dhe nr. 282, datë 16.4.2004, “Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Shkodrës”, shfuqizohen.



4. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

KËRKESË

Shtetasi Altin Dako, i datëlindjes 5.3.1977, kërkon shpalljen të zhdukur që nga viti 1991, të shtetasit Mihallaq Doko, , i biri i Themit dhe Vases, lindur në Poro dhe banues në fshatin Dëllenjë, Njësia Administrative Novoselë, Bashkia Vlorë.

KËRKUESI
Altin Doko

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 532 lekë